


RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK


Për programin e studimit Specializues Afatgjatë (SPA)
në “Stomatologji”, me profile “Kirurgji Orale” dhe “Ortodonti”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Vergjini MULO



Prof. Ass. Teuta PUSTINA KRASNIQI



Qershor / 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Specializim Afatgjatë në: “Stomatologji”, me profile “Kirurgji orale” dhe “Ortodonti”

1	IAL aplikues:	Universiteti Aldent
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Stomatologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Programi i Studimit Specializues Afatgjatë në: “Stomatologji” me profile: 1. “Kirurgji Orale”; 2. “Ortodonti”;
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 299, datë 22.07.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 535, datë 14.11.2016
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër Nr. 112, datë 11.03.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i tretë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Sipas pikës IV në Urdhërin e Licencimit citohet: Universiteti Aldent do të realizojë programin e studimit specializues afatgjatë në bashkëpunim me Qendrën spitalore Giovanni XIII Trevizo, Itali, sipas marrëveshjes dypalëshe të lidhur ndërmjet tyre.
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 8
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE / 5 PAK
18	Numri i studentëve (3 vitet e fundit)	38 studentë – profili Kirurgji Orale; 26 studentë – profili Ortodonti;
19	Komente / të tjera:	-

Pachira

dy

HYRJE

Raporti i Vetvlerësimit për programin e studimit specialistik aftagjatë /SPA/ në profilin e Kirurgjisë Orale dhe Ortodoncisë, u aplikua në sistemin AMS të ASCAL, dhe ishte e lehtë për t'u shkarkuar. RVB përmban 84 faqe dhe ofron të dhëna të mjaftueshme për analizën e gjendjes së Universitetit Aldent /UAL/dhe programit të studimit në vlerësim. Mund të vihet re se u bënë përpjekje të mëdha në hartimin e dokumentit, punë që duhet vlerësuar.

Duke iu referuar RVB, dokumenteve të shkarkuara nga web faqe e UAL dhe dokumenteve shtesë të dërguara me kërkesë të ASCAL dhe ekspertëve të jashtëm, shihet qartazi se Institucioni ka vendosur instrumente dhe mekanizma për funksionimin adekuat të programeve të shkollimit specialistik dhe se të gjitha aktivitetet bazohen në dokumente ligjore kombëtare dhe institucionale. Po ashtu, në sistemin e ASCAL u inkorporuan edhe *Minutat e takimit*, të cilat ishin të një vlere të lartë për përpilimin e këtij raporti. Universiteti "ALDENT" (UA) është institucion jo publik i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 673, datë 22.09.2006, me statusin Shkollë e Lartë Universitare. Përgjatë viteve UA ka pësuar një sërë ndryshimesh, si në emërtim dhe në strukturën e tij. Me VKM Nr. 539, datë 13.06.2013, ndryshon statusi nga shkollë e lartë universitare private Aldent në Universitet, me emërtimin Universiteti Aldent. Me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 305, datë 24.07.2013, riorganizohet institucioni në 2 Fakultete, në përputhje me Vendimin Nr. 442, datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit. UA ka kaluar disa procese vlerësimi dhe akreditimi të njëjësive kryesore, si edhe të akreditimit institucional. Me Urdhër të MASH Nr. 115, datë 13.07.2017, hapet Njesia Kryesore: Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Me Urdhër të MASH Nr. 111, datë 11.03.2016, Universiteti Aldent ka kaluar akreditim periodik institucional, në përputhje me Vendimin Nr. 124, datë 18.02.2016 të Këshillit të Akreditimit. Së fundmi, Institucioni ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjensinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.114, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 14.12.2022.

Struktura akademike e Universitetit Aldent, aktualisht përbëhet nga tre njësi kryesore:

1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore me:

- Departamenti i Farmacisë;
- Departamenti i Formimit Mjekësor;
- Qendra Kërkimore Farmako-Terapeutike;


2. Fakulteti i Shkencave Dentare me:

- Departamenti i Laborantëve Dentarë;
- Departamenti i Stomatologjisë;
- Qendra e Shërbimit dhe Formimit Klinik;

3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike me:

- Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë;
- Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri;
- Qendra e Promovimit të Shëndetit;

Universiteti Aldent është institucion jopublik në vend, i profilizuar tërësisht në fushën e shkencave mjekësore, duke ofruar programe në të tre ciklet e studimit: bachelor, master dhe programe të specializimeve afatgjatë. Universiteti Aldent aktualisht përbëhet nga 3 Fakultete,



9 departamente dhe ofron 13 programe, në të cilat studjojnë rreth 1700 studentë. Me kampusin e ri universitar, UAL ofron për studentët, personelin dhe bashkëpunëtorët e vet, më shumë hapësira, lehtësira dhe shërbime cilësore, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së institucionit. Programi i studimit Specializues afatgjatë (SPA) në Stomatologji, me profilet Kirurgji orale dhe Ortodonci, është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 299, me datë 22.07.2013 me kohëzgjatje 3 vjeçare. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Laborantëve Dentarë, Fakulteti i Shkencave Dentare. Programi i studimit është akredituar sipas Urdhërit Nr. 112, datë 11.03.2016 të MAS, në bazë të Vendimit Nr. 126, datë 18.02.2016 të Këshillit të Akreditimit.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Programi i studimit Specializues afatgjatë (SPA) në Stomatologji me profilet Kirurgji orale dhe Ortodonti, është akredituar me Urdhër të MAS Nr. 112, datë 11.03.2016, bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 126, datë 18.02.2016. Referuar këtij vendimi Këshilli i Akreditimit **nuk ka lënë rekomandime** për këtë program studimi.

Universiteti Aldent është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 18.05.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 56/5 Prot, datë 18.05.2022. Universiteti Aldent përcjell në ASCAL më datë 24.05.2022, me anë të shkresës me Nr. 28/1 Prot, datë 24.05.2022 “Kthim përgjigje për programin e studimit Specializim Afatgjatë në Stomatologji me profile: Kirurgji Orale dhe Ortodonti”.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

Pasi u njohëm me komentet e Universitetit Aldent lidhur me Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm për programin e studimit: Specializim Afatgjatë në Stomatologji me profile Kirurgji Orale dhe Ortodonci, RVJ, në cilësinë e ekspertëve të jashtëm të vlerësimit të këtij programi sqarojmë dhe argumentojmë sa më poshtë:

1. Konstatimi i GVJ-së në Draft RVJ: Fusha 1, vlerësimi sipas standardeve, fq 11:

“Mendojmë se në këtë drejtim institucioni ka nevojë të përmirësojë pjesëmarrjen në lidhje me sasinë e punimeve që duhet të kryejnë specialistët. Është një praktikë e huazuar nga programet italiane të vitit 2005, të cilat vetë italianët i kanë konsideruar të tepërta dhe i kanë ripunuar në vitin 2015”

Komenti i UAL: Mendojmë se duhet parë mundësia që ky paragraf të hiqet, mbasi nuk lidhet me standardet për të cilat diskutohet.

Përgjigja e GVJ mbi komentin:

GVJ, pasi rishikoi RVJ, është dakord me institucionin, që duhet hequr ky paragraf në fq 11 të Draft RVJ. Por në fushën 10, Vlerësimi sipas standardeve fq 94 (pas paragrafit të parë) të shtohet, referuar evidencave bashkëlidhur RVB-së, mendojmë se institucioni ka nevojë të përmirësojë pjesëmarrjen e specialistëve në lidhje me punimet kërkimore shkencore.

Raporti në këtë pikë ndryshohet.

(Prubus) *gy*

2. Konstatime të GVJ në Draft RVJ: Fusha 7, pjesa përshkrimore, fq 62 dhe vlerësimi sipas standardeve, fq 68:

Në faqen 62 dhe 68 konstatime të GVJ (që janë për të njëjtin argument):

Përsa i përket shpërndarjes së krediteve në lëndë të ndryshme mendojmë se ka akoma vend për të diskutuar dhe për të bërë përmirësime. Në disa lëndë të formimit të përgjithshëm mjekësor janë caktuar po aq kredite sa në disa lëndë të karakterit specifik, psh. lëndët Anatomia Patologjike dhe Sëmundje të Brendshme kanë nga 6 kredite, po aq sa ka dhe Kirurgjia Orale, që është lëndë kryesore e këtij profili (Kirurgji Orale). Nga ky këndvështrim mendojmë se ka rëndësi që shpërndarja e krediteve të ripunohet e përmirësohet më tej.

Programi përmban lëndë karakterizuese që kanë një numër të konsiderueshëm kreditesh, për këtë arsye mendojmë se duhet të rishihen këto lëndë, për të ulur numrin e krediteve në dobi të praktikave, brenda hapësirave që lejon ligji dhe janë në përputhje me Ligjin për Profesionet e Rregulluara dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, KSHK, fq 68.

Komenti i UAL, për paragrafin në fq 62: Profili kirurgji orale ka disa lëndë bazë dhe si më kryesoren Kirurgjinë Dentoalveolare, aq sa në disa vende profili nuk quhet Kirurgji Orale, por kirurgji Dentoalveolare. Në draft RVJ fq 60, ku jepet plani mësimor i profilit Kirurgji Orale ku janë të përfshira dy lëndë: **Kirurgji Dentoalveolare 1 dhe 2** të cilat së bashku kanë **22 kredite**, që së bashku me **6 kredite** të Kirurgjisë Orale rezultojnë **28 kredite në total për lëndët kryesore të profilit Kirurgji orale**. Po në këtë grup lëndësh përfshihen edhe lëndë të tjera karakterizuese si **Implantologjia 1 dhe; Paradontologjia**, etj, të cilat janë pjesë integrale e Kirurgjisë orale. Të gjitha këto lëndë karakterizuese përbëjnë **60% të ngarkesës mësimore të shprehur në kredite**, në përputhje me legjislacionin në fuqi për këto lloj programesh.

Përgjigjja e GVJ mbi komentin:

Përsa i përket lëndëve të Anatomisë Patologjike dhe Sëmundje të Brendshme (secila me 6 kredite) sqarojmë se, ndërtimi i programit të studimit që ofron UAL, është bërë mbështetur në vëzhgimet tona të drejtpërdrejta (raste klinike) dhe të literaturës të kolegeve tanë dhe të Universiteteve me të cilat bashkëpunojmë. Si rezultat është konstatuar se ka një shtim të theksuar të rasteve me gjendje prekanceroze, sidomos në moshat me të cilët punojnë më së shumti kirurgët oralë. Në këto kushte, lëndët e sipërcituara kanë një rëndësi të veçantë në formimin e specializantit, pasi i shërben atij në diagnostikimin/kapjen që në fazat e hershme të këtyre sëmundjeve, marrjen korrekte të biopsive, si dhe interpretimin sa më adekuat të analizave histopatologjike.

Gjithashtu, kirurgëve oralë ju duhet shpesh herë të bëjnë ndërhyrje invazive, sidomos në rastin e implanteve të shumta në një seancë, heqjen e kisteve të nofullave, apo në ndërhyrje paradontologjike të mëdha. Kirurgu oral në të gjitha rastet që trajton duhet të jetë në gjendje të përcaktojë kufijtë e tij, sidomos në pacientë që janë me diabet, pacientë me sëmundje të ndryshme kardiovaskulare, pacientë që trajtohen me antikoagulantë, kortizonikë, etj. Nëse një kirurg oral nuk njeh mirë lëndën e sëmundjeve të brendshme, mund të ndodhet para komplikacioneve të rënda, ndonjëherë edhe fatale, siç edhe kanë ndodhur në raste të ndryshme. Bazuar në argumentet e mësipërm, mendojmë se heqja e një apo dy krediteve këtyre lëndëve nuk do të ndryshonte/përmirësonte programin e studimit në fjalë, përveçse do të shtonte përqindjen e lëndëve karakterizuese, gjë që do na çonte në mos zbatim korrekt të legjislacionit në fuqi dhe të deklaratës së Bolonjës për kreditet përkatëse sipas fushave specifike.

Komenti i UAL, për paragrafin në fq 68: Programi, siç është cituar dhe më lart dhe në Draft RVB, përmban lëndë karakterizuese, aq sa përcaktohet nga legjislacioni në fuqi për këto programe. Programi specializim afatgjatë në Stomatologji me profile, përmban rreth 800 orë praktika klinike, nga të cilat 600 orë të përcaktuara si Praktika Klinike 1, 2 dhe 3; dhe 200 orë praktika klinike që kryhen gjatë zhvillimit të lëndëve karakterizuese (shih planin mësimor).

(Preston) *Juy*

Orët totale të praktikave klinike (800 orë) janë konsideruar më se të mjaftueshme nga stafi akademik i UAL, kjo dhe nga konsultimet me stafin e ftuar nga universitete të njohura europiane, të cilët kanë konstatuar se lëndët, kreditet dhe orët e praktikës janë të ngjashme, natyrisht duke ruajtur veçoritë e secilit vend.

Përgjigja e GVJ mbi komentet:

GVJ referuar argumenteve të UAL, por dhe gjykimit tonë, mbështetur në aktual 80/2015 për Arsimin e Lartë, neni 35 pika 1, i cili lejon institucionet që të ndryshojnë deri në 20% të përmbajtjes së planit mësimor të shprehur në kredite, mendojmë se përditësimi i një programi studimi mbas një fare kohe të funksionimit të tij në përgjithësi është i nevojshëm. Prandaj, në fq 62 në vend të paragrafit të mësipërm të ndryshohet si më poshtë:

Institucioni të shohë mundësinë e rritjes së krediteve të lëndëve specifike, apo të praktikave klinike, sipas vlerësimit nga vetë UAL dhe për atë që sa e lejojnë kufizimet e akteve ligjore dhe nënligjore për këto lloj programesh.

Ndërkohë, paragrafi i faqes 68 në draft raport, në raportin përfundimtar do të hiqet, mbasi mendimi ynë është shprehur më sipër me ndryshimin e formulimit të paragrafit në faqen 62.

POLITIKAT E DREJTIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË STUDIMEVE TË SPA


1. Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e programit të studimit, mësimdhënia dhe kërkimi shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshatja e objektiveve dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për programin e studimit (Programi i studimit është përshatur me strategjinë për zhvillim të institucionit; Përmbatja e programit të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi).

Misioni i Programit Specialistik të Kirurgjisë Orale dhe Ortodoncisë është të arsimojë dhe mbështesë studentët, që kur të diplomojnë, të kenë cilësi dhe kompetenca profesionale të definuara dhe të përcaktuara, me njohuri të detajuara në disiplinat e lartëcekura, me qëllim që nëpërmjet përgatitjes kompetente teorike dhe praktike, të kontribohet në avancimin e ofrimit të shërbimeve të mbrojtjes të shëndetit oral, rehabilitimit të pacientëve dhe njëkohësisht të shëndetit të përgjithshëm dhe mirëqenies të popullatës.


Programi i studimit të Universitetit Aldent ka si qëllim të përgatisë specialistë të fushës së Stomatologjisë në profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonti, me formim të plotë teoriko-praktik, të cilët aftësohen për të punuar brenda vendit dhe jashtë tij. Qëllimi i këtij programi studimi është përgatitja e specialistëve në profilet e mësipërme, të aftë që t'i përgjigjen kërkesave dhe nevojave aktuale, të cilat janë gjithnjë në rritje dinamike, si nga pikpamja sasiore, ashtu edhe ajo cilësore. Ky program studimi afatgjatë plotëson një boshllëk, që ka ekzistuar për një kohë të gjatë në shërbimin tonë dentar, pasi strukturat tona shtetërore nuk kanë bërë më parë specializime në fushën e Ortodoncisë (akoma edhe aktualisht), një profesion i domosdoshëm ky për mjekimin e anomalive të dhëmbëve dhe nofullave, kryesisht tek fëmijët. Nevojat për trajtim ortodontik në vendin tonë janë gjithnjë në rritje, ndërkohë që numri i specialistëve është tepër i vogël. Kjo ka sjellë një diskordancë të madhe të mbulimit të këtij shërbimi kaq të

Practus 

rëndësishëm. Po ashtu, specializimi i Kirurgjisë Orale është i domosdoshëm në praktikën stomatologjike, mbasi edhe në këtë shërbim ka një numër të pakët specialistësh. Fakulteti i Mjekësisë Dentare, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, përgatit vetëm specialistë në nivelin e Kirurgjisë Oro-Maksilo-Faciale (OMF), çka kërkon afate më të gjata studimi dhe kryen ndërhyrje shumë të ndërlikuara e në kushte spitalore. Ndërkohë, që përqindja më e lartë e nevojave të shërbimit tonë në profilin e Kirurgjisë, janë për ndërhyrje në nivelin e gojës e të dhëmbëve; dhe këtë e mbulon specialisti i Kirurgjisë Orale. Ky program studimi përgatit specialistë të fushave të cekura më lartë, mbështetur mbi bazën e përvojës së arsimit mjekësor shqiptar dhe të përvojës të disa universiteteve të njohura në Europë, kryesisht atyre italiane. Specialistët e përgatitur me këtë program studimi, mbas diplomimit do të kenë njohuritë e nevojshme mbi bazat e anatomisë e fiziologjisë së organizmit të njeriut, sistemin orofacial dhe strukturat që e plotësojnë në tërësi. Ata do të fitojnë njohuritë e duhura edhe mbi sëmundjet kryesore të kavitetit të gojës, ndryshimet anatomo-patologjike, që ndodhin gjatë çrregullimeve në zhvillim, profilaksinë, diagnostikimin e hershëm të sëmundjeve, që mund të zhvillohen në gojë, të cilat rrezikojnë jetën e njerezve, sidomos gjendjet prekanceroze e tumorale, planifikimin terapeutik e mjekimin adekuat në kohën e duhur të tyre. Në rastet kur është e nevojshme, këto profile do të jenë të afta të bëjnë udhëzimin dhe rekomandimin tek specialistë të tjerë të fushave përkatëse. Ata do të jenë të aftë që në nivelin e duhur të përshkruajnë preparatet/medikamentet e nevojshme që përdoren për mjekimin e patologjive të gojës, dozat korrekte, mekanizmin e veprimit të tyre, si dhe efektet anësore që këto medikamente mund të japin në organizmin e njeriut. Këta specialistë do të jenë të aftë për t'ju përgjigjur kërkesave të larta estetike e funksionale, që kanë sot pacientët tanë, sidomos në fushën e anomalive të dhëmbëve e të nofullave, në përgatitjen e aparateve të lëvizshme dhe sidomos atyre fikse, të cilat kanë filluar të përgaditen kohët e fundit edhe te ne dhe për të cilat nuk kemi pasur eksperiencën e duhur në të kaluarën. Të diplomuarit në këtë program marrin edhe njohuri speciale mbi:

- metoda dhe teknologji bashkëkohore të trajtimit si Implantologjia dhe Kirurgjia ortognatike;
- teknikat me aparatura moderne të nivelit të shkencës së sotme europiane e botërore;
- metodat e nevojshme menaxheriale për të organizuar e drejtuar punën në njësitë e tyre ku ushtrojnë profesionin, por edhe në kolektiva më të mëdha, duke kombinuar njohuritë profesionale me ato të marketingut profesional;

Specialistët e këtij program studimi marrin edhe informacionin e duhur për të mos qenë vetëm mjekë të profilit të tyre, por edhe vëzhgues të vëmendshëm të rasteve, njohës të patologjive të reja, përgjithësues të fenomeneve dhe ekspertë të kërkimit shkencor, një drejtim ky i domosdoshëm për specialistët tanë për të bërë të mundur evidentimin e dukurive dhe fenomeneve shëndetësore te ne, veçoritë që ata kanë, frekuencën dhe prognozën e tyre, dekursin dhe mjekimin e suksesshëm të tyre. Ky program specializimi afatgjatë është hartuar jo vetëm sipas kërkesave të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, të udhëzimeve të MASH për arsimin mjekësor shqiptar, por është harmonizuar edhe me kërkesat e legjislacionit europian për shëndetësinë. Ky program është hartuar edhe konform direktivës no. 2005/36/EC të Këshillit të Parlamentit Europian dhe akteve të tjera, që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Programi i specializimit afatgjatë në Kirurgji Orale dhe Ortodonci që

Practica 

ofron Universiteti Aldent shkon në harmoni edhe me rritjen numerike të specializimeve të ne, si dhe me mënyrën e organizimit të shërbimit stomatologjik në Shqipëri.

Universiteti Aldent ka përcaktuar strategji të qarta afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë për realizimin e misionit të tij në fushën e specializimeve afatgjata.

Strategjia afatshkurtër lidhet me konsolidimin e mëtejshëm të këtij programi studimi që është i aktivizuar që në vitin 2014; verifikimin e saktë të nevojave të specializantëve; kërkesat e tyre specifike sipas specializimit dhe ato preferenciale për aparatura e disiplina ku kanë interes të veçantë. Në strategjinë afatgjatë, Universiteti ka parashikuar koordinimin efikas midis këtyre programeve të studimit, që i ofrojnë tregut të punës specialistë të mirëfilltë të fushave të veçanta, si dhe studimin e tregut të punës për specializime në fusha të tjera, krijimin gradual të kushteve e të mundësive për ta edhe në programe të tjera si parodontologjia, patologjitë e mukozave të gojës etj. Kjo realizohet duke shfrytëzuar aktivitete e mjedise të përbashkëta, praktika klinike e laboratorike të përbashkëta për të përvetësuar reciprokisht probleme specifike të specializimeve të njëri tjetrit dhe për të mos pasur ndarje fikse ndërmjet specialistëve, pasi edhe praktika mjekësore nuk është e ndarë në një formë të tillë, por shpesh problemet lidhen e ndërthuren me njëri tjetrin dhe qëndrimi ndaj tyre duhet të jetë kompleks e i plotë. Qasja e kombinimit të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies është adoptuar, që e bën të mundshme për studentët që të identifikojnë dhe përdorin përvojën e tyre, shkathtësitë dhe njohuritë që më së miri i avancojnë ata në procesin mësimor. Kështu, kurrikulumit i këtij programi do të lehtësohet nga metodat kryesore, si:

Të mësuarit e mbështetur në ligjerata: Një ambient me diskutim interaktiv do të krijohet për të shpjeguar aspektet teorike të shkencave shëndetësore, menaxhimit, ligjit, ekonomisë dhe kontekstit organizativ. Qëllimi është që të krijohet një ambient mbështetës në klasë, ku studentët do të marrin feedback dhe të mësojnë nga përvoja dhe njohuritë e studentëve tjerë dhe ligjëruesit.

Të mësuarit e mbështetur në probleme: Studentët do të punojnë në grupe të vogla që të ekzaminojnë historitë e rastit. Ideja është që studentët të punojnë bashkarisht në një ekip në mënyrë që të arrijnë të dyja, edhe të mësuarit e subjektit edhe transferimin e shkathtësive në punën grupore. Kjo metodë vë theks të veçantë në të mësuarit e vetërregulluar të mbështetur nga udhëzimet, ku të kuptuarit është përforcuar nëpërmjet aplikimit në problemin, detyrën apo përvojën e punës.

Të mësuarit e mbështetur në praktikë: Programi do të ofrojë mundësi për studentët që të marrin përgjegjësi dhe punë në një ambient të kujdesit shëndetësor si anëtarë të ekipeve me mbikëqyrje nga mësimdhënësit. Gjatë fazës praktike studentët do të mësojnë për modelet e menaxhimit në mjediset e kujdesit shëndetësor dhe do të trajnohen që të përdorin teorinë dhe konceptet për të kuptuar dhe reflektuar në mënyrë kritike gjatë praktikës.

Të mësuarit reflektiv: Inkurajimi i studentëve dhe ekipeve që të reflektojnë në aktivitetet dhe proceset e punës së përbashkët, me fokus në përdorimin e shërbimeve të kujdesit, mund të zhvillojë kuptimin e rolit dhe vlerave të profesioneve tjera.

Të mësuarit e mbështetur në hulumtim: studentët do të fitojnë një kuptim të thellë të metodologjisë së hulumtimit dhe do të marrin pjesë në projektet hulumtuese të realizuara nga Universiteti Aldent.

Prubus. duj

Vlen të theksohet se i rëndësishëm në aspektin e përgjithshëm, është bashkëpunimi multidisiplinar, aq i domosdoshëm dhe i vlefshëm në shërbim të pacientit.

Programi i specializimit afatgjatë ka raport të rregullt midis leksioneve e praktikave në salla e laboratore, me diskutime të rasteve e zgjidhje të tyre me protokolle të qarta, gjë që u konsiderua mjaft efektive edhe nga vetë studentët pavarësisht ndikimit që ka pasur pandemia Covid -19 në 2 vitet e fundit. Programi SPA ka parashikuar edhe kreditet e nevojshme që studentët fitojnë në praktikat profesionale, të cilat zhvillohen në të tre vitet e studimit dhe i aftësojnë ata për punët që do të kryejnë në të ardhmen. Gjatë hartimit të tij, programi është konsultuar edhe me programet e disa universiteteve të huaja që përgatisin specialistë të këtyre fushave, sidomos me ata në Itali, Spanjë etj, prej nga vijnë çdo 2 javë edhe pedagogë, që japin mësim e sjellin përvojën e tyre mësimdhënëse e shkencore. Programi tashmë është konsoliduar dhe plotëson një nevojë të madhe të shërbimit stomatologjik të vendit për specialistë të fushave të rëndësishme të tij, si Kirurgjia Orale dhe Ortodoncia, të cilët ose kanë munguar më parë, ose kanë qenë në numër fare të vogël e të përgatitur jashtë vendit, por që nuk mund të përballonin nevojat e shërbimit. Tashmë Universiteti Aldent ofron një infrastrukturë të plotë nga më modernet në vend, për përgatitjen e studentëve të ciklit të tretë. Aktualisht, operohet në 3 salla kirurgjikale të pajisura me aparaturat dhe instrumentariumin e nevojshëm, si dhe në kabinetet laboratorike për temat e laboratoreve. Sallat kirurgjikale janë të pajisura me aparatura moderne në fushën e Kirurgjisë Orale si *kamera operatore Ekler, aparati i grafisë intraorale dhe panoramex, bisturia piezo-elektrike, laseri, centrifuga, motori kirurgjikal i vendosjes të implanteve, mikroskopi si dhe së fundmi aparatura e sedacionit koshient*. Sallat operatorive janë të plotësuara me instrumentariumin e nevojshëm kirurgjikal, me kite të plota për ndërhyrje kirurgjikale si *sinus lifting, kirurgji paradontale, kiti i fiksimit dhe stabilizimit të membranave në GBR (guided bone regeneration) dhe kite kirurgjikale të përgjithshme*. Kabinetet laboratorike janë të pajisura me sisteme kompjuterike dhe ofrojnë mundësinë e laboratoreve dixhitale në Kirurgji Orale dhe në Implantologji. Institucioni bashkëpunon me firma të njohura të Europës dhe më gjerë në tregun e materialeve dhe aparatave mjekësore bashkëkohore, me të cilat ka bërë të mundur furnizimin ritmik e të mjaftueshëm me të gjithë preparatet dhe pajisjet e tjera të shërbimit stomatologjik, në sasinë e kualitetin e nevojshëm, shoqëruar këto me çertifikatën e cilësisë dhe të origjinës së produkteve dhe instruksionet e përdorimit të tyre. Kohëzgjatja e studimit në tre vite mendojmë se është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të na dhënë edhe specialistë të përgatitur, por brenda një afati optimal që i vijnë në shërbim tregut relativisht shpejt duke plotësuar nevojat e tij. Kohëzgjatja e programit të studimit është e ngjashme me thuajse të gjitha vendet europiane si Itali, Gjermani, Francë, Spanjë, etj. Ndërkohë, afati i studimeve prej katër vjetësh ofrohet në profile të tjera si ai i Kirurgjisë OMF, ku ka gamë më të gjerë ndërhyrjesh të një shkalle vështirësie më të lartë dhe që kryhen në institucione me shtretër.

Në zhvillimin dhe plotësimin e programit angazhohet personel akademik e mjekësor mjaft i kualifikuar, specialistë me përvojë të gjatë dhe kualifikime të nevojshme. Disa specialistë të huaj të një niveli mjaft të lartë shkencor e mësimdhënës, vijnë periodikisht, japin leksione e drejojnë praktika, organizojnë e udhëheqin tema studimore dhe janë pjesë e stafit mësimor. Përgatitja me nivel të mirë të specialistëve në UAL, bëhet e mundur edhe për faktin se krahas kushteve të krijuara, është grumbulluar edhe një përvojë e mirëmësimdhënieje, pasi ai funksionon si shkollë e lartë që nga viti 2006 dhe kjo përvojë pozitive po pasurohet me ritme të shpejta. Emërtimi i


Prutina

programit të studimit është në përputhje me Kornizën Shqiptare të kualifikimit. Programi përfshihet në ciklin e tretë të studimeve, në specializime afatgjata në Stomatologji me profile:

- Profili Kirurgji Orale
- Profili në Ortodonci


Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
STANDARDI I - SYNIMET DHE QËLLIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT, KUADRI I PËRGJITHSHËM	
Standardi I. 1- Programet e studimeve specializuese afatgjata në mjekësi ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi: misioni dhe qëllimi i tyre është shprehur qartë.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të specializimeve afatgjata është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka një mision të qartë për programet e studimit që ofron.</p> <p>Kriteri 3 Qëllimi i programit të studimit dhe rezultatet që priten janë të qarta.</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimit mbështeten mbi objektiva të qartë profesionale dhe janë të integruar me veprimtaritë klinike.</p> <p>Kriteri 5 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimeve.</p>	<p>Përmbajtja e programit të ciklit të tretë, SPA në “Stomatologji” me profile, Kirurgji Orale dhe Ortodonti, është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit Nr.80/2015 “Mbi arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në R.SH”, konkretisht me pikën 9 të nenit 35 të këtij ligji.</p> <p>Ky program studimi është hartuar dhe plotëson kërkesat ligjore dhe të akteve nënligjore që rregullojnë arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë e module dhe vlerësohet me Kredite ECST sipas sitemit vendas dhe atij European të vlerësimit dhe transferimit të tyre, IAL, ka një mision të qartë për këtë program studimi të ciklit të tretë që ka ofruar. Qëllimi i hapjes dhe realizimit të programit, si dhe objektivat e tij janë të qarta dhe të detajuara dhe krijojnë besueshmëri në realizimin e plotë të tyre. Programi i studimit është hartuar dhe po implementohet sipas standarteve dhe kërkesave të arsimit të lartë shqipëtar dhe të atij European dhe synon të jetë i krahasueshëm me të. Ai ka si synim që t’ju përgjigjet kërkesave dhe nevojave të tregut të punës në vendin tonë; por që kandidatët që kryejnë këtë program të SPA, të jenë të aftë për të kryer edhe detyrën e specialistit në nivel European nëse është e nevojshme. Programi merr parasysh</p>


Practica 

	<p>zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, karakterin kombëtar të arsimit shqiptar dhe ruan e zhvillon vlerat kulturore të kombit tonë. Qëllimi i këtij programi studimi është i qartë. Ai synon të përgatisë Specialistë të aftë e të mirëinformuar në fushën e Kirurgjisë Orale dhe Ortodoncisë, që të jenë të gatshëm profesionalisht për të përballuar kërkesat e tregut të punës, si në shërbimin stomatologjik publik ashtu edhe në atë privat. Ky program synon gjithashtu, që specialistët e përgatitur, të zotërojnë jo vetëm kompetenca të plota profesionale në nivelin e specialistit të fushës, por edhe në nivel të lartë të bashkëpunimit e bashkëveprimit të punës në ekip dhe të raporteve të etikës mjekësore, me pacientët dhe me kolegët e bashkëpunëtorët e tjerë. Të gjitha masat organizative janë marrë që këto synime të realizohen dhe rezultatet e pritshme të këtij programi studimi jo vetëm janë hartuar qartë, por edhe zotërojnë premisat e plotësimit të plotë të tyre. Emërtimi i programit të ciklit të tretë SPA në “Stomatologji”, me profile Kirurgji Orale dhe Ortodonci, është i drejtë dhe i përligjur për informacionin profesional e shkencor që ai përmban dhe i përket nivelit 8 në kornizën shqiptare të kualifikimit.</p> <p>Emërtimi dhe kohëzgjatja e programit të studimit përputhen me “Standardet e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të tretë “Specializime Afatgjata” miratuar me VKM Nr. 824, datë 24.12.2021</p> <p><i>Rregullore programi studimi.pdf;</i> <i>Analizë punësimi Specializantët.pdf;</i> <i>Statuti i UAL.pdf)</i> <i>Rregullore e Universitetit ALDENT.pdf;</i> <i>Rregullore e Fakultetit të Shkencave Dentare (për firmë Dr Diana , Agroni) .pdf;</i></p>
<p>Standardi I. 2- Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Programi i specializimit afatgjatë përfshin formim teorik e praktik në fushën e specialitetit, i cili realizohet njëkohësisht në një universitet të akredituar, dhe në një institucion spitalor</p>	<p>Ky program studimi, ofrohet nga Universiteti Aldent, i cili është një institucion i akredituar për 5 vite, me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 114, datë 15.12.2017.</p>

Prabh...



<p>ose në një institucion shëndetësor të aprovuar dhe akredituar për këtë qëllim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe Ministria e Shëndetësisë (MSH) pasi është marrë mendimi i Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore.</p> <p>Kriteri 2 Programi i specializimit afatgjatë kryhet me kohë të plotë dhe përfshin pjesëmarrjen në veprimtaritë mjekësore të departamenteve ose shërbimeve ku ofrohet formimi, në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe nën mbikqyrjen e autoritetit apo entit përgjegjës.</p>	<p>Referuar përmbatjes dhe syllabuseve të lëndëve të këtij programi studimi, GVJ konstaton se ai ofron dije teorike dhe praktike për studentët. Dijet dhe aplikimet praktike, përveç ambjenteve të cilat vetë Universiteti Aldent vendos në dispozicion, zhvillohen edhe në ambiente të tjera me të cilat universiteti ka marrëveshje, siç janë: Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Qendra spitalore Nënë Tereza Tiranë, Spitali i Traumës, laboratorët kirurgjikalë të Dental Lider Corsi, etj. Ky program studimi, ofrohet me kohë të plotë dhe përfshin krahas formimit teorik bashkëkohor edhe pjesëmarrjen në veprimtaritë mjekësore, të cilat kryhen në Institucionin që realizon programin, por edhe në Institucionet mbështetëse me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, sipas procedurave dhe protokolleve mjekësore të aprovuara dhe që janë në zbatim në veprimtarinë e tyre. Për këtë qëllim janë ngarkuar udhëheqës praktikë dhe tutorë, që janë specialistë në Stomatologji.</p> <p><i>Plani mësimor.pdf V1.pdf; V2.pdf; V3.pdf; Marrëveshjet e bashkëpunimit.</i></p>
<p>Standardi I. 3- Programet e studimeve janë eficientë, në përputhje me misionin institucional.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni bën një planifikim institucional efikas dhe kryen përmirësime të ndjeshme për realizimin e qëllimeve dhe rezulton se programi ka arritje të mira.</p>	<p>Programi është hartuar dhe zbatohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e këtij institucioni, qësynon thellimin dhe perfeksionimin e njohurive të mjekëve stomatologë të diplomuar në nivelin e dytë të studimeve universitare, në fusha të veçanta, përkatësisht në Kirurgji Orale dhe Ortodonci.</p> <p>SPA ka filluar për herë të parë në vitin 2014 dhe është akredituar në vitin 2016. Gjatë gjithë kësaj periudhe, personeli akademik e mjekësor i Universitetit, ka arritur të përmirësojë performancën e vet në funksion të realizimit të programit, duke rritur cilësinë e shërbimeve në formimin teorik dhe atë praktik-klinik. Përmirësime janë kryer në aspektin infrastrukturor, ndërkohë që prezenca e pandemisë Covid-19, ka limituar pjesëmarrjen e studentëve në veprimtari kërkimore e shkencore brenda dhe jashtë vendit.</p>

Practus 


	<p><i>Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.pdf;</i> <i>Planimetri Kampusi i ri.pdf;</i> <i>Planimetritë Kampus A+B .pdf</i></p>
<p>Standardi I. 4- Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare dhe integrojnë kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë përshtaten në strukturë me programet homologe të zhvilluara në vendet europiane.</p>	<p>Programi i studimeve për specializime afatgjatë në stomatologji, me profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonci, është përshtatur në strukturë dhe në modalitete të organizimit me programe të ngjashme të nivelit European. Së pari kjo përafërsi vjen nga përmbajtja e vetë kurrikulës së studimit që po realizohet në këtë fushë. Për hartimin e saj janë marrë përvojat e përparuara të disa Universiteteve të Europës, kryesisht ato të Italisë, me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi që janë efektive. Këto marrëveshje më konkretisht janë lidhur me Universitetin e Chieti-Pescara, Universiteti i Aquilas dhe spitalin S. G. Monastier, Treviso të Italisë. Ndërkohë mjaft bashkëpunime zhvillohen edhe me institucionet brenda vendit, në mënyrë që të gjitha programet të jenë të unifikuara në përmbajtjet tyre.</p> <p><i>Marrëveshjet e bashkëpunimit;</i> <i>Plani mësimor.pdf</i></p>
<p>Standardi I. 5- Programet e studimeve ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë synojnë të plotësojnë kërkesat e tregut të punës në përputhje me nevojat për specialistë në fushën e mjekësisë.</p> <p>Kriteri 2 Numri i përgjithshëm i specializantëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo vit përcaktohet në përputhje me politikat shtetërore të zhvillimit të fushës së shëndetësisë dhe kapacitetet pritëse të strukturave të përfshira në rrjetin formues (në varësi të numrit të personelit, kapaciteteve pritëse, etj).</p>	<p>Programi i studimeve për specializime afatgjatë në stomatologji, me profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonci, është hapur bazuar në kërkesat e tregut të punës për specialistë në këto profile. Programi jo vetëm plotëson nevojat e tregut të vendit, por jep një kontribut të vyer edhe në rajon, mbasi ka specializantë dhe nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, etj. Në këtë drejtim, hapja e këtij programi studimi konsiderohet si një kontribut i madh publik në fushën e dentistrisë në vend dhe në rajon. Aktualisht në UAL janë të regjistruar dhe frekuentojnë rregullisht studimet në SPA 64 specializantë, prej të cilëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 38 studentë në Kirurgji Orale; - 26 studentë në Ortodonci;

Prachur

[Signature]

	<p>të cilët parashikohet që të diplomohen dhe të marrin titullin e specialistit të lëmisë përkatëse në vitin 2023. E veçanta e programit qëndron në faktin që ai hapet në çdo 2-3 vjet, çka shkon në harmoni me nevojat e tregut të punës për specialistë, sikurse dhe i jep mundësi institucionit që të menaxhojë më mirë stafin e tij dhe të huaj, labororet dhe klinikat në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Infrastruktura e re e vënë në dispozicion pas ndërtimit të kampusit të ri dhe personeli akademik janë të mjaftueshme jo vetëm për të garantuar cilësinë e veprimtarive akademike për numrin aktual të studentëve, por edhe për rritjen e mëtejshme të tyre në të ardhmen. (Shtojca nr. 10). <i>Planimetritë e godinave A+B, kampusi i ri.</i></p>
<p>Standardi I. 14- Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine, materiale mësimore të hartuara dhe të botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj.</p>	<p>Universiteti Aldent ka një sistem të integruar të përdorimit të teknologjisë, duke përfshirë në të disa shërbime si ai i sekretarisë, mësimdhënies në distancë, faqe të revistës shkencore, faqen zyrtare të konferencës së institucionit ICMS, faqen zyrtare të UAL si dhe është mjaft aktiv në rrjetet sociale.</p> <p>Institucioni publikon në mënyrë të vazhduar informacion objektiv e me të dhëna konkrete. Universiteti publikon rregullisht broshura, materiale mësimore të hartuara dhe të botuara për vlerësimin e brendshëm dhe pasqyron të dhëna kryesore e të detajuara mbi gjendjen e aktivitetin e tij gjatë vitit akademik. Faqja e internetit luan një rol të rëndësishëm për shpërndarjen e informacionit për studentët dhe gjithë të interesuarit e tjerë që lidhet me kushtet, kriteret e pranimit e të regjistrimit, mirëfunksionimin e procesit mësimor, të dhëna për stafin, mjediset, infrastrukturën etj. Sekretaria mësimore është në dispozicion të studentëve për të dhënë informacion sa herë ju kërkohet dhe në mënyrë të vazhduar. Veçanërisht, rol të rëndësishëm ka luajtur kjo faqe gjatë pandemisë, ku nëpërmjet saj është bërë e mundur komunikimi dhe lidhja me</p>

Prachas



sistemet e tjera që institucioni disponon. UAL disponon sisteme menaxhimit të brendshëm *fx-education* dhe sistemin online-education (UAL-LMS), nëpërmjet të cilit është zhvilluar mësimdhënia gjatë pandemisë ose trajnimet dhe diskutimet me personelin e huaj, informimi për oraret, datat e provimeve, eventet e ndryshme, ceremonitë, aktivitete shkencore dhe çdo gjë që ai ka ineres. Të dhënat që lidhen me aktivitetin e çdo studenti të veçantë kanë karakter konfidencial. Po ashtu, ky sistem mundëson nëpërmjet një fjalëkalimi personal, aksesin në llogarinë e sekretarisë mësimore, ku studenti gjen gjithëka që ka lidhje me të, si provimet që duhet të japë, notat e tyre, shumën e krediteve të fituara, detyrimet akademike e financiare etj.

(Shtojca nr.8: Print screen, aksesi në platformën online për stafin dhe studentët)


Konkluzionet e vlerësimit:

Programi SPA në Stomatologji me profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonci në Universitetin Aldent është hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015, të akteve nënligjore dhe në funksion të zbatimit të misionit dhe objektivave të vetë institucionit. UAL ka në strategjinë e vet të zhvillimit të institucionit, përmirësimin e metodave të mësimdhënies e mësimnxënies, pajisjen e kandidatëve me dije shkencore bashkëkohore dhe shprehë praktike të nivelit kombëtar dhe europian, hapjen e degëve të reja dhe zgjerimin e gamës së studimeve në këtë IAL.

Programi i studimit synon të përgatisë specialistë të aftë e të mirëinformuar në fushën e Kirurgjisë Orale dhe Ortodoncisë, që të jenë të gatshëm profesionalisht për të përballuar kërkesat e tregut të punës, si në shërbimin stomatologjik publik ashtu edhe në atë privat.

Emërtimi dhe kohëzgjatja e programit të studimit përputhen me “Standardet e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të tretë “Specializime Afatgjata”, miratuar me VKM Nr. 824, datë 24.12.2021

Struktura e programit, përmbajtja, zhvillimi e monitorimi përmirësohen vazhdimisht për t’u përshtatur sa më mirë me kërkesat e kohës dhe të zhvillimit shkencor në stomatologji. Hapja çdo dy-tre vjet është gjithashtu në përputhje me nevojat e tregut dhe rrit mundësinë e përdorimit më racional të burimeve njerëzore, klinike dhe laboratorike.

Prubus 

2. Struktura akademike e Fakultetit që ofron SPA

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Vendi që zë Fakulteti, që ofron SPA në organigramën e IAL (Universiteti, Fakulteti / Departamenti), të dhëna për personelin akademik përgjegjës për specializimin afatgjatë, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE), Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), koordinimi i mësimdhënies me njësi të tjera.

Universiteti Aldent që ofron këtë program studimi, SPA në Stomatologji me profilet: Kirurgji Orale dhe Ortodonci, përbëhet nga organet drejtuese, autoritetet drejtuese, njësitë bazë me karakter mësimor e shkencor dhe nga administrata e tij. Funksionimi i të gjithë veprimtarisë pedagogjike, administrative, vendimmarrëse dhe kërkimit shkencor, gjenden në rregulloren e fakultetit (*Rregullore e Fakultetit të Shkencave Dentare*). Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Shkencave Dentare. Ky Fakultetet ka në përbërjen e tij 3 njësi bazë:

- **Departamenti i Stomatologjisë;**
- Departamenti i Laborantëve Dentarë;
- Qendra e Formimit dhe Shërbimit Klinik;

Organet drejtuese të Fakultetit të Shkencave Dentare janë;

- Dekanati;
- Asambleja e Personelit Akademik;

Organ drejtues administrativ:

- Administratori i njësisë kryesore (Fakultetit)

Autoritetet drejtuese:

- Dekanati;
- Përgjegjësit e departamenteve;

Personeli akademik i njësisë përgjegjëse për specializimin afatgjatë, PAE, PAK;

Të dhënat për personelin akademik të Fakultetit për vitin akademik 2021-2022 jepen në tabelën e mëposhtme, (*Lista e Stafit 2021-2022 FMD (4)*), ndërsa stafi akademik i Departamentit të Stomatologjisë që është përgjegjës për programin e studimit për tre vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë (*Tabelat .pdf, tabelat nr. 1 dhe 2*):

Për vitin akademik 2018-2019, janë angazhuar 20 pedagogë gjithsej, nga ku 10 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët: 1 Prof. Dr., 1 Prof.As., 1 Dr., 3 SPA, dhe 4 Msc; si dhe 10 pedagogë me kontratë (PAK), nga të cilët: 2 Prof.Dr., 3 Prof.As., 1 Dr., 1 SPA, dhe 3 Msc. Raporti PAE/PAK është 10/10.

Për vitin akademik 2019-2020, janë angazhuar 20 pedagogë gjithsej, nga ku 10 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët: 1 Prof. Dr., 1 Prof.As., 1 Dr., 2 SPA, 3 Msc dhe 2 Bsc; si dhe 10 pedagogë me kontratë (PAK), nga të cilët: 2 Prof.Dr., 3 Prof.As., 1 Dr., 1 SPA, dhe 3 Msc. Raporti PAE/PAK është 10/10.

Prabhu
Jey

Për vitin akademik 2020-2021, janë angazhuar 17 pedagogë gjithsej, nga ku 12 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët: 1 Prof. Dr., 1 Prof.As., 4 Dr., 2 SPA, dhe 4 Msc; si dhe 5 pedagogë me kontratë (PAK), nga të cilët: 1 Prof.Dr., 3 Prof.As., dhe 1 Dr. Raporti PAE/ PAK është 12/5.

Tabela nr. 1

IAL	Fakulteti i Shkencave Dentare (Viti akademik 2021 – 2022)				Total
	Numri i PAE		Numri i PAK		
	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada	
Departamenti i Stomatologjise	11	(1) Prof. Dr. (1) Prof. Asoc. Dr. (2) Dr. (3)Spa (2) MSc (2) Bsc	11	(2) Prof. Dr. (3) Prof. Asoc. (2) Dr. (1)Spa (3) Msc	22
Departamenti i Lab Dentar	9	(1) Prof. Asoc. Dr. (2) Dr. (1)Spa (4) Mp. (1) Bsc	5	(2) Dr. (1)Spa (2) MSc.	14
Qendra e Sherbimit dhe Formimit klinik	11	(2) Prof. Dr. (4) Dr (1)Spa (1) MSc. (3) Mp	11	(2) Prof. Asoc. Dr. (3) Dr. (3)Spa (3)Msc	22
Në total	31		27		58

Stafi Administrativ dhe Ndihmës	
Emër Mbiemër	Pozicioni
Enida Dobi	Sekretare
Luljeta Tafa	Sanitare

Prushas

[Signature]

Edmond Mema	Koordinator i marrëdhënieve me jashtë
Orjeta Bushi	Ekonomiste
Vladimir Leka	Mirëmbajtës

Këshilli Drejtues i Specializimit		
Emër Mbiemër	Titulli	Pozicioni (Kryetar/Anëtar)
Diana Brovina	Prof.	Kryetare
Agron Meto	Prof.Asc.	Anëtar
Adem Alushi	Prof.	Anëtar
Merita Bardhoshi	Prof. Asc.	Anëtar
Ruzhdie Qafmolla	Prof.	Anëtar

Stafi akademik, përbërja dhe kriteret që ai plotëson u verifikuan në vend dhe janë paraqitur me detaje tek *Aneksi 1*, që ndodhet në fund të raportit.


Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
STANDARDI II- ORGANIZIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV I INSTITUCIONIT ORIENTOHEK NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E PRORAMEVE TË STUDIMIT	
Standardi II. 1- Personeli akademik dhe administrativ organizohet për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit.	
Kriteri 1 Struktura akademike dhe administrative e institucionit përmbush objektivat e programeve të studimit dhe objektivat strategjike për zhvillimin e institucionit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në nivel institucional, si Statuti, Rregullorja e programit të studimit, Rregullorja e Fakultetit, si dhe Strategjia e Zhvillimit të programit të studimit, GVJ konstatoi që programi i studimit është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit. Qëllimi dhe objektivat e programit janë në përputhje me dokumentat strategjike, statutin e IAL dhe të gjitha aktet e nxjerra për zbatimin e tij. Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me të gjitha strukturat e organizuara për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit, rezulton se përmbushen objektivat strategjike për zhvillimin institucional të tij. Struktura akademike dhe administrative e Universitetit përmbush objektivat e programit të

Prushas

[Signature]

	<p>studimit SPA në Stomatologji me profile: “Kirurgji Orale” dhe “Ortodonci”. Objektivat e institucionit janë pjesë e zhvillimit të përgjithshëm institucional.</p> <p><i>(Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; Statuti i UAL; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Dentare; Rregullore e programit të studimit specializim afatgjatë në stomatologji)</i></p>
<p>Standardi II. 2- Organizimi i institucionit është në përputhje me përcaktimet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në përmbushje të misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Organizimi i institucionit bëhet në përmbushje të misionit dhe qëllimit të tij.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete një nga të cilët ofron studime në fushën e mjekësisë së paku për programet e integruara të studimeve në fushën e Mjekësisë, Farmacisë dhe Stomatologjisë.</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti ose Qendra Kërkimore Shkencore janë të përbëra, së paku, nga 3 shërbime/departamente me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar.</p>	<p>Bazuar në statutin, rregulloren dhe diskutimet e zhvilluara në institucion, del në pah se organizimi i institucionit bëhet në përmbushje të misionit dhe qëllimit të tij. UAL është i organizuar dhe funksionon mbi bazën e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij dhe të udhezimeve të MASH. Autonomia dhe liria akademike e institucionit janë të sanksionuara në Statutin e Universitetit dhe rregulloret përkatëse, duke mbështetur tërësisht përmbushjen e misionit dhe qëllimit të institucionit. Aktet e brendshme të institucionit sigurojnë zhvillimin e lirë e krijues të mësimdhënies e kërkimit shkencor dhe është garanci për respektimin e të drejtave të personelit akademik dhe studentëve. Universiteti Aldent është i organizuar në 3 njësi kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore i përbërë nga: <ol style="list-style-type: none"> a. Departamenti i Farmacisë, b. Departamenti i Formimit Mjekësor, c. Qendra kërkimore farmakoterapeutike. 2. Fakulteti i Shkencave Dentare i përbërë nga: <ol style="list-style-type: none"> a. Departamenti i Stomatologjisë, b. Departamenti Laborantëve Dentarë, c. Qendra e Formimit dhe Shërbimit Klinik. 3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike i përbërë nga: <ol style="list-style-type: none"> a. Departamenti i Infermierisë-Fizioterapisë, b. Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri,

Prusha 

	<p>c. Qendra e Promovimit të Shëndetit.</p> <p>Departamenti i Stomatologjisë që ofron këtë program studimi, për vitin akademik 2021-2022 ka 11 personel akademik efektiv (PAE), ku 7 prej tyre janë me tituj ose grada shkencore, 2 me Msc dhe 2 me Bsc.</p> <p><i>(Statuti i UAL.pdf; Rregullore e Universitetit ALDENT)</i></p>
<p>STANDARDI VII - INSTITUCIONI DISPONON NJË RREGULLORE TË DETAJUAR TË PROGRAMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË</p>	
<p>Standardi VII. 1- Rregullorja është hartuar në përputhje me standardet e specializimeve në mjekësi dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe përditësohet çdo vit akademik</p>	
<p>Kriteri 1 Rregullorja është hartuar në përputhje me standardet e specializimeve në mjekësi dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Rregullorja hyn në fuqi në fillim të çdo viti akademik dhe përditësohet çdo vit të ri akademik.</p> <p>Kriteri 3 Kriteret e përcaktuara për një cikël specializimi në fillim të tij nuk mund të ndryshojnë gjatë përditësimeve vjetore të rregullores deri në përfundim të atij cikli. Nëse janë të nevojshme, ndryshimet në rregullorët pasardhëse duhet të përjashtojnë shprehimisht ciklin e nisur të specializimit.</p>	<p>UAL disponon rregulloren për funksionimin e Institucionit, të njësisë kryesore dhe të asaj bazë; si dhe rregullore të detajuar që lidhet me mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e programit të studimit, është hartuar duke u mbështetur në kërkesat e ligjit 80/2015, si dhe aktet nënligjore që dalin në zbatim të tij.</p> <p>Referuar RVB-së, aplikimi i licesimit për programin e studimit është bërë më datë 28.02.2013, dhe leja për hapjen e programit është marrë më datë 16.03.2013.</p> <p>Kriteret e pranimit të studentëve janë miratuar me vendim të senatit dhe nuk ndryshoheshin për ciklin përkatës akademik. Ndryshimet reflektojnë jo vetëm bazën ligjore që miratohet gjatë ecurisë akademike, por edhe specifika të ndryshme që lindin nga nevoja e përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit.</p> <p><i>Rregullore e Universitetit ALDENT.</i></p> <p><i>6. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Dentare.</i></p> <p><i>6.1 Rregullore e programit të studimit specializim afatgjatë në stomatologji.</i></p>

Prubus

[Signature]


Standardi VII. 2- Hartimi dhe miratimi i rregullores ndjek procedurat dhe merr mendimin e institucioneve të ndryshme të parashikuara për këtë qëllim.	
<p>Kriteri 1 Rregullorja propozohet nga Këshilli i Profesorëve dhe aprovohet nga senati i institucionit që i ofron ato.</p> <p>Kriteri 2 Rregullorja e aprovuar nga senati merr aprovimin nga MSH dhe MASH para hyrjes në fuqi.</p>	<p>Nga takimet në institucion, GVJ u informua se Rregullorja e programit të studimit të ciklit të tretë, specializim afatgjatë në Stomatologji, është hartuar nga Këshilli i Profesorëve dhe miratuar me Vendim Senati. Nr. 48, datë 24.12.2019. Referuar RVB dhe takimeve në institucion, kjo rregullore nuk është dërguar për aprovim në MSH, mbasi nuk është pjesë e detyrimit ligjor për miratimin e akteve të funksionimit të brendshëm të institucioneve të arsimit të lartë, por në ministrinë përkatëse të Arsimit ishin dërguar kriteret për pranimin e studentëve në këtë cikël, sikurse dhe e kërkon legjislacioni në fuqi.</p> <p><i>Rregullore e programit të studimit specializim afatgjatë në stomatologji</i></p> <p><i>vendim senati per miratimin e Rreg Spa.pdf</i></p>
Standardi VII. 3- Rregullorja përcakton kriteret dhe mënyrën e përzgjedhjes së organeve drejtuese të programeve specializuese dhe tutorëve.	
<p>Kriteri 1 Në rregullore janë përcaktuar qartë kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së përgjegjës të programit të specializimit dhe të këshillit drejtues.</p> <p>Kriteri 2 Në rregullore përcaktohen kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së mjekut përgjegjës/tutor për çdo specializant si dhe detyrat e tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit të studimit, rezulton se janë përcaktuar qartë kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së Drejtuesit të Specializimit dhe të Këshillit Drejtues. Referuar <i>nenit 18</i> të rregullores, kriteret e mjekut tutor janë të përcaktuara konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgjegjësi i programit duhet të ketë të paktën titullin “Prof.As.” dhe përvojë klinike të gjatë në ushtrimin e profesionit; - Këshilli drejtues i programit të studimit në bashkëpunim me përgjegjësin e programit të specializimit, punon për përgatitjen, organizimin dhe kontrollin e programit të specializimit; <p>Në përzgjedhjen e tyre janë patur parasysh jo vetëm kërkesat e rregullores, por dhe specializimet dhe përvoja e tutorëve në universitetet e huaja dhe eksperiencat e mëparshme shkencore e pedagogjike të tyre.</p>

Pruchas


[Signature]

	Rregullore e programit të studimit specializim afatgjatë në stomatologji
Standardi VII. 4- Në rregullore është përcatuar qartë mënyra e pranimit të studentëve në programin e specializimit	
<p>Kriteri 1 Në rregullore janë përcaktuar kriteret për aplikim (niveli i studimeve të kryera, kohëzgjatja dhe titulli i diplomës që kërkohet, nota mesatare, mosha, publikimet e kryera, etj) si dhe kriteret përjashtuese.</p> <p>Kriteri 2 Në rregullore përcaktohet qartë dokumentacioni që duhet të dorëzojë kandidati për aplikim, mënyra e dorëzimit të dokumentacionit dhe afati përfundimtar.</p> <p>Kriteri 3 Në rregullore janë përcaktuar qartë pikët maksimale që mund të grumbullojë kandidati dhe pikët që i jepen kandidatit për çdo kriter të plotësuar (notë mesatare, publikime, etj) si dhe pikët maksimale dhe minimale që mund ti jepen kandidatit gjatë çdo testimi (me shkrim, me gojë, praktik, etj).</p> <p>Kriteri 4 Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e konkurimit dhe si duhet të aplikojë kandidati për specializim; përcaktohet sa kohë para datës së shpallur për testimet mbyllet pranimi i dokumentave.</p> <p>Kriteri 5 Aplikanti dorëzon një kërkesë me shkrim sipas formatit të përcaktuar në rregullore dhe që i bashkëngjitet asaj. Aplikantit, në momentin e pranimit të dokumentacionit i jepet një vërtetim për aplikimin me numrin e tij identifikues gjatë procesit.</p> <p>Kriteri 6 Në rregullore është përcatuar qartë mënyra e zhvillimit të testimeve, rradha e zhvillimit të tyre, sa ditë diferencë mund të ketë nga një testim tek tjetri për të njëjtin program dhe për programe të ndryshme specializimi.</p>	<p>Rregullorja e specializimit përcakton qartë cilët janë kandidatet që mund të aplikojnë për ndjekjen e studimeve në SPA, dokumentacioni i nevojshëm që kandidati duhet të dorëzojë, si dhe procedurat përkatëse për regjistrimin në këtë program.</p> <p>Niveli i domosdoshëm i studimeve që duhet të ketë kryer kandidati për të ndjekur ciklin e tretë të studimeve në SPA është së paku 5 vite akademike me kohë të plotë në stomatologji dhe të ketë grumbulluar jo më pak se 300 kredite (ECTS).</p> <p>Me synimin e pranimit të kandidatëve cilësore, rregullorja ka përcaktuar që nota mesatare e kandidatëve duhet të jetë jo më pak se 8. Gjithashtu, kandidati duhet të plotësojë disa kriteret të tjera si: të ketë eksperiencë klinike, të ketë kualifikime dhe pjesëmarrje në trajnime dhe aktivitete të ndryshme profesionale e shkencore, si edhe kontribute në artikuj shkencor.</p> <p>Të gjitha këto kriteret vlerësohen me pikë të caktuara dhe të gjitha bashkëpërbëjnë një shumatore, sipas mënyrës që është përcaktuar qartë në rregullore. Në rregullore është përcaktuar edhe mënyra e aplikimit, e testimit, intervistës dhe pikët që grumbullon kandidati në të gjitha këto faza, si dhe dokumentacioni i nevojshëm, mënyra e pranimit dhe e regjistrimit. Kërkesa specifike ka në rregullore dhe për antarët e komisionit të përzgjedhjes së kandidatëve për në SPA, mënyra si caktohen ata dhe kriteret që duhet të plotësojnë.</p> <p>Nga verifikimi që ju bë dosjeve të specializantëve në sekretarinë mësimore rezultoi se dosjet ishin të plota, procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve ishin respektuar konform rregullores dhe dokumentacioni ruhej e mirëmbahej mirë. Me kandidatët fitues gjatë regjistrimit ishin lidhur</p>


Pruchas



<p>Kriteri 7 Në rregullore përcaktohet mënyra e përzgjedhjes së komisionit të provimit dhe kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët e komisionit.</p> <p>Kriteri 8 Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e vlerësimit të kandidatëve për çdo testim dhe dokumentacioni i përdorur i cili ruhet sipas procedurave të parashikuara në rregullore.</p> <p>Kriteri 9 Emërtimet e programeve të specializimeve të miratuara për vitin akademik, numri i specializantëve që do të pranohen për çdo program specializimi dhe taksat që duhet të paguajë specializanti për çdo specializim publikohen të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve.</p> <p>Kriteri 10 Mënyra e vlerësimit dhe argumentet mbi të cilat kryhet testimi duhet të përcaktohen në rregullore dhe të publikohen të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve.</p> <p>Kriteri 11 Në rregullore është përcaktuar qartë mënyra dhe afatet e shpalljes së rezultateve të testeve dhe të listës përfundimtare me fituesit si dhe është përcaktuar vendi dhe data e shpalljes së rezultateve.</p> <p>Kriteri 12 Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e lidhjes së kontratës me specializantët fitues.</p>	<p>kontratat përkatëse, një kopje e të cilës ruhej në dosjen personale të gjithësecilit.</p> <p><i>Procedurat e rekrutimit.</i></p> <p><i>6.1 Rregullore e programit të studimit specializim afatgjatë në stomatologji</i></p>
<p>Standardi VII. 5- Në rregullore parashikohen plani i çdo programi specializues, frekuentimi i tyre, transferimet e studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i detajuar i çdo programi specializues, lëndët dhe praktikat që duhet të frekuentohen, mënyra e frekuentimit, maksimumi i mungesave të lejuara dhe arsyet, leja e lindjes, dhe mënyra e recuperimit të mungesave duhet të jenë të parashikuara në rregulloren e specializimeve.</p> <p>Kriteri 2 Parashikohen procedurat për transferimet për apo nga programe të tjera</p>	<p>Plani mësimor përmban lëndët dhe modulet që zhvillon studenti përgjatë studimeve akademike. Në syllabuset e lëndëve përcaktohen detajet për detyrimet, praktikat që duhet të frekuentohen, mënyra e frekuentimit, maksimumi i mungesave të lejuara dhe mënyra e recuperimit apo shlyerjes së mungesave.</p> <p>Në rregulloren e studimeve në SPA është parashikuar mënyra e frekuentimit të studimeve në</p>

Practica 

<p>specializuese, ose për apo nga institucione të tjera që ofrojnë programe specializuese në mjekësi.</p> <p>Kriteri 3 Parashikohen kriteret dhe mënyra e pezullimit, zgjatjes ose përjashtimit të specialistit nga studimet specializuese.</p> <p>Kriteri 4 Rregullorja parashikon rastet kur specializimi mund të kryhet në një institucion tjetër që nuk është pjesë e rrjetit formues (për shembull institucionet jashtë vendit), kohëzgjatjen e kësaj periudhe dhe organin aprovues të kësaj procedure. Këto institucione duhet të jenë të akredituara për kryerjen e programit specializues në vendin përkatës.</p>	<p>këtë cikël dhe arsyet e mundshme të mungesave, si dhe mënyra e rikuperimit të tyre.</p> <p>Referuar kësaj rregulloreje specialistët janë të detyruar të frekuentojnë jo më pak se 70% të leksioneve e të seminareve dhe 100% të orëve laboratorike dhe të praktikave.</p> <p>Rregullorja ka parashikuar edhe shkaqet e ndërprerjes së studimeve, apo të transferimit të tyre deri në 1 vit në një institucion tjetër jashtë vendit. Këto institucione duhet të jenë të akredituara për kryerjen e programit specializues në vendin e origjinës.</p> <p><i>Rregullore e programit të studimit specializim afatgjatë në stomatologji.</i></p> <p><i>Syllabuset e lëndëve.</i></p>
<p>Standardi VII. 6- Në rregullore parashikohet librezja e studentit, tipologia dhe mënyra e verbalizimit të rezultateve të provimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Rregullorja parashikon formatin e librezës së studentit, mënyrën e plotësimit të saj dhe mënyrën e zëvendësimit të saj në rast humbje. Libreza e studentit e shoqëron atë deri në përfundim të ciklit specializues dhe diplomimit të tij.</p> <p>Kriteri 2 Përcaktohen tipologjia dhe mënyra e verbalizimit të rezultateve të testeve të kryera për pranimin e kandidatëve, testeve vjetore dhe testimin përfundimtar.</p>	<p>Rregullorja ka parashikuar një sistem të veçantë për ruajtjen e rezultateve, duke nisur nga pranimi deri në testimin përfundimtar. Në fillim të programit të studimit, specialisti pajiset me adresë dhe një kod personal ku ai ka të drejtë e mundësi të futet online dhe të shohë të gjitha rezultatet dhe vlerësimet vjetore të tij. Në sistemin e informatizuar të Universitetit, specialisti mund të gjejë të gjitha njoftimet që jepen, leksionet, eventet e ndryshme që zhvillohen, apo që UAL rekomandon.</p> <p>Nisur nga verifikimet që u bënë në sekretarinë përkatëse, por dhe në takim me specialistët, rezultoi se kjo mënyrë është mjaft efiçente dhe shërben për një kontroll e monitorim reciprok. Në rast të një gabimi të mundshëm është vetë specialisti që kërkon verifikimin e më pas ndreqjen e gabimit. Duke parë online faqen e tij kandidati gjen edhe detyrimet e prapambetura dhe mundësinë e shlyerjes së tyre. Sikundër u evidentua edhe gjatë takimit me studentët specialistë, institucioni ka mundësi sisteme të ndryshme për akses dhe informim online, apo</p>

Prubus 

	<p>zhvillimin e mësimit online gjatë pandemisë Covid-19. Platforma e-Learning e vënë në dispozicion të procesit akademik, aksesohet nga studentët e SPA dhe personeli i angazhuar në këtë program. Nga takimi në sekretarinë mësimore, GVJ u informua se, regjistrat e plotësuar në mënyrë manuale, amza si dhe fletët e provimeve të specializantëve konsiderohen dokumente të rëndësishë së dorës së parë dhe ruhen pa afat.</p> <p><i>Rregullore e programit të studimit specializim afatgjatë në stomatologji.</i></p> <p><i>Print screen, aksesi në platformën online për stafin dhe studentët</i></p>
<p>Standardi VII. 7- Në rregullore parashikohen procedurat për testimet vjetore dhe testimin përfundimtar si dhe formati i diplomës.</p>	
<p>Kriteri 1 Në rregullore përcaktohet mënyra e testimit vjetor dhe përfundimtar të specializantëve, pikët minimale dhe maksimale, lloji i testit dhe argumentet që testohen.</p> <p>Kriteri 2 Në rregullore përcaktohen kriteret për përzgjedhjen e komisionit të testimit vjetor dhe të atij përfundimtar.</p> <p>Kriteri 3 Në rregullore përcaktohen rastet e mungesave të justifikuara në testime dhe mënyra e recuperimit të testimit në këto raste.</p> <p>Kriteri 4 Në rregullore përcaktohet formati i diplomës. Diploma duhet të firmoset nga rektori, kryetari i komisionit të provimit përfundimtar/final dhe dekani i fakultetit përkatës.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit, në përfundim të çdo viti akademik organizohet provimi teorik dhe praktik për vlerësimin e dijeve të fituara gjatë atij viti dhe ky vlerësim bëhet me notë.</p> <p>Specializanti në përfundim të studimeve i nënshtrohet një provimi përfundimtar, i cili konsiston në një testim praktik paraprak, ku specializanti demonstroi disa nga aftësitë praktike të fituara.</p> <p>Vijohet me paraqitjen e temës studimore të përgatitur për mbrojtjen e diplomës. Tema studimore përshfaq gjithë njohuritë teorike dhe praktike të fituara gjatë viteve të specializimit.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit ka parashikuar ngritjen e një komisioni prej 5 antarësh, specialistë të fushës përkatëse, me tituj shkencorë dhe me eksperiencë në fushën përkatëse të stomatologjisë dhe në atë studimore shkencore. Në përfundim plotësohet diploma e specializimit, e cila firmoset nga Dekani dhe Rektori. Një kopje e formatit të Diplomës së specializimit ndodhet në dosjen përkatëse.</p> <p><i>Modaliteti i tezës së diplomës</i></p> <p><i>Rregullore e programit të studimit specializim afatgjatë në stomatologji.</i></p>

Prabhu

[Signature]

Standardi VII. 8- Në rregullore parashikohen të drejtat dhe detyrat e specialistit.

Kriteri 1 Rregullorja duhet të përmbajë detyrat dhe të drejtat që ka specialisti.

Kriteri 2 Në rregullore përcaktohet tipologjia dhe mënyra e sigurimit të specialistëve gjatë kryerjes së specializimit. Parashikohet tipi i policës së sigurimit dhe masa e mbulimit.

Kriteri 3 Në planin e programeve të specializimeve parashikohet se kur mund të kryhen veprimtari të caktuara të parashikuara nga këto programe, në ç'gradë autonomie mund të kryhen dhe çfarë aktiviteteve duhet të ketë kaluar me sukses specialisti për të zhvilluar disa aktivitete të tjera të parashikuara nga programi specializues, nën mbikqyrje ose në autonomi të plotë. Është përcaktuar një sistem vartësish të aktiviteteve të parashikuara.

Kriteri 4 Parashikohen rastet kur mund të pezullohet specializimi nga ana e specialistit dhe periudha maksimale e lejuar për pezullim, si dhe procedurat për të hequr dorë nga specializimi.

Bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe nga takimi me specialistët e programit të studimit, rezulton se në këtë rregullore janë parashikuar të drejtat dhe detyrat e specialistit. Që në fillim të studimeve studentët specialistë njihen me të drejtat dhe detyrat që ata kanë gjatë studimeve dhe që janë të specifikuara në rregulloren e tij. Ai e ka mundësinë që të konsultohet periodikisht me këto kërkesa dhe të drejtat e tij.

Për të gjithë periudhën e studimeve studentët janë të siguruar dhe Fakulteti disponon dokumentacionin përkatës që lidhet me sigurimin e specialistëve.

Specializanti merr njohuritë e duhura teorike e praktike dhe të etikës profesionale, si dhe nocionet e punës studimore shkencore, që e bëjnë atë të aftë për të ushtruar detyrën e specialistit në fushën që përgatitet.

Që në fillim të studimeve studentëve ju është bërë e qartë përmbajtja e programit dhe janë të detyruar të marrin pjesë aktivisht në realizimin teorik e praktik të tij. Një ndër objektivat kryesore në programin e SPA-s është angazhimi sistematik i specialistëve në punën klinike-praktike, si dhe angazhimin studimor-shkencor. Për këtë arsye, kandidati është i detyruar të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme, që lidhen ngushtë me fushën specifike në të cilën ai specializohet. Përmes këtyre aktiviteteve synohet që specialisti të aftësohet në: përvetësimin e metodologjive dhe të njohurive të nevojshme klinike e kërkimore shkencore, punën e pavarur në klinikë, laborator, apo në sallën e operacionit, mënyrën e përdorimit të informacioneve bashkëkohore dhe administrimin e tyre, përdorimin e teknologjive bashkëkohore në veprimtarinë e tij klinike, përvetësimin e metodave të avancuara të grumbullimit, analizës dhe përpunimit të të dhënave.

Practica *duy*

Veçanërisht pas vënies në përdorim të kampusit të ri universitar, UAL u ka krijuar specializantëve kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit afatgjatë me karakter akademik e klinik. Atyre u është siguruar në vazhdimësi mbështetja teknike për zhvillimin e aktivitetit klinik shkencor që parashikon programi. Dekanati i Shkencave Dentare ka në formë të shkruar dhe të informatizuar një pasqyrë të përvitshme të kandidatëve të regjistruar në SPA dhe lëvizjet e mundshme të tyre. Janë të regjistruar edhe ata që janë larguar para afatit dhe kanë ndërprerë studimet.

Specializantët gëzojnë të drejtën e pushimit vjetor 4 javë që është e parashikuar në strukturën mësimore të këtij programi. Për mungesat për arsye shëndetësore kërkohet të paraqitet raport mjekësor dhe kështu është vepruar. Kur mungesat zenë mbi 30% të ciklit apo modulit, ky i fundit duhet të përsëritet. Në rast leje lindjeje afati i specializimit është parashikuar të shtyhet për aq kohë sa zgjat leja e lindjes. Kur ndodhin ngjarje të jashtëzakonshme apo fatkeqësi familjare, specializanti mund të mungojë deri në 30 ditë me kushtin që të shlyejë të gjithë detyrimet në një periudhë të mëvonshme. Nga RVB dhe takimi në sekretarinë mësimore rezultoi se, aktualisht në UAL janë të regjistruar dhe frekuentojnë rregullisht studimet në SPA 64 specializantë, prej të cilëve 38 në Kirurgji Orale dhe 26 në Ortodonci.

Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.

*Rregullore e programit të studimit
specializim afatgjatë në stomatologji.*

Planimetri Kampusi i ri.

Print screen platforma online.

Plani mësimor.

Siguracioni i shëndetit.

Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i studimit SPA, përmban qëllim dhe objektiva të qarta, të shprehura në rregulloren e tij dhe të verifikuara nga GVJ edhe gjatë vizitës në terren. Këto objektiva janë në përputhje

Practus *guy*

me kërkesat ligjore e nënligjore të arsimit të lartë Shqiptar dhe me synimet strategjike që ka ky institucion për zhvillimin e tij.

Programi i studimit disponon dokumentacionin dhe ambjentet e nevojshme institucionale për zhvillimin me sukses të tij. Rregullorja e këtij programi studimi është hartuar sipas standarteve të specializimeve afatgjata në fushën e stomatologjisë dhe përmban të gjithë modalitetet e nevojshme për procedurat që ndiqen që në njoftimin për hapjen e këtij programi, kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët që duan të ndjekin atë, dokumentacioni i nevojshëm që paraqitet, procedurat e konkurimit, pranimit e regjistrimit në këtë program, detyrimet dhe të drejtat e specialistëve, detyrimet përmbyllëse, mbrojtja e tezës së diplomës e deri te akti i Diplomimit.

3. Personeli akademik dhe mbështetës

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik të SPA, raporti PAE/PAK, Personel akademik/Personel administrativ/student; shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Nga shqyrtimi i CV-ve dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se, personeli akademik i angazhuar në realizimin e programit të studimit SPA në “Stomatologji”, me profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonci, ofruar nga UAL, është përzgjedhur sipas kriterëve të nevojshme ligjore e didaktike, ka përvojë në mësimdhënie dhe përbëhet nga personalitete, që kanë tituj e grada shkencore dhe eksperiencë klinike të mjaftueshme për realizimin me sukses të programit. Drejtuesi i programit të studimit ka titullin “Prof.Dr”. Personeli akademik ka në përbërjen e tij disa Prof.Dr. Prof.As.Dr., PhD apo SPA, të shkencave mjekësore. Ata kanë veprimtari të pasur kërkimore shkencore dhe veprimtari botuese brenda e jashtë vendit. Tutorët klinikë të programit janë mjekë specialistë të fushës, që i përkasin këtij programi dhe kanë një eksperiencë të pasur klinike e kërkimore shkencore në këtë fushë. Ata janë rekrutuar dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas kërkesave ligjore dhe rregulloreve të institucionit. Në fillim të çdo viti akademik njësisia bazë e këtij institucioni i paraqet Dekanatit të Fakultetit kërkesat për plotësimin e vendeve vakante në stafin akademik. Dekanati ja përcjellë ato Rektoratit, i cili përcakton kriteret e pranimit sipas Rregullores së Universitetit dhe këtij Fakulteti. Vendet e punës në këtë institucion përfitohen sipas procedurave konkurruese. Kandidati që fiton duhet të kalojë një periudhë prove prej 3 muajsh, pas të cilës kur nuk ka probleme lidhen marrëdhënie pune me kontratë të rregullt sipas ligjit në fuqi. Kontratat e punës janë të hartuara sipas kërkesave të kodit të punës dhe të ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Ato janë të një formati të caktuar për PAE dhe për PAK.

Stafi mësimdhënës për programin e studimit SPA në “Stomatologji”, me profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonci, përbëhet nga Personel Akademik Efektiv (PAE), dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK). Referuar dok (4.Tabelat .pdf, tabelat 4.1, 4.2 dhe 4.3) stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi për tre vite akademike, dhe kualifikimi i tyre është sipas tabelës më poshtë:

Prachus
Jey


Grada/Tituj	2018-2019		2019-2020		2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	1	1	1	1	-
Prof.Asoc	1	1	4	1	2	2
Dr	5	1	3	2	5	1
SPA	-	1	-	2	-	2
Dr në proces	2	-	2	-	2	-
Raporti PAE/PAK	9	4	10	6	10	5
Totali	13		16		15	

Nga verifikimi i të dhënave të deklaruara në dokumentacionin mbështetës, gjatë takimit me personelin akademik dhe vizitës në zyrën e burimeve njerëzore, rezultoi se jo vetëm shkalla e kualifikimit të personelit është e lartë, por një kontigjent i konsiderueshëm janë të shkolluar e të kualifikuar në përfundim. Ndërkohë një nga pikat më të forta është aktivizimi i profesorëve të huaj për periudha të shkurtra trajnimi, cikël leksionesh apo veprimtari të tjera, që organizon UAL. Më shumë se 3 profesorë italiane, ekspertë të njohur në fushën e stomatologjisë janë angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në realizimin e këtij programi studimi të SPA në profilet përkatëse. Ata zhvillojnë çdo javë leksione e praktika me specializantët, duke sjellë përvojën e universiteteve të tyre në Shqipëri, në UAL. Një kontribut të veçantë jep personeli administrativ prej 5 personash, që është me kohë të plotë në funksion të realizimit cilësor të specializimit. Të dhënat lidhur me moshën dhe eksperiencën në punë jepen në këtë tabelë:

Personeli sipas titujve /gradave	Numri sipas moshës					
	(36-45)		(46-55)		(56-65)	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr					3	2
Prof As.			1	4	2	1
Doktorë (PHD mbaruar në Universitetet Europiane)	8	3				
SPA	5	1				2
Personeli Administrativ	2		3			

Nga shqyrtimi i ngarkesës mësimore për çdo pedagog, rezulton se 80% të ngarkesës mësimore të këtij programi specializimi mbulohet nga personeli akademik efektiv (PAE). Personeli i angazhuar ka një eksperiencë të gjatë në punë dhe ka harmonizim midis atyre në moshë e me përvojë të gjatë klinike e pedagogjike, me një kontigjent të rinjsh të shkolluar jashtë, si në Itali, Gjermani, Rumani etj. Personeli akademik efektiv dhe ai me kontratë kanë të lidhura kontratat e punës me institucionin, ku përshkruhen qartë qëllimi i lidhjes së kontratës, afatet e kontratës,

Prachas



paga dhe mënyra e dhënies së saj, si dhe të drejtat dhe detyrat e palëve, po ashtu rastet dhe mënyra e zgjidhjes së saj. Në përfundim, GVJ konstaton se Universiteti Aldent ka angazhuar profesionistët më të njohur në fushën e dentistrisë në vend, por edhe jashtë. Ndërrthurja midis personelit akademik me eksperiencë të gjatë dhe personelit të ri jep mundësinë e transferimit të kësaj eksperience dhe krijimin e një vijueshmërie e qëndrueshmërie afatgjatë të stafit. Kjo vërehet edhe në statistikat e vëna në dispozicion ku largimet e stafit kanë ndodhur vetëm për arsye studimi apo trajnimi jashtë vendit. Personeli është mjaft i përkushtuar dhe i angazhuar në zhvillimin me sukses të programit të studimit. Angazhimi i personelit të huaj është një nga pikat e forta të programit, pasi jo vetëm mundësohet sjellja e eksperiencës së tyre nga vendet/institucionet nga vijnë, por më së shumti ata sjellin të rejtat e fundit të shkencave dentare që aplikohen sot në vendet e zhvilluara. CV _compressed (1).; Rregullore e Universitetit ALDENT.; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Dentare (për firmë Dr Diana Agroni).; Rregullore e programit të studimit specializim afatgjatë në stomatologji. Kontrata FT. Kontrata PT.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III. 2 - Strukturat e përfshira duhet të disponojnë standardet e përgjithshme dhe specifike të parashikuara	
<p>Kriteri 5 IAL-të duhet të komunikojnë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të gjitha ndryshimet e kriterëve dhe standardeve që kanë mundur akreditimin jo më vonë se 30 ditë nga ndryshimi. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës ekzaminon kriteret dhe standardet e ndryshuara dhe japin miratimin e tyre mbi këto ndryshime.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni që ofron programet specializuese ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, ndihmës dhe administrativ kompleksiv në strukturat qendrore dhe dytësore për të mbuluar nevojat e specialiteteve të ofruara, në bazë të kapaciteteve.</p> <p>Kriteri 7 Institucioni që ofron programet specializuese është i mirëorganizuar dhe disponon dokumentacion që tregon mënyrën e organizimit dhe strukturën drejtuese si dhe personelin administrativ dhe akademik me</p>	<p>Programi i studimeve në SPA në Universitetin Aldent është hapur në vitin akademik 2013-2014 dhe nuk ka patur ndryshime të kriterëve dhe standardeve që nga hapja e tij, me përjashtim të përditësimeve të syllabuseve, literaturës apo infrastrukturës mbështetëse, elemente këto shumë sinjifikante, që tregojnë rritjen cilësore dhe qënien bashkëkohore të këtij institucioni.</p> <p>Universiteti Aldent është ndoshta i vetmi institucion jopublik në vend i profilizuar në shkencat mjekësore-dentare. Ka një eksperiencë realitivist të gjatë në këtë drejtim, ka kryer investime të mëdha infrastrukturore dhe dëshmon se ka personelin akademik, shëndetësor, ndihmës dhe administrativ, mbështetës në bashkëpunim me strukturat spitalore qendrore dhe dytësore, për të mbuluar nevojat e studentëve specializantë dhe të programit të studimit.</p>

(Pacibus)
[Signature]

<p>titujt përkatës si dhe rolet e parashikuara për secilin.</p>	<p>UAL është një institucion i konsoliduar që funksionon në përputhje me ligjin e arsimit të lartë në vendin tonë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. ka kaluar me sukses disa akreditime periodike të institucionit dhe të programeve të studimit; 2. personeli administrativ dhe akademik është me titujt përkatës dhe me rolet e parashikuara për secilin prej tyre sipas kërkesave të ligjit; 3. organizimi dhe struktura drejtuese funksionon në përputhje me çdo akt ligjor e nënligjor në fuqi e në përputhje me standartet e cilësisë në arsimin e lartë; <p><i>Lista e tutorëve të angazhuar në programin e studimit.</i> <i>CV e stafit akademik.</i> <i>Statuti i UAL.</i></p>
<p>Standardi III. 3 - Rrjeti formues¹ plotëson kriteret minimale të parashikuara dhe është i përshtatshëm për të ofruar programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni plotëson kërkesat minimale të përgjithshme të parashikuara në këtë dokument përsa i përket rrjetit formues.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni duhet të plotësojë kërkesat minimale specifike për çdo specialitet të parashikuara në shtojcën 2 të këtij dokumenti përsa i përket rrjetit formues.</p> <p>Kriteri 3 Kërkesat e përgjithshme dhe specifike janë të organizuara sipas kriterëve të mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Përshtatshmëria e strukturave dhe pajisjeve, me shërbimet përkatëse të përgjithshme dhe diagnostikuese dhe ekzistencën në to të specialiteteve të ngjashme b. Ekzistenca e numrit dhe procedurave praktike të mjaftueshme për një formim të plotë profesional 	<p>IAL dhe Fakulteti përgjegjës për këtë program studimi, plotëson kriteret e nevojshme të përgjithshme që janë të parashikuara për sa i përket rrjetit formues që lidhet me këtë program studimi. Në dispozicion të këtij programi është vënë Qendra e Formimit dhe e Shërbimit Klinik, që është një institucion i organizuar në reparte dhe funksionon sipas rregullores së posaçme brenda UAL. Kjo klinike sipas RVB dhe vizitës në institucion, ofron për programin e studimit në fjalë të gjitha facilitetet e nevojshme me 28 unite dentare dhe mjekon 800-1000 pacientë çdo vit, duke plotësuar kushtet për zhvillimin me sukses dhe në mënyrë optimale të programit të specializimit.</p> <p><i>Rregullore e Universitetit ALDENT.</i> <i>Rregullore e Fakultetit të Shkencave Dentare.</i> <i>Rregullore e programit të studimit specializim afatgjatë në stomatologji.</i></p>

¹ Me rrjet formues nënkuptohet bashkësia e të gjitha strukturave të përfshira në aktivitetet e parashikuara për secilin program specializues: strukturat qendrore/bazë, dytësore dhe komplementare.

Practica
[Signature]

<p>c. Burime financiare të mjaftueshme</p> <p>d. Tutorë dhe pedagogë të përshtatshëm dhe ekspertë</p> <p>e. Strukturë organizative e përshtatshme, me kapacitetet e nevojshme profesionale</p> <p>f. Programim i aktiviteteve orientuese, analizuese sipas kërkesave të tregut dhe përcaktimi i një programi formues</p> <p>g. Seleksionimi dhe vlerësimi i studentëve</p> <p>h. Efikasiteti dhe efica në aktivitetet e ndryshme të parashikuara.</p> <p>Kriteri 4 Institucioni disponon dokumentacion që provon përbërjen e rrjetit formues dhe të gjitha strukturave të përfshira në formimin specializues (qendrore/bazë, dytësore, etj) dhe konvencionet eventuale me këto struktura dhe me ato komplementare.</p> <p>Kriteri 5 Strukturat qendrore dhe dytësore të përfshira në formimin specializues duhet të jenë të akredituara nga MASH/APAAL në bashkëpunim me MSH/Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni duhet të disponojë dokumentacion që sqaron ekzistencën e shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specializantëve. Shërbimet e përgjithshme dhe diagnostikuese të pranishme në strukturat shëndetësore pjesë e rrjetit formues nuk mund të jenë të ndryshme apo inferiore nga ato të parashikuara në shtojcën 2 për akreditimin e strukturave.</p> <p>Kriteri 7 Institucioni disponon dokumentacion që sqaron ekzistencën e specialiteteve të ngjashme në strukturat shëndetësore pjesë të rrjetit formues, shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specializantëve (sipas shtojcës 2).</p> <p>Kriteri 8 Institucioni disponon dokumentacion që sqaron numrin e shërbimeve mjekësore që ofron për ushtrimin</p>	<p>UAL plotëson kërkesat minimale specifike për çdo specialitet, që janë të parashikuara në lidhje me rrjetin formues të tij. Puna është e organizuar në reparte sipas veçorive karakteristike të çdo nënspecialiteti. Rrjeti formues i këtij institucioni, që lidhet me realizimin me sukses të këtij programi SPA plotëson standartet dhe kriteret specifike sipas kërkesave të programeve të studimeve afatgjata në fushën e mjekësisë dhe konkretisht në fushën e Kirurgjisë Orale dhe Ortodoncisë. Ky institucion me një përvojë disa vjeçare në fushën e Arsimit të lartë në të tre ciklet e studimit ka dokumentacion të plotë, infrastrukturën e nevojshme dhe përvojën e duhur për realizimin e plotë të programit të studimit SPA në Kirurgji Orale dhe Ortodonci.</p> <p><i>Organigrama ALDENT.</i> <i>Planimetri Kampusi i ri.</i> <i>Planimetrite Kampus A+B.</i></p> <p>UAL ka organizuar dhe plotëson kërkesat e përgjithshme dhe ato specifike lidhur me kriteret e këtij programi studimi në SPA.</p> <p>Pajisjet e mjediseve mësimore dhe ato të praktikave profesionale janë të përshtatshme dhe moderne, të plota e të mirëmbajtura dhe krijojnë kushtet për një mësimdhënie mëse normale e të kohës. Kjo krijon premisat e duhura për realizimin pa pengesa të këtij programi. Në funksion të këtij programi studimi, sallat janë të pajisura me video projektorë dhe ka lidhje me internet Wireless.</p> <p>Ky program studimi mbështetet mbi një infrastrukturë të kompletuar, që mundëson formimin teorik sipas standarteve të kërkuara, por dhe një mundësi praktike reale për të kryer intervente të tipeve të ndryshme, por dhe që kanë shkallë vështirësie klinike të ndryshme që varion sipas rastit të paraqitur. Ekzistenca e një numri të interventeve operatore që kontrollohet dhe monitorohet vazhdimisht, edhe pse në kushtet specifike të pandemisë Covid-19,</p>
--	--

Prubus

[Signature]

profesional të specializantëve (sipas shtojcës 2).

Kriteri 9 Institucioni duhet të disponojë dokumentacion që sqaron aktivitetin asistencial kompleks vjetor të strukturave të përfshira në rrjetin formues. Aktiviteti asistencial vjetor që kryhet nga specializantët në kuadër të formimit të tyre nuk mund të jetë më i madh se 30% e aktivitetit asistencial total që kryejnë strukturat e përfshira në rrjetin formues (sipas shtojcës 2).

konsiderohet e mjaftueshme për një formim profesional të arsyeshëm nga ana e specializantëve. Regjistrat e sallave operatore dhe kartelat klinike të pacientëve që u vëzhguan gjatë vizitës në institucion, si dhe librezat personale të specializantëve, japin informacion dhe vërtetojnë se është kryer një numër i mjaftueshëm ndërhyrjesh operatore që bën të mundur zotërimin e protokollit dhe teknikës operatore për çdo rast. Programi i studimit zotëron të ardhura financiare të mjaftueshme. Ato sigurohen jo vetëm nga tarifat e specializantëve, por edhe nga tarifat që merren nga shërbimi ndaj të tretëve.

Tutorët e praktikave apo Udhëheqësi i Programit, janë mjekë të specializuar në fushën e Stomatologjisë dhe mbajnë tituj dhe grada shkencore. Ata kanë eksperiencë të mjaftueshme klinike që të përballojnë kërkesat e këtij programi dhe të mundësojnë realizimin cilësor të tij.

Struktura organizative e UAL e cila është ngarkuar për implementimin e këtij programi studimi, është e plotë si nga ana akademike ashtu edhe ajo administrative. IAL ka paraqitur dokumentacion të plotë lidhur me përbërjen e tyre, mënyrën e rekrutimit të stafit, përgatitjen e dokumentacionit dhe krijimin e dosjeve personale. Në të gjitha rastet e verifikuara gjatë vizitës në institucion nuk u gjetën mungesa në këtë drejtim. Kapacitetet njerëzore të ngarkuara me këtë proces janë të mjaftueshme, sidomos po të marrim parasysh numrin e studentëve që frekuentojnë aktualisht këtë program.

Programi i studimeve SPA është hartuar duke parashikuar aktivitete orientuese, që mundësojnë përgatitjen cilësore profesionale të kandidatëve dhe merr në konsideratë nevojat e tregut të punës në këtë fushë. Aktiviteti profesional që e shoqëron këtë program studimi përputhet mirë me nevojshmërinë e specialistëve të Kirurgjisë Orale dhe

Practica
Jay

Ortodoncisë, që kërkon dije bashkëkohore dhe njohje të protolloleve të ndërhyrjeve operatore dhe të teknologjive të fundit. Gjatë vizitës në institucion GVJ, konstatoi se UAL, disponon gjithë dokumentacionin e nevojshëm që provon praninë dhe statusin e rrjetit formues të programit të studimit në SPA për Kirurgji Orale dhe Ortodonci. Ky dokumentacion është i arkivuar dhe i aksesueshëm nga të interesuarit. Ai vërteton jo vetëm praninë dhe statusin e strukturave institucionale, por edhe ato të atyre bashkëvepruese, për pjesën me të cilën ka marrëveshje institucionale dhe që janë në dispozicion të këtij programi studimi. Të tilla institucione janë Qendra Spitalore Universitare, Spitali i Traumës dhe disa struktura private të shërbimit stomatologjik që kryejnë aktivitet kirurgjikal. Të gjitha këto janë resurse në dispozicion të procesit të Specializimit të kandidatëve në këtë program SPA.

Institucioni disponon dokumentacionin e nevojshëm me të cilin provon ekzistencën e shërbimeve të përgjithshme mjekësore e stomatologjike, me karakter diagnostikues e mjekues, që janë në funksion të këtij programi studimi. Këto shërbime të përgjithshme diagnostikuese që janë të pranishme në klinikën stomatologjike të UAL si institucion ndihmës në zhvillimin e këtij programi studimi, janë pjesë e rrjetit formues të specializantëve që ndjekin këtë program. IAL disponon dokumentacionin e nevojshëm që vërteton ekzistencën e specialiteteve të ngjashme në strukturat e veta që janë pjesë e rrjetit formues të këtij programi studimi.

Procedura e rekrutimit në UAL.

Planimetri Kampusi i ri.

Planimetritë Kampus A+B.

Rregullore e programit të studimit specializim afatgjatë në stomatologji.

CV e stafit akademik.

Organigrama ALDENT.

Prabh...

guy

Standardi III. 4- Institucioni është i mirëorganizuar dhe disponon burime njerëzore të mjaftueshme për mirëfunksionimin e programeve specializuese.

Kriteri 1 Institucioni disponon dokumentacionin e nevojshëm që provon dhe përshkruan strukturën organizative dhe figurat drejtuese, akademike dhe profesionale të angazhuara.

Kriteri 2 Çdo program specializues përcakton:

- a. Një figurë drejtuese, përgjegjësi i programit të specializimit. Përgjegjësi i programit të specializimit të ketë të paktën titullin "Profesor i asociuar" dhe 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit.
- b. Këshilli i profesorëve përveç përgjegjësit të programit të specializimit, përcakton një këshill drejtues të programit të studimit i cili, në bashkëpunim me përgjegjësin e programit të specializimit, punon për përgatitjen, organizimin dhe kontrollin e programit të specializimit në fjalë.
- c. Një përgjegjës për menaxhimin ekonomik-financiar dhe përmbushjen e kërkesave administrative.
- d. Të paktën një përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm.

Nga shqyrtimi i DVV, rezulton se UAL, e ka të përcaktuar në aktet rregullatore të tij funksionin që kanë strukturat didaktike dhe profesionale, përgjegjëse për menaxhimin dhe realizimin e këtij programi studimi. Staf i departamentit dhe i programit të studimit përbëhet nga pedagogë me tituj dhe grada të fituara në brenda dhe jashtë vendit.

Figura drejtuese e këtij program studimi sipas Vendimit Nr. 33, datë 09.10.2019, është Prof.Dr. R Q.

Këshilli Drejtues i këtij programi përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët janë ekspertë të njohur në fushën e Stomatologjisë.

Institucioni ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila ka realizuar në mënyrë periodike monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë me anë të metodave që i ka përcaktuar.

Ndërsa stafi akademik i programit të studimit me kohë të pjesëshme, ka eksperiencë të gjatë didaktike e shkencore. Staf i ftuar i cili angazhohet në këtë program studimi, është pjesë e universiteteve të njohura vendase dhe të huaja. Personeli i jashtëm me kontratë që janë ekspertë të fushave shumë specifike përbëjnë rreth 10% të stafit, që merret me realizimin e programit të specializimit afatgjatë. Pjesa tjetër e stafit pedagogjik ka së paku gradën shkencore "Doktor".

Në këtë program çdo student ka një pedagog tutor (udhëheqës klinik), që e ndjek dhe e ndihmon atë gjatë gjithë periudhës së specializimit; një pedagog mund të ketë në udhëheqjen e tij 2-3 studentë. Është bërë kujdes që fusha e specializimit të udhëheqësit të jetë e njëjtë me atë të programit ku specializohet student.

Prabh...
[Signature]

	<p>Universiteti Aldent ka dhe kontrata bashkëpunimi me specialistë nga institucione të tjera klinike e mjekësore dhe ofron asistencë nga specialistë të nivelit të lartë, me të cilët ka marrëdhënie bashkëpunimi shumëvjeçare, kundrejt të gjitha procedurave e kërkesave të kodit të punës dhe ligjeve për punësimin.</p> <p><i>Marrëveshjet e bashkëpunimit.</i> <i>Rregullore e Universitetit ALDENT.</i> <i>Rregullore e programit të studimit specializim afatgjatë në stomatologji.</i> <i>CV e stafit akademik</i> <i>Aprovimi i strukturave drejtuese të Universitetit Aldent (Keshilli drejtues në SPA)</i></p>
<p>STANDARDI IV - PERSONELI AKADEMIK, SHËNDETËSOR, NDIHMËS MËSIMOR-SHKENCOR, ADMINISTRATIV DHE TUTORËT JANË TË MJAFTUESHËM DHE PLOTËSOJNË STANDARDET E PËRGJITHSHME SI DHE ATO SPECIFIKE TË PARASHIKUARA PËR ÇDO SPECIALITET</p>	
<p>Standardi IV. 1 - Personeli i angazhuar në programet specializuese plotëson standardet e parashikuara</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon dokumentacionin e nevojshëm që përshkruan strukturën didaktike dhe figurat profesionale të angazhuara në programin specializues.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon personel akademik, pedagogë dhe tutorë, sipas specifikimeve në shtojcën 2.</p> <p>a. Pedagogë universitarë: profesorë, profesorë të asociuar dhe docentë, për jo më pak se 50% të pedagogëve të përfshirë në programin specializues. Të paktën një profesor i brendshëm është nga sektori disiplinor i programit të specializimit që ofrohet nga institucioni.</p> <p>b. Pedagogë jo universitarë që ushtrojnë profesionin në strukturat e rrjetit formues: personel me eksperiencë didaktike-formuese të dokumentuar dhe me eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare pranë strukturave të përfshira në rrjetin formues, për një maksimum prej 50% të pedagogëve dhe me të cilët është lidhur një kontratë me kohëzgjatje të</p>	<p>GVJ konstatoi se UAL, disponon dokumentacionin e nevojshëm për personelin akademik dhe atë administrativ që merret me zbatimin e këtij programi. Në dokumentet themelore si statuti, rregullore, janë të përcaktuara procedurat ligjore dhe mënyra e rekrutimit të stafit akademik dhe ndihmës. Ky institucion ka kryer më së miri rekrutimin e stafit me të gjitha kriteret e duhura, veçanërisht për SPA. <i>Statuti i UA; Rregullore e Universitetit ALDENT;</i></p> <p>Institucioni disponon dokumentacionin e nevojshëm për stafin e rekrutuar sipas procedurave dhe rregullores së tij. E njëjta procedurë si ajo që përdoret për stafin e studimeve universitare është ndjekur edhe për pranimin e stafit që është ftuar të realizojë programin e specializimit afatgjatë, por kriteret e vendosura për këtë rast kanë qenë të një niveli më të lartë dhe që i korrespondojnë nivelit të studimeve të ofruara. Në raste të veçanta kur nuk mund të sigurohen specialistë me kohë të</p>

Practus

Jay

<p>paktën sa kohëzgjatja e secilit program specializues.</p> <p>c. Pedagogë të jashtëm me kontratë: ekspertë të sektorëve të ndryshëm disiplinorë, për një numër maksimal prej 10% të numrit total të pedagogëve, të cilët mund të angazhohen vetëm në mungesë të profesorëve universitarë.</p> <p>Kriteri 3 Numri dhe niveli i kërkuesve të angazhuar në këto programe përbën një garanci për realizimin e programeve (50% e tyre duhet të jenë personel akademik i brendshëm, të angazhuar në punën klinike dhe me tituj akademikë: “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose gradë shkencore “Doktor” apo “PHD” të fituar në universitete të mirënjohura në botë dhe të shquar për cilësi dhe veprimtari të pasur klinike/kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse.</p> <p>Kriteri 4 Numri i studentëve që mund të ndiqet nga një tutor është jo më i madh se 3 (tre).</p>	<p>plotë për shkak të angazhimeve të tjera të rëndësishme, apo për shkak të specifikës që mund të ketë një drejtim i caktuar, janë angazhuar specialistë me kontratë nga institucionet partnere. <i>Kontrata FT; Kontrata PT</i></p> <p>Institucioni publikon rregullisht njoftime lidhur me punësimin e personelit, procedurë të cilën e kemi shpjeguar edhe në pjesën hyrëse të këtij paragrafi. Personeli akademik me kohë të plotë, përbën mbi 50% të numrit total të pedagogëve, që mbulojnë këtë program studimi dhe ka të paktën gradën shkencore "Doktor".</p> <p>Mbulimi i programit në % nga personeli akademik efektiv (PAE) për realizimin e këtij programi në tre vitet akademike është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për vitin akademik 2018-2019 70% realizohet nga PAE dhe 30% nga PAK, nga ku 5 staf akademik efektiv ose 55% janë me grada / tituj; - Për vitin akademik 2019-2020 62% realizohet nga PAE dhe 38% nga PAK, nga ku 8 staf akademik efektiv ose 80% janë me grada / tituj; - Për vitin akademik 2020-2021 67% realizohet nga PAE dhe 33% nga PAK, nga ku 8 staf akademik efektiv ose 80% janë me grada / tituj; <p>Pjesa më e madhe e numrit të personelit të angazhuar në programin e studimit të specializimit afatgjatë, janë personel akademik i brendshëm, të angazhuar aktivisht në punën klinike dhe me tituj akademik "Profesor", "Profesor i Asociuar", ose gradë shkencore "Doktor", apo "PhD", të fituara në universitete të mirënjohura në botë dhe të shquar për cilësi dhe veprimtari të pasur klinike/kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse. Ky institucion ka procedura transparente të vlerësimit të stafit akademik dhe këto janë përcaktuar në vendimet e Senatit të Universitetit.</p>
--	--

Prabh... *Jey*

	<p>Një vlerësim i tillë është bërë nëpërmjet pyetësorit të zhvilluar me studentët, ku një seksion i posaçëm i është dedikuar vlerësimit të metodave të mësimdhënies, teknikave të përdorura, vlerësimit të personelit etj</p> <p>Në kontratat e punës të stafit akademik dhe ndihmës, përcaktohen detyrat për secilin punonjës në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet konkret e sipas detyrave të ngarkuara.</p> <p>Zyra e burimeve njerëzore disponon dosjet përkatëse të personelit dhe të dhënat e nevojshme për to. Numri i specializantëve që ndjek një pedagog tutorështëderi në 3 të tillë.</p> <p><i>Procedura e rekrutimit në UAL.</i> <i>Tabelat.</i></p>
<p>Standardi IV. 2 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit konform statutit dhe rregullores së përcaktuar nga vetë institucioni.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit dhe detyrave që u janë caktuar.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik, rezulton se, institucioni ndjek me korrektësi procedurat ligjore të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit. Nga verifikimi i procedurës së ndjekur rezulton se, si rregull lajmërimi për një vend të lirë pune është dhënë në faqen e Universitetit Aldent, rrjetet sociale dhe në platformatë tjera të punësimit. Departamenti i Laborantëve Dentarë paraqet kërkesat në rastin e programit, për nevojat e tij për plotësimin e vendeve vakante që lidhen me zhvillimin e programit. Dekananti Fakultetit të Shkencave Dentare ia përcjell kërkesat Rektoratit i cili ka përcaktuar kriteret e pranimit që duhet të plotësojë kandidati, dokumentacioni që duhet të paraqesë dhe afati i zhvillimit të konkursit përkatës. <i>Procedura e rekrutimit në UAL.</i></p> <p>Nga takimi me njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë, GVJ u informua se, UAL ka procedura transparente të vlerësimit të stafit akademik dhe këto janë përcaktuar në rregulloren e universitetit. Në kontratat e punës të stafit akademik dhe ndihmës, përcaktohen detyrat për secilin punonjës në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet konkret e sipas detyrave të ngarkuara. Zyra e personelit në këtë institucion</p>

Prushas *guy*

	<p>disponon dosjet përkatëse të personelit dhe të dhënat e nevojshme për to. Ajo ka të dhënat për mënyrën si është bërë njoftimi për punë për pozicionin e pedagogut, ka të dhëna të plota për mënyrën si është rekrutuar personeli dhe për ecurinë e tyre në punë në vazhdimësi, të cilat ruhen në dosjen e secilit.</p> <p><i>Kontrata FT</i> <i>Kontrata PT</i> <i>Rregullore e Universitetit ALDENT</i></p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni mund të ofrojë programe mësimdhënieje në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, që ofron programe mësimdhënieje në gjuhë të huaj, plotëson të njëjtat standarde të përcaktuara për IAL-të që ofrojnë programet e studimeve specializuese të fushës së mjekësisë në gjuhën shqipe.</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënieje në gjuhë të huaj ka kryer së paku pesë vjet studime në një institucion të huaj në të njëjtën gjuhë mësimdhënieje, ose disponon një certifikatë për njohje të avancuar të gjuhës së mësimdhënieje të njohur ndërkombëtarisht në nivelin C1, dhe ka kryer së paku një vit studime në një institucion me të njëjtën gjuhë mësimdhënieje,.</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënieje në gjuhë të huaj ka mbajtur mbi 10 kumtesa shkencore në këtë gjuhë.</p>	<p>Nga takimet me drejtuesin e fakultetit dhe departamentit, GVJ u informua se UAL nuk ofron programe studimi në gjuhë të huaj, por vetëm në gjuhën shqipe.</p> <p>Në rastet kur janë ftuar staf i huaj, institucioni ofron përkthim të tyre në gjuhën shqipe.</p> <p>Institucioni në planet e tij afatgjata të zhvillimit ka transformimin gradual në një program ku shumica e lëndëve të ofrohen në gjuhë të huaj nga personel vendas dhe i huaj. Niveli i gjuhës së huaj të kërkuar në pranim dhe përfshirja e personelit të huaj, mundëson në të ardhmen orientimin e programit drejt një programi ndërkombëtar.</p> <p><i>Strategjia e zhvillimit të programit të studimit</i></p>
<p>Standardi IV. 4- Specializanti ka një tutor që e ndjek atë gjatë gjithë periudhës së specializimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studenti ka një udhëheqës klinik (tutor) të diplomuar dhe specializuar në fushën e programit të studimit të aplikantit i cili ka një eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare në fushën klinike në fjalë dhe ka gradën "Doktor".</p> <p>Kriteri 2 Studentit që ka një udhëheqës klinik që nuk është pjesë e personelit akademik të institucionit që ofron programin e specializimit, i caktohet dhe një udhëheqës akademik, anëtar i personelit akademik të institucionit me së paku gradën shkencore</p>	<p>Në programin e specializimit afatgjatë në profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonci çdo student specializant ka një pedagog si tutor (udhëheqës klinik). Gjatë gjithë periudhës së specializimit, tutori ka për detyrë të qëndrojë pranë specializantit. Ai ndihmon në plotësimin me sukses të programit deri në mbrojtjen e temës dhe diplomimin e tij. Tutorët janë me eksperiencë profesionale shumëvjeçare, me pervojë në punën klinike dhe atë studimore shkencore, si rregull të fushës së specializimit</p>

Practica
Jey

“Doktor” apo “PhD” (të fituar në universitete, të mirënjohura në botë) në fushën në të cilën vazhdon studimet specializanti.

Kriteri 3 Këshilli i Profesorëve përzgjedh udhëheqësit klinikë, të aftë për të drejtuar punën klinike e kërkimore të specializantëve, mbështetur në vlerësimin e veprimtarive klinike e kërkimore botuese të tyre, brenda e jashtë vendit.

Kriteri 4 Tutori është i punësuar me kohë të plotë pranë njërës nga strukturat e rrjetit formues dhe ka një kontratë bashkëpunimi me institucionin që ofron programin specializues.

Kriteri 5 Udhëheqësit klinikë punojnë për përditësimin e njohurive dhe aftësive të tyre, mbështetur në marrëveshjet institucionale, me qëllim mundësimin e shkëmbimeve të praktikave më të mira dhe dhënien e këshillave në mbështetjen efektive të studentëve.

Kriteri 6 Udhëheqësi klinik i studentit është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e përparimit të punës klinike të studentit.

Kriteri 7 Udhëheqësi klinik ka ekspertizën, formimin dhe udhëzimet e duhura për rolin e tij në udhëheqjen e specializantit në realizimin e studimeve specializuese dhe në veçanti të pjesës praktike/klinike.

Kriteri 8 Udhëheqësi nuk mund të mbikëqyrë më shumë se 3 (tre) studentë njëkohësisht.

Kriteri 9 Fusha e specializimit të udhëheqësit përputhet me atë të programit specializues që ndjek specializanti.

Kriteri 10 Në të gjitha rastet, studenti ka vetëm një pikë të identifikuar kontakti, i cili duhet të jetë udhëheqësi klinik kryesor i tij. Nëse udhëheqësi kryesor nuk është në dispozicion, studentit i bëhet e ditur se cili do të jetë personi që do ta zëvendësojë.

ose të afërt me të dhe që mbajnë të gjithë tituj dhe grada shkencore. Tutorët janë të punësuar me kohë të plotë dhe kanë në udhëheqje 2 ose 3 specializantë. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion, janë paraqitur të dhëna të hollësishme të pedagogëve që kryejnë edhe tutorin në ciklin e studimeve në SPA.

Ata janë me titull Prof. ose Prof.As. në disa raste janë Phd që e kanë marrë në universitete mjaft të njohura kryesisht në Europë. Përzgjedhja e tyre është bërë ndërmjet specialistëve të fushës ku është ofruar ky program i SPA. Përgjatë kësaj, në raste të veçanta tutorët janë përzgjedhur nga një fushë e përafërt, por me tregues cilësorë dhe eksperiencë të spikatur në fushën klinike dhe atë studimore shkencore.

Nga takimi me specializantët e këtij programi studimi, rezulton se institucioni e ka të përcaktuar qartë edhe për rastet kur udhëheqësi është tërhequr apo larguar për arsye pune. Zëvendësimi i tyre është bërë duke marrë edhe mendimin e specializantit në të gjitha rastet kur një gjë e tillë ka qenë e mundur. Tutori i ka ndjekur specializantët gjatë gjithë procesit mësimor dhe veprimtarive klinike për realizimin e programit. Midis të tjerave, tutori “mëson” specializantët edhe për çështjet etike, sjelljen me kolegët dhe personelin ndihmës, mënyrën e komunikimit me pacientët apo shoqëruesit e tyre dhe mjaft probleme të tjera të hasura në praktikën e përditshme.

Nga takimi me stafin akademik rezulton se, UAL ju ka siguruar tutorëve kohën dhe kushtet e nevojshme për mbarëvajtjen e specializantëve, si nga ana mësimore, ashtu edhe ajo klinike, duke bërë rregullimet e nevojshme në orare dhe normuar kohën e punës.

CV e stafit akademik.

Tabelat.

Stafi Akademik 2021-2022.

Practus

<p>Kriteri 11 Institucioni siguron që udhëheqësi të ketë kohën e mjaftueshme për ta mbikëqyrur specializantin.</p>	<p><i>Lista e Tutorëve të angazhuar në programin e studimit.</i></p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se UAL disponon disa sisteme informimi dhe ka nivel të kënaqshëm të përdorimit të teknologjisë së informacionit.</p> <p>Institucioni disponon një database të hollësishme me të gjitha të dhënat e duhura për personelin akademik dhe atë ndihmës, që janë të përfshirë në procesin e realizimit të programit të SPA. Po ashtu disponon të dhëna të hollësishme për personat përgjegjës që kryejnë edhe detyrën e tutorit. Në këtë kontekst, çdo informacion apo e dhënë që lidhet me stafin apo studentët është pjesë e këtyre sistemeve. Situata e Covid-19, e stimuloi akoma më shumë përdorimin e saj duke mundësuar në këtë mënyrë përdorimin e saj në çdo veprimtari akademike e administrative.</p> <p><i>Print screen platforma online.pdf Stafi Akademik 2021-2022. Lista e Tutorëve të angazhuar në programin e studimit.</i></p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhohet në kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe të zhvillimit profesional të mëtejshëm të personelit akademik të angazhuar në program e të personelit mbështetës.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash të programeve të kualifikimit.</p>	<p>Nga takimi me drejtuesit e fakultetit dhe departamentit, si dhe me stafin akademik të programit të studimit, rezulton se:</p> <p>UAL kontribuon si me nxitje financiare, po ashtu edhe duke i vënë në dispozicion ambientet dhe infrastrukturën e tij për organizim konferencash, simpoziumesh, panaiere dentare, aktivitete të ndryshme; po ashtu edhe me personelin e tij akademik të cilët kanë referuar në këto aktivitete të ndryshme shkencore. Të gjitha aktivitetet që janë organizuar në UAL dhe ato aktivitete në të cilën UAL ka qenë pjesëmarrëse, janë depozituar në sekretarinë përkatëse, duke regjistruar të gjitha të dhënat e programeve të kualifikimit, duke</p>

Practus

[Signature]

	filluar nga numri i pjesëmarrësve, tematika e trajtuar, temat për të cilat është folur, ekspozitat e ndryshme, etj.
Standardi IV. 7- Institucioni mban një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të përfshirë në këtë veprimtari, në rast se ka, edhe të mbështetjes financiare të institucionit ndaj tyre.</p> <p>Kriteri 2 Baza e të dhënave përmban botime akademike (tekste, monografi, libra, artikuj) apo kumtesa në konferenca brenda a jashtë vendit.</p>	<p>Universiteti Aldent ka të dhëna të sakta mbi aktivitetin shkencor dhe veprimtarinë botuese të stafit të tij akademik. Ai ka krijuar një arkiv të rregullt ku janë të dokumentuara aktivitetet e ndryshme shkencore e akademike, që janë kryer dhe ku ka pasur pjesëmarrje të pedagogëve dhe personelit ndihmës të institucionit. <i>Libri Abstrakteve të Konferencës.</i></p> <p>Ndërkohë, vetëm për kërkimin shkencor dhe veprimtaritë e lidhura me të, UAL disponon një revistë shkencore https://www.ajbsonline.com, në të cilën janë të publikuara jo vetëm aktivitetet e institucionit. Në këtë arkiv janë të përfshira dhe të gjitha botimet akademike e shkencore të realizura nga stafi i këtij universiteti si artikuj, libra, kumtesa etj, si për aktivitete kombëtare, ashtu edhe ato ndërkombëtare. Për zhvillimin e veprimtarive shkencore si konferenca, workshope, trajnime, seminare, UAL ka vënë në dispozicion online një platformë të dedikuar për veprimtaritë shkencore për stafin dhestudentët, në të cilën gjenden të detajuara të gjitha veprimtaritë e zhvilluara nga UAL.</p> <p>https://www.aldentconference.org/</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Nga sa më sipër rezulton se, UAL ka kapacitete të mjaftueshme në personel akademik, administrativ dhe ndihmës për të mbuluar nevojat e këtij program studimi. Për rekrutimin e stafit akademik, institucioni ka të përcaktuar në statutin dhe rregulloren e tij procedurat ligjore dhe rrugën që ndiqet për punësimin e stafit akademik e ndihmës.</p> <p>Programi i studimit disponon në nivel departamenti, pedagogë universitarë me grada dhe tituj shkencor, “Profesorë”, “Profesorë të Asociuar” dhe “PhD”, të fituara në universitete të mirënjohura në botë, si në Itali, Japoni etj.</p>	

Prabhu *Jey*

Çdo student ka një tutor (udhëheqës klinik) që e ndjek atë gjatë gjithë periudhës së specializimit. UAL disponon dhe arkivën e saj elektronike, ku ruhen të dhënat që kanë të bëjnë me stafin akademik, trajnimet që kryhen në vazhdimësi pranë universitetit dhe të dhënat e studentëve.

4. Infrastruktura dhe logjistika në funksion të programit të SPA

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, spitale, klinika, pajisjet spitalore, teknologjitë e informacionit (IT), biblioteka, shërbime të tjera për studentët. Mjediset të ndara në Struktura Qëndrore dhe Struktura dytësore

Universiteti Aldent ka aktualisht infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve që ofron në të tre ciklet e studimit, përfshirë edhe programin e specializimit afatgjatë, SPA. Institucioni disponon 4 godina të pajisura me infrastrukturën e nevojshme.

UAL ka organizuar infrastrukturën e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të programit të SPA. Për studentët janë në dispozicion rreth 10.800 m², në të cilën përfshihen salla leksionesh dhe seminaresh me kapacitet nga 30 deri në 120 studentë, laboratorë të pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme, zyra për stafin dhe qeverinë studentore, bibliotekë, kafeteri, parking, etj. Të gjitha sallat janë të pajisura me video-projektor, kompjuter të lidhur me internet dhe tabela. Godinat në kampusin e ri përmbushin jo vetëm standardet shqiptare të ndërtimit, por edhe ato europiane. Hapësirat e bollshme, ndriçimi natyral, përmbushin më së miri nevojat për një mësimdhënie cilësore. Për studentët e Shkencave Dentare janë në dispozicion ambiente me sipërfaqe rreth 4500 m², në të cilën përfshihen salla leksionesh dhe seminaresh me kapacitet nga 30-80 -120 studentë. Ka laboratore të pajisura me aparaturat e nevojshme, zyrat e duhura për stafin dhe qeverinë studentore, bibliotekë, kafeteri, parking për studentët e stafin etj. (Planimetri Kampusi i ri; 10.Planimetritë Kampus A+B)

Nga vizita në institucion, vëzhgimi i ambjenteve, rezulton se, personeli akademik i çdo fakulteti e departamenti, si dhe ai administrativ ka mjedise të veçanta e të mjaftueshme e komode për të kryer normalisht aktivitetin e tij dhe për studim individual. Biblioteka është e pajisur dhe e informatizuar me një sallë me kapacitet rreth 60 poste leximi, 15 poste interneti të pajisura me kompjuter dhe biblioteka, që kanë rreth 20.000 tituj nga të cilët 3000 tituj janë literaturë profesionale. Sigurohet akses edhe në bibliotekat dixhitale online si Hinari, biblioteka e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, apo libraria online e vënë në dispozicion nga RASH. Sigurimi i literaturës online në bibliotekën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, ku disponohen vetëm libra me karakter mjekësor dhe kjo është për tu vlerësuar, pasi dihet nevoja për të përdorur literaturën më të fundit të fushës së mjekësisë. Në të gjitha mjediset e UAL, është siguruar ngrohja dhe ftohja qëndrore, burime alternative për furnizimin me ujë dhe energji elektrike, si dhe shkallë emergjence, fushë sportive, kafe-bar dhe mjedise të tjera argëtimi dhe pushimi. Të gjitha mjediset kanë të instaluar sistemin kundër zjarrit. Ato plotësojnë kushtet teknike të parashikuara me ligj për mbrojtjen nga zjarri. Ambientet mësimore janë të pajisura të gjitha me kamera të cilat monitorohen 24 orë.

Prubus
Jey

Një nga pikat më të forta të institucionit është infrastruktura laboratorike. Në funksion të programit, janë vënë në dispozicion klinika dhe laboratorë në shërbim të studentëve, që ndjekin programin e studimit “Specializim Afatgjatë në Stomatologji” si p.sh:

Klinika e Dentistrisë Restorative dhe Endodoncisë, që përmban 7 unite dentare, në të cilat studentët trajtojnë pacientë të ndryshëm duke u ofruar shërbime që nga mbushjet e thjeshta deri tek trajtimet e ndërlikuara të kanaleve të rrënjëve të dhëmbëve.

Klinikat e Kirurgjisë Orale janë të vendosura në katin e parë të universitetit Aldent. Secila përmban nga 2 unite dentare, si dhe të gjitha instrumentet e nevojshme për realizimin e ndërhyrjeve ambulatorë kirurgjikale, si heqje dhëmbësh, heqje rrënjësh, heqje të dhëmballëve të pjekurisë, etj. Çdo ndërhyrje mbikqyret nga pedagogu dhe asistenti i sallës gjatë gjithë kohës.

Klinikat e Ortodoncisë ndodhen në katin e parë dhe të dytë të kompleksit laboratorik të Universitetit Aldent. Në të gjenden posaçërisht 10 dhe 2 unite dentare. Sallat janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që studentët të punojnë në grupe të vogla. Në sallë gjenden materialet e nevojshme për marrjen e masës dhe aplikimin e kontrollin e aparateve ortodontike fikse dhe të lëvizshme.

Klinika e Periodontologjisë dhe Sëmundjeve të Mukozës janë të vendosur në katin e dytë të Universitetit Aldent. Këto 2 klinika përmbajnë secila nga 3 unite dentare, si dhe të gjitha instrumentet e nevojshme për kryerjen e ndërhyrjeve periodontale. Pedagogu dhe asistenti i sallës janë të pranishëm gjatë gjithë kohës dhe monitorojnë çdo lloj procedure që kryhet gjatë orëve të praktikës, duke siguruar trajtimin sa më korrekt të pacientëve.

Klinika e Protetikës Stomatologjike është e vendosur në katin e parë të kompleksit laboratorik. Kjo klinikë përmban posaçërisht 3 dhe 2 unite dentare, si dhe të gjitha pajisjet dhe instrumentet e nevojshme për të trajtuar pacientë të ndryshëm për zëvendësimin e dhëmbëve me ura fikse, proteza parciale të thjeshta, proteza parciale të skeletuara ose me atashmente, proteza totale, etj. Çdo procedurë dhe ndërhyrje që kryhet në pacient monitorohet dhe kontrollohet nga pedagogu dhe asistenti i sallës, duke mundësuar trajtimin sa më korrekt të pacientëve.

Klinika e Dentistrisë Pediatrike është e vendosur në katin e parë të universitetit Aldent. Kjo klinikë përmban 7 unite dentare si dhe të gjitha instrumentet dhe pajisjet e nevojshme për trajtimet dentare të fëmijëve duke filluar që nga silantet, mbushjet e dhëmbëve të qumështit, mbushjet e dhëmbëve të përhershëm të sapodalë, trajtimet e kanaleve të rrënjëve të dhëmbëve të qumështit si dhe të dhëmbëve të përhershëm të sapodalë me apeks te papërfunduar.

Laboratori i Dentistrisë Paraklinike është i vendosur në katin e parë të kampusit qendror të Universitetit, përmban 2 unite dentare dhe 40 manekina me unite të inkorporuara, si dhe të gjitha pajisjet dhe instrumentet e nevojshme për të përgatitur studentët në menaxhimin e rasteve të ndryshme në fushën e Dentistrisë Restorative dhe jo vetëm.

Labororet e Protetikës Fikse janë të vendosur në kompleksin laboratorik të universitetit dhe janë të organizuar në mënyrë të tillë që të kenë të gjitha hapësirat e nevojshme për realizimin e procedurave laboratorike për dizajnimin e një punimi fiks me rreth 20 poste pune secila.

Laboratori i Ortodoncisë Paraklinike është i organizuar në mënyrë të tillë që studentët të kenë të gjitha lehtësitat e nevojshme për përvetësimin e njohurive laboratorike në realizimin e një

Prachas
Jey

aparati ortodoncic të lëvizshëm. Ky laborator ka gjithsej 20 vende pune, ku mësimi bëhet në grupe të vogla dhe çdo student ka hapësirat e tij. Aty nuk mungojnë modelet e allçisë sipas anomalive të caktuara, rezinat e llojeve të ndryshme, telat për ndërtimin e elementeve metalike. Gjatë praktikave studentët mbikqyren nga pedagogët mjekë dhe laborantë.

Laboratori i Protetikës Mobile është i pajisur me aparaturat bashkëkohore të nevojshme për konstruktimin e një proteze të lëvizshme. Laboratori i përpunimit të metal/porcelanit përmban të gjitha aparaturat e nevojshme për realizimin e etapave laboratorike të përpunimit të metal/porcelanit. Është i ndërtuar nga unite pune për çdo student dhe aparatura të standardeve europiane si, furra e derdhjes së metalit, furra e pjekjes së porcelanit, sabloza, elektroliza, si dhe pajisjet e nevojshme për lustrimin dhe përpunimin përfundimtar të një punimi protetik. Çdo procedurë e kryer nga studentët monitorohet nga pedagogu dhe laboranti i sallës.

Laboratori i informatikës përmban rreth 60 PC dhe përdoret jo vetëm për procesin mësimor, por edhe nga studentët që duan të zhvillojnë punime apo detyra të ndryshme, teste dhe kuize gjatë gjithë vitit akademik.

Laboratori i imazherisë dixhitale është një risi në kampusin e ri. Përdoret gjërësisht për implementimin e teknikave digjitale, vizualizimin dhe përpunimin e imazheve mjekësore në stomatologji etj. Të gjitha sallat e laboratoreve dhe leksioneve janë me ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial, me dritare me dopio xham si dhe me ajër të kondicionuar. Ndërtesat janë tepër moderne të pajisura dhe shumë të mirëmbajtura si nga studentët dhe personeli. Laboratorët e sipërpërmendur janë në përdorim të të dy profileve të specializimit afatgjatë në stomatologji. (*Planimetri Kampusi i ri.; Planimetritë Kampus A+B .; Organigrama ALDENT.; Tabelat*)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
STANDARDI III - INSTITUCIONI DISPONON TË GJITHA KAPACITETET INFRASTRUKTURE, TEKNOLOGJIKE DHE ORGANIZATIVE TË NEVOJSHME TË PARASHIKUARA PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË	
Standardi III. 1- Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimit të të gjitha cikleve të studimit dhe në veçanti të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qëndror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore.	Gjatë vizitës në institucion, vëzhgimit të amjenteve, rezulton se UAL disponon infrastrukturë dhe logjistikë nga më modernet në vend. Në funksion të programit, janë vënë në dispozicion klinika dhe laboratorë në shërbim të studentëve që ndjekin programin e studimit si

Prachas *guy*

Kriteri 2 Këto mjedise duhet të jenë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet.

Kriteri 3 Institucioni duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme infrastrukturore dhe teknologjike. Ai disponon struktura administrative dhe klinike, të mjaftueshme për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit specializues sipas standardeve specifike bashkëngjitur këtij dokumenti (Shtojca 2).

Kriteri 4 Institucioni disponon struktura të akredituara për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme klinike dhe didaktike. Akreditimi i këtyre infrastrukturave kryhet nga MASH/APAAL në bashkëpunim me MSH/Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore. Objekt i akreditimit janë strukturat përbërëse pjesë të rrjetit formues të njësisë që ofron programet e studimit specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë. Për struktura nënkuptohen strukturat fizike (departamentet, njësitë operative, shërbimet, qendrat, laboratorët, poliambulatorët, etj) pjesë e rrjetit formues ku zhvillohen aktivitetet dhe shërbimet e nevojshme për formimin e specializantëve.

Veçanërisht objekt i akreditimit janë strukturat qëndrore të njësisë që ofron programet e studimeve specializuese afatgjata, si ato të fakultetit apo universitetit. Këto struktura si dhe menaxhimi organizativ, administrativ, didaktik dhe teknik shëndetësor dhe aktivitetet e lidhura me to, koordinimi dhe/ose drejtimi i tyre për çdo njësi që ofron programe studimi specializimi, duhet të jenë të përshtatshme dhe strukturat të pajisura mjaftueshëm për organizimin dhe realizimin e aktivitetit formues profesional specializues në fushën e mjekësisë. Edhe në rastet kur mund të ekzistojnë më shumë se një strukturë e akredituar si struktura qëndrore/bazë, vetëm një prej tyre mund të

p.sh: Klinika e Dentistrisë Restorative dhe Endodoncisë që përmban 7 unite dentare në të cilat studentët trajtojnë pacientë të ndryshëm, duke u ofruar shërbime që nga mbushjet e thjeshta deri tek trajtimet e ndërlikuara të kanaleve të rrënjëve të dhëmbëve.

Klinikat e Kirurgjisë Orale janë të vendosura në katin e parë të universitetit Aldent. Secila përmban nga 2 unite dentare, si dhe të gjitha instrumentet e nevojshme për realizimin e ndërhyrjeve ambulatorie kirurgjikale, si heqje dhëmbësh, heqje rrënjësh, heqje të dhëmballëve të pjekurisë, etj. Çdo ndërhyrje që kryhet mbikqyret nga pedagogu dhe asistenti i sallës gjatë gjithë kohës.

Klinikat e Ortodoncisë ndodhen në katin e parë dhe të dytë të kompleksit laboratorik të Universitetit Aldent. Sallat janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që studentët të punojnë në grupe të vogla.

Në sallë gjenden materialet e nevojshme për marrjen e masës dhe aplikimin e kontrollin e aparateve ortodoncike fikse dhe të lëvizshëm. Klinika e Periodontologjisë dhe Sëmundjeve të Mukozës janë të vendosur në katin e dytë të Universitetit Aldent. Këto 2 klinika përmbajnë secila nga 3 unite dentare, si dhe të gjitha instrumentat e nevojshëm për kryerjen e ndërhyrjeve periodontale. Nga takimi me stafin akademik, GVJ u informua se, pedagogu dhe asistenti i sallës janë të pranishëm gjatë gjithë kohës dhe monitorojnë çdo lloj procedure, që kryhet gjatë orëve të praktikës, duke siguruar trajtimin sa më korrekt të pacientëve. Klinikat e Protetikës Stomatologjike janë vendosur në katin e parë të kompleksit laboratorik. Këto klinika përmbajnë posaçërisht 3 dhe 2 unite dentare, si dhe të gjitha pajisjet dhe instrumentat e nevojshme për të trajtuar pacientë të ndryshëm për zëvendësimin e dhëmbëve me ura fikse, proteza parciale të thjeshta, proteza parciale të skeletuara ose me atashmente, proteza totale, etj.

Practus
[Signature]

konsiderohet si strukturë bazë efektive e njësisë që ofron programet specializuese afatgjata.

Objekt i akreditimit janë edhe strukturat dytësore të konvencionuara me strukturën qëndrore/bazë të cilat shërbejnë për të arritur ose kompletuar aktivitetin asistencial të kërkuar për formimin e specialistit, të cilat mund të jenë struktura universitare ose jo universitare, të të njëjtës strukturë spitalore ose jo. Në rastet kur programi i studimit parashikon frekuentimin e strukturave, shërbimeve, aktiviteteve, laboratorëve ose gjithçka tjetër që nuk bën pjesë në strukturën qendrore/bazë ose në strukturat dytësore të lidhura me të, institucioni që ofron programin e studimit lidh një kontratë ose konvencion me këto struktura komplementare. Në këto raste duhet të ketë marrëveshje të veçanta mes IAL-së dhe strukturës në fjalë dhe të respektohen standardet e parashikuara për strukturat qendrore/bazë e dytësore.

Kriteri 5 Akreditimi i strukturave të rrejtit formues bëhet pas verifikimit të plotësisht nga ana e IAL-së të standardeve të përshkruara në këtë dokument dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe i jep të drejtën IAL-së që ofron programet specializuese të përdorë këto struktura për të organizuar e realizuar aktivitetin formues specializues për secilin specialitet. Strukturat e akredituara për një specialitet të caktuar mund të shtrijnë aktivitetin formues, me kërkesë të IAL-së, edhe në specialitete të tjera me kusht që të plotësojnë të gjitha standardet dhe kriteret e parashikuara për atë specialitet.

Kriteri 6 Institucioni mund të organizojë programe të përbashkëta të studimeve specializuese afatgjata me një a më shumë institucione të tjera në vend, të njohura/akredituara nga MASH/APAAL në bashkëpunim me MSH/Qëndrën Kombëtare të Cilësisë Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore, ose të huaja të

Çdo procedurë dhe ndërhyrje që kryhet në pacientë, monitorohet dhe kontrollohet nga pedagogu dhe asistenti i sallës duke mundësuar trajtimin sa më korrekt të pacientëve.

Klinika e Dentistisë Pediatrike përmban 7 unite dentare si dhe të gjitha instrumentet dhe pajisjet e nevojshme për trajtimet dentare të fëmijëve duke filluar që nga silantet, mbushjet e dhëmbëve të qumështit, mbushjet e dhëmbëve të përhershëm të sapodalë, trajtimet e kanaleve të rrënjëve të dhëmbëve të qumështit si dhe të dhëmbëve të përhershëm të sapodalë me apeks të papërfunduar.

Poliklinikat, labororet, pajisjet teknologjike janë të tilla që në cikël të mbyllur të realizojnë gjithçka në aspektin teorik dhe praktik brenda ambienteve të UAL.

Në të gjitha rastet kur për ndonjë modul të veçantë nevojitet më tepër, UAL ka kontrata të rregullta bashkëpunimi prej më shumë se 10 vitesh me Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitalin Universitar të Traumës etj. Kjo është e nevojshme vetëm për raste të veçanta, pasi për programet e specializimit që Universiteti ofron, Kirurgji Dentare dhe Ortodonci, ato janë specializime që në gjithë botën ushtrohen në kushte ambulatorë, të cilat institucioni i plotëson tërësisht.

Marreveshjet e bashkëpunimit.pdf;

Tabelat .pdf;

Pruchas
guy

<p>akredituara për zhvillimin e programeve specializuese analoge në vendin përkatës, në bazë marrëveshjesh midis tyre.</p>	
<p>Standardi III. 2 - Strukturat e përfshira duhet të disponojnë standardet e përgjithshme dhe specifike të parashikuara</p>	
<p>Kriteri 1 Strukturat qendrore dhe dytësore disponojnë standarde të përgjithshme në përputhje me kapacitetin infrastrukturor, teknologjik, organizativ dhe asistencial sipas kriterëve të mëposhtme dhe sipas kriterëve specifike të parashikuara në shtojcën 2:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Kapaciteti infrastrukturor: hapësira të mjaftueshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara; b. Kapaciteti teknologjik: pajisje të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara; c. Kapaciteti organizativ: kompetenca të nevojshme profesionale; d. Kapaciteti asistencial: sasi dhe tipologji të caktuar të ndërhyrjeve klinike. <p>Kriteri 2 Të gjitha strukturat (psh. auditorët, biblioteka, sekretaritë, etj.) plotësojnë standardet e përgjithshme.</p> <p>Kriteri 3 Struktura bazë është e pajisur me ambientet/pajisjet e nevojshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. për administratën dhe strukturat ndihmëse (sekretari didaktike, bibliotekë tradicionale dhe telematike, sallë mbledhjesh, dhomë për specializantët) b. kompjuter në dispozicion të sekretarisë dhe administratës c. program të kompjuterizuar për menaxhimin e të dhënave të sekretarisë didaktike d. faqe interneti të tijin 	<p>Nga takimi me studentët dhe vizita në institucion rezulton se, UAL ka kapacitete të mjaftueshme infrastrukturore dhe teknologjike për të përballuar numrin e studentëve që ndjekin programin e specializimit afatgjatë. Me qëllim që specializantët të kenë sa më tepër hapësira në dispozicion, drejtuesit e UAL kanë vendosur që ky program të mos hapet çdo vit, por çdo 2-3 vite, në varësi të kushteve dhe mundësisë së institucionit për të plotësuar më së miri kërkesat maksimale për një zhvillim cilësor të mësimin. Kapaciteti infrastrukturor është brenda kufijve të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, rezulton se, UAL ka një staf të mjaftueshëm dhe me kompetencat e duhura profesionale për të realizuar programin e studimit. Poliklinikat universitare Aldent realizojnë të gjitha tipologjitë që janë të detyrueshme për t'u realizuar nga studentët gjatë gjithë periudhës së studimeve. Për më tepër, institucioni ka bibliotekë me një numër të mjaftueshëm titujsh, biblioteka online, sekretari të dixhitalizuar etj. Struktura ka ambjentet e duhura për administratën, sekretaritë, sallë biblioteke dhe IT, sallë mbledhjesh, sallë për specializantët etj. Sekretaria është e kompjuterizuar dhe natyrisht ka shumë kompjutera.</p> <p>Institucioni ka faqen e tij të internetit: www.ual.edu.al. Kompjutera në dispozicion të studentëve të lidhur në internet, e-mail për specializantët, si dhe sistemin e tij të brendshëm UAL-LMS. UAL ka marrëveshje me Qendrën Spitalore Universitare dhe Spitalin Universitar të Traumës, nëse do të jetë e nevojshme për shtretër,</p>

Prachas

[Signature]

<p>e. linja telefonike dhe pajisje për fotokopje</p> <p>f. salla për leksionet dhe seminarat</p> <p>g. laboratorë kërkimorë dhe didaktikë</p> <p>h. kompjuter në dispozicion të studentëve të pajisur me lidhje interneti dhe akses në bazat e të dhënave profesionale on line (së paku 1 kompjuter / 5 studentë)</p> <p>i. adresë poste elektronike personale për specializantët të ofruar nga struktura universitare</p> <p>j. ambulatorë dhe struktura asistenciale (me pajisjet e nevojshme teknologjike sipas specialitetit)</p> <p>k. ambiente spitalore me shtretër (në rastet kur janë parashikuar në standardet specifike të specialitetit në shtojcën 2)</p> <p>Ambjentet më sipër sigurojnë standardet e sigurisë dhe ato higjienike dhe nuk kanë barriera arkitektonike që pengojnë aksesin në veprimtaritë e ndryshme të parashikuara nga programi i studimit.</p> <p>Kriteri 4 Çdo program specifik i specializimit plotëson standardet specifike sipas tipologjisë së specializimit (psh. laboratorë specifikë, shërbime, shtrime spitalore, etj.) sipas shtojcës 2. Standardet specifike ndahen në:</p> <p>a. bazë: standarde që duhet domosdoshmërisht të përmbushen si nga struktura bazë dhe nga strukturat dytësore/satelite.</p> <p>b. dytësore: standarde që, për të plotësuar kriteret e akreditimit të strukturës, duhet të plotësohen si nga struktura qendrore edhe nga ajo dytësore ose nga strukturat të tjera të IAL-së sipas një përqindjeje të caktuar të parashikuar për akreditimin. Nëse nuk plotësohen as nga struktura bazë e</p>	<p>pasi të dy profilet si Kirurgjia Orale dhe Ortodoncia janë tërësisht ambulatorë.</p> <p>UAL ka kapacitete të mjaftueshme në personel mjekësor dhe ndihmës për të mbuluar nevojat e specializantëve në profilet e ofruara. UAL ka një organigramë të përcaktuar dhe të aprovuar nga instancat kompetente dhe përmbush të gjitha kriteret për numrin dhe përbërjen e stafit akademik, administrativ dhe ndihmës. Institucioni disponon gjithë dokumentacionin e duhur që trgon mënyrën e organizimit dhe strukturën drejtuese të institucionit.</p>
--	--

Prabh...

guy

as nga ajo dytësore duhet të plotësohen nga strukturat komplementare me të cilat ka një marrëveshje bashkëpunimi.

- c. shërbime të përgjithshme: janë shërbimet operative që duhet të ketë struktura në të cilën bën pjesë struktura qendrore ose ajo dytësore që do të akreditohen.

Kriteri 5 IAL-të duhet të komunikojnë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të gjitha ndryshimet e kriterëve dhe standardeve që kanë mundësuar akreditimin jo më vonë së 30 ditë nga ndryshimi. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës ekzaminojnë kriteret dhe standardet e ndryshuara dhe japin miratimin e tyre mbi këto ndryshime.

Kriteri 6 Institucioni që ofron programet specializuese ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, ndihmës dhe administrativ kompleksiv në strukturat qendrore dhe dytësore për të mbuluar nevojat e specialiteteve të ofruara, në bazë të kapaciteteve.

Kriteri 7 Institucioni që ofron programet specializuese është i mirëorganizuar dhe disponon dokumentacion që tregon mënyrën e organizimit dhe strukturën drejtuese si dhe personelin administrativ dhe akademik me titujt përkatës si dhe rolet e parashikuara për secilin.

Konkluzionet e vlerësimit:

Referuar gjetjeve dhe konstatimeve të mësipërme, rezulton se Universiteti Aldent disponon infrastrukturë, logjistikë, facilitete dhe shërbime nga më cilësoret në vend. Kampuset e institucionit përmbushin kërkesat dhe standardet për zhvillimin e proceseve akademike e shkencore në nivelin maksimal.

Infrastruktura laboratorike dhe e praktikave profesionale, është nga më të mirat në vend. Falë investimeve të kryera në vitet e fundit, institucioni garanton infrastrukturën e nevojshme, të mjaftueshme dhe të mirëpajisur me të gjitha aparaturat, pajisjet dhe materialet e teknologjisë

Prabh...
Jey

së fundit, për realizimin me sukses të programit të studimit specializim afatgjatë në profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonci.

Niveli i shërbimeve teknologjike, IT, sistemet e informimit, biblioteka, libraritë online, facilitetet e rekreacionit, sportive dhe shërbimet ndaj studentëve, janë në nivel të kënaqshëm, e shprehur kjo edhe në pyetësorin e realizuar me studentët SPA.

Bashkëpunimi me institucionet spitalore garanton zhvillimin e praktikave klinike në qendra spitalore ndër më të njohurat në vend.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, shpenzimet, kostoja për student, kontrolli financiar, kapacitetet menaxhuese.

UAL financohet kryesisht nga burimet e veta të brendshme siç janë tarifat e shkollimit të studentëve. Siç paraqitet dhe në tabelën më poshtë, të ardhurat e UAL kanë ardhur në rritje nga viti në vit pavarësisht situatës së krizës ekonomike. Duhet theksuar se këto tarifa janë konkurruese në treg dhe kushtet e mësimdhënies janë nga më të mirat në vend.

Të ardhurat nga:	2016	2017	2018	2019	2020
Fonde publike:					
Pushteti qendror	-	-	-	-	-
Pushteti vendor	-	-	-	-	-
Gjithsej	-	-	-	-	-
Fonde jopublike:					
Grantet për kërkim dhe kontratat	-	-	-	-	-
Konsulencat, shërbimet	-	-	-	-	-
Tarifat (regjistrim/shkollim/e tj)	391,207,32 8	444,306,77 1	478,734,32 9	501,904,49 6	573,623,57 5
Sponsorizimet	-	-	-	-	-
Tarifat për trainim (kualifikimi i vazhdueshëm)	-	-	-	-	-
Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj	-	-	-	-	-
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)	-	-	-	-	-
Gjithsej	-	-	-	-	-
SHUMA	391,207,32	444,306,77	478,734,32	501,904,49	573,623,57

Prabh...

[Signature]

	8	1	9	6	5
--	---	---	---	---	---

Nga takimi me Dekanin dhe Drejtuesin e departamentit, GVJ u informua se, kur hartohet buxheti përfshihen të gjitha kostot e një programi të studimit, burimet njerëzore dhe infrastrukurore, materialet e konsumit, pajisjet, zhvillimin e praktikave spitalore, pasurimit të bibliotekës, kostot e auditeve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe mundësitë e mbështetjes financiare, ku Universiteti Aldent është partner i vetëm dhe vetëfinancon të gjitha shpenzimet. Ecuria e institucionit ka qenë e qëndrueshme, me rritje të vazhdueshme nga viti në vit. Nuk ka detyrime ndaj të tretëve, qofshin këta individë apo organizata, banka, apo ndaj organeve tatimore. Rritja ekonomike i ka shërbyer rritjes së cilësisë në saj, shtimit të numrit të punonjësve, shtimit të laboratoreve dhe infrastrukturës në shërbim të studentëve. Pavarësisht vështirësive të evidentuara gjatë pandemisë, treguesit makroekonomikë të institucionit janë të qëndrueshëm. Mirëadministrimi i të ardhurave dhe hartimi i planeve të detajuara, i kanë dhënë mundësi institucionit të ruajë stabilitetin financiar dhe të garantojë realizimin e investimeve të parashikuara në infrastrukturë, laboratorë dhe logjistikën e nevojshme. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion, është analizuar shpërndarja sipas zërave të buxhetit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II. 3- Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të gjendjes financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjitha detyrimet financiare, pagat dhe mbështetjet financiare të programit.</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja dhe kontratave të shërbimeve në lidhje me programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB - së dhe takimit me dekanin, GVJ u informua se, institucioni në mënyrë të përvitshme realizon vlerësime dhe audite lidhur me performancën financiare të institucionit. Përveç detyrave të tjera, UAL është i vetëdijshëm për impaktin social që ka aktiviteti i tij në përgatitjen e specialistëve të lartë të fushës së mjekësisë e tani të specialistëve në SPA. Njëkohësisht, zbatohen detyrimet specifike si biznes, që paguan rregullisht taksat dhe tatimet ndaj shtetit dhe obligohet me ligj që të hartojë nje bilanc ekonomik vjetor. Ky bilanc i është nënshtruar auditimit të brendshëm dhe të jashtëm nga ekspertë të licensuar. Ai është monitoruar nga strukturat shtetërore e tatimore në mënyrë periodike dhe rezulton të jetë nje aktivitet i rregullt dhe që nuk ka asnjë problem lidhur me</p>

Prubus

guy

	detyrimet ndaj shtetit, me studentët e specializantët apo me të tretët.
STANDARDI VIII - INSTITUCIONI DISPONON DHE MENAXHON BURIMET FINANCIARE	
Standardi VIII. 1- Institucioni harton një raport financiar të kostos së programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të kostove të përfshira në realizimin e programit të studimit, si kostot operacionale, kostot fikse të ambienteve dhe të pajisjeve, kostot e personelit, etj.</p> <p>Kriteri 2 Raporti financiar përmban të ardhurat e programit për vitet e kaluara akademike.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së programit të studimit dhe dëshmon se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p> <p>Kriteri 4 Programi i studimeve specializuese mbështetet nga një buxhet i mjaftueshëm për të arritur objektivat e programit për çdo student.</p>	<p>Referuar RVB, rezulton se, bilancet dhe auditet financiare përmbajnë të gjitha të dhënat e domosdoshme, si të ardhurat, shpenzimet për paga, siguracione, tatime, shpenzimet për lëndë të parë dhe materiale konsumi stomatologjike dhe jo vetëm, për IT, për libra e revista, për kërkime shkencore, për qeratë dhe gjithçka tjetër që lidhet me infrastrukturën e institucionit.</p> <p>Siç është theksuar më lart, nuk ka bilance të veçanta sipas programeve të studimeve, ndonjë prej të cilëve mund të mos figurojë ndonjë vit rentabël, por institucioni funksionon si një entitet i vetëm ekonomik.</p> <p>Pavarësisht vështirësive që solli pandemia Covid 19, UAL rezulton të jetë një institucion, që manifeston qëndrueshmëri ekonomike afatgjatë dhe kjo ka bërë që në mënyrë progresive të shtojë investimet nga viti në vit dhe të hapë programe të reja studimi.</p> <p>Përveç ndërtimit të kampusit të ri që ka qënë një nga investimet kolosale, investimet janë shtuar edhe në pasurimin e pajisjeve teknologjike, blerjen e bazës materiale nga firma prestigjioze e shoqëruar me çertifikatë cilësie dhe origjinë të mallit. Investime të spikatura janë bërë edhe në drejtim të shtimit të stafit akademik, sidomos të atyre me tituj dhe grada shkencore dhe në fushën e kualifikimit të vazhduar të tyre. Programi SPA mbështetet nga një buxhet i mjaftueshëm për të arritur objektivat e programit, çka jep garanci për një zhvillim të qëndrueshëm dhe afatgjatë të tij.</p> <p><i>4.Tabelat</i></p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	

Practus

[Signature]

Referuar të gjitha të dhënave të paraqitura më sipër, treguesve financiarë, analizës dhe evidencave të paraqitura, rezulton se Universiteti Aldent gëzon një situatë të qëndrueshme financiare në rritje nga viti në vit. Burimet financiare sigurohen me forma të ndryshme ku pjesën më të madhe e zënë të ardhurat nga studentët. Mirëmenaxhimi i të ardhurave ka mundësuar investime strategjike në infrastrukturë, logjistikë dhe pajisje laboratorike. Ndërkohë, zbaton me rigorozitet të gjitha detyrimet financiare, që lindin nga fusha e veprimtarisë si institucion arsimor jo publik dhe nuk ka detyrime apo barrë ndaj të tretëve dhe shtetit. Auditet dhe raportet financiare të kryera në mënyrë periodike, tregojnë se drejtuesit e institucionit jo vetëm garantojnë qëndrueshmëri të institucionit, por sigurojnë në mënyrë progresive buxhet të mjaftueshëm për të përballuar kriza dhe vështirësi, që ndeshen gjatë veprimtarisë së tyre, sikundër rezultoi pandemia Covid 19.

Prachas

[Signature]

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Terma reference: Monitorimi nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NjBSC), funksionet e saj në programet e SPA, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë.

Referuar takimit me NJSBC-në, GVJ u informua se, Sigurimi i Cilësisë në Universitetin Aldent është i konsoliduar për shkak se institucioni ka zhvilluar disa procese të vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Ajo ka autonomi operative dhe akses të plotë në të gjitha të dhënat e institucionit, që është e specifikuar edhe në rregulloren e tij dhe funksionon në përputhje me rregulloren specifike të hartuar sipas të drejtave dhe detyrimeve statuale. NJSBC siguron zhvillimin e cilësisë së arsimit në pajtim me ligjin mbi arsimin e lartë, statutin dhe rregulloren e Universitetit Aldent, standardet shtetërore dhe udhëzimet për vlerësimin e jashtëm nga ASCAL.

NJSBC ka nga një anëtar nga çdo fakultet i Universitetit Aldent, një ekspert të jashtëm dhe një përfaqësues të unionit studentor. Megjithatë, në funksion të procesit akademik ka një angazhim të shumëfishtë, që përfshin personelin e pritjes, tutorët akademikë, përgjegjësin e programit, sekretarinë mësimore, si dhe drejtuesit e njësive bazë, që janë në kontakt të vazhdueshëm me studentët dhe stafin e çdo programi studimi.

Në NJSBC përfshihet staf i brendshëm dhe përfaqësues të departamenteve të rëndësishme administrative të universitetit, të cilët janë në kontakt të drejtëpërdrejtë me mësimdhënien dhe problemet e lidhura me të. Në institucion u deklarua gjithashtu edhe angazhimi i ekspertëve apo institucioneve të tjera partnere që operojnë në fushën e cilësisë. Një nga bashkëpunimet e frytshme ka qënë zhvillimi i pyetësorit të studentëve të Universiteti Aldent për studentët e ciklit të parë dhe të dytë, si dhe me studentët e SPA-së me Institutin për Cilësi në Arsim. Kjo iniciativë e UAL vlerësohet pozitivisht pasi institucioni ka kryer një proces të vlerësimit dhe marrjes së mendimit të studentëve në një periudhë të vështirë pandemie. Një nga veprimtaritë më të rëndësishme të njësive është komunikimi me studentët, i cili realizohet nëpërmjet pyetësorëve. Universiteti Aldent rëndësi dhe vend të veçantë i kushton shërbimeve ndaj studentëve për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe veprimtarive të tjera. I gjithë stafi akademik është i informuar, merr pjesë dhe dëshmon angazhim maksimal në proceset e sigurimit të cilësisë. Institucioni ka krijuar mekanizmat e nevojshëm duke përdorur instrumente matëse dhe vlerësuese për vlerësimin periodik të programeve të studimeve dhe i ka përfshirë informacionet e nevojshme në të gjitha vlerësimet e brendshme të cilësisë. Në fund të çdo viti akademik, NJSBC publikon raportin vjetor, i cili përmban edhe plan masash për përmirësimin e treguesve me vlerë të ulët. Të gjitha gjetjet e vlerësimit vjetor janë pjesë e raportit vjetor të NJSBC-së, i cili i vihet në dispozicion rektoratit. Këto të dhëna janë bazë për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe vetëvlerësimit. Gjithashtu, institucioni kryen një vlerësim të brendshëm vjetor gjithëpërfshirës që përfshin gjithë programet, njësitë kryesore/bazë dhe ndihmëse, që e paraqet në një raport vjetor të Universitetit, i cili shërben si një historik për performancën institucionale. Ky raport i përvitshëm dërgohet konform legjislacionit edhe në MAS.

Prachus *Juy*


GVJ vlerësoi mjaft të plotë dhe informues raportin e hartuar nga njësia. Jo vetëm përmbajtja e raportit vjetor ishte e plotë, por mbi të gjitha paraqitja e informacionit ishte dhënë në mënyrë të qartë për personelin akademik dhe studentët. Ndërkohë, Senati Akademik, bazuar në gjetjet e njësisë, apo rezultateve të sondazheve të zhvilluara, ndërmerr masat që vlerëson në kuadër të përmirësimit të cilësisë dhe ka autoritet për të monitoruar implementimin e tyre. Vlen të përmenden përmirësimet e fundit të kryera gjatë vitit akademik 2020-2021, bazuar në kërkesat e dala nga pyetësi i studentëve të zhvilluar në bashkëpunim me Institutin për Cilësi në Arsim, IQE. (Rezultatet e pyetësorit)

Përfaqësuesi i NJSBC-së, shërbimi i tutoriatit akademik, si edhe përgjegjësit e programeve, luajnë rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin për sigurimin e cilësisë në programin mësimor. Për shkak të pamundësisë së komunikimit në auditore, është bërë një punë jashtëzakonisht e madhe me personelin akademik dhe studentët nëpërmjet grupeve virtuale me qëllim informimin, asistencën dhe trajnimin për një pjesëmarrje aktive dhe efektive në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. UAL bën rregullisht vlerësimin e performancës së përgjithshme, proces i cili realizohet në çdo vit akademik duke marrë mendimin e studentëve për të vlerësuar performancën e institucionit dhe të personelit akademik. Rezultatet janë paraqitur në dokumentet, në mbështetje të RVB-së. Pyetësi i studentëve të Universitetit Aldent është një procedurë e përvitshme që kryhet nga NJSBC, që ka për qëllim monitorimin dhe sigurimin e cilësisë duke u fokusuar në indikatorë të përgjithshëm dhe indikatorë specifikë të vlerësimit dhe monitorimit. GVJ vlerëson pozitiv faktin që institucioni u jep studentëve mundësinë për të vlerësuar performancën e pedagogëve të tyre. Kjo metodë rrit kërkesat e studentëve ndaj stafit dhe njëkohësisht shërben për promovimin e shembujve të mirë apo menaxhimin në kohë të rasteve problematike. Gjithashtu, për të monitoruar përmirësimin, raportet e çdo njësie dhe strukture përmbledhen në raportin vjetor të institucionit dhe bëhen publike në faqen zyrtare të tij. (Raport i NJSBC 2020-2021; Formulari i performancës akademike.; Vlerësimi sipas formatit elektronik të pyetësorit.)


Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I. 9- Institucioni përdor instrumente matës, vlerësues, metodologji vlerësimi.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor instrumente matës, vlerësues, metodologji vlerësimi dhe e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin në kohë të pedagogëve, tutorëve dhe strukturave të përfshira në rrjetin formues.</p>	<p>Referuar RVB-së, UAL disponon strukturën dhe mjetet matëse për vlerësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit që ai ofron. Nëpërmjet NJSBC-së, studentët e programit të studimit i nënshtrohen plotësisht të pyetësorve në fund të çdo semestri, për të dhënë opinionin e tyre mbi zhvillimin e programit të studimit, infrastrukturës etj. (11.1 Vlerësimi sipas formatit elektronik të pyetësorit.)</p> <p>Studentët njihen me rezultat e provimeve me anë të sistemit të informatizuar që UAL disponon dhe</p>

Practus



<p>Kriteri 3 Institucioni informon mbi rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet e pritshme.</p>	<p>kanë në dispozicion një afat kohor të caktuar për të shprehur pretendimet e tyre në lidhje me vlerësimin. (8.Print screen platforma online)</p> <p>Sistemi mundëson në mënyrë permanente intervistimin e studentëve për të gjitha aspektet e procesit arsimor. Stafit mësimdhënës i kërkohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik të bëjnë raporte mbi problematikat e hasura gjatë procesit akademik, por gjithashtu një feedback merret edhe nga mbikqyrësit e praktikave.(7.Lista e Tutoreve te angazhuar ne programin e studimit.)</p>
<p>STANDARDI IX- INSTITUCIONI DISPONON NJË STRUKTURË DHE MEKANIZMAT E POSAÇME TË PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË DHE PERFORMANCËS SË SAJ</p>	
<p>Standardi IX. 1- Institucioni disponon një strukturë dhe mekanizmat e posaçme të përmirësimit të cilësisë dhe performancës së saj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka dhe përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ka mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit, të cilat vlerësohen për pajtueshmërinë e programeve të reja të studimit me strategjinë e institucionit apo fakultetit, metodën e hartimit të programeve dhe zhvillimit të kompetencave të përshkruara në aktet ligjore apo standardet shtetërore të cilësisë.</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhohet për zhvillimin e një kulture që njeh rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në punën e tyre.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia,</p>	<p>UAL ka përmbyllur të gjitha obligimet ligjore për sa i përket standardeve institucionale. Për të siguruar instrumentet e duhura të sigurimit të cilësisë, Universiteti Aldent ka punuar në përputhje me Ligjin Nr.80/2015, me rregulloren e përgjithshme të UAL dhe statutin, neni 13: “Për organizimin e punës për kontrollin e brendshëm”.</p> <p>Në kuadër të ngritjes se grupeve vjetore te punës për SBC sigurohen të gjitha procedurat e caktuara për zhvillimine kompetencave të përshkruara në aktet ligjore apo standardet shtetërore të cilësisë. Institucioni ka të përcaktuar procedurat për njohjen me standartet e cilësisë dhe shpjegimine rëndësisë së tyre.Universiteti Aldent në kuadër të Planit të vet të përgjithshëm Strategjik, rëndësi dhe vend të veçantë i kushton cilësisë së procesit mësimor, si edhe të gjitha shërbimeve mbështetëse për realizimin e këtij procesi. Pjesë e sigurimit të cilësisë janë dhe studentët, duke u përfshirë edhe ne hartimin e RVB-ve, apo përpunimin e të dhënave të NJSBC-së.</p> <p>Universiteti Aldent ka bërë të mundur krijimin e kulturës së cilësisë në Instiutucion përmes organeve të rëndësishme që merrem me sigurimin e cilësisë.</p>

Practus 

<p>politika dhe procedurat janë formale dhe në dispozicion të publikut.</p> <p>Kriteri 6 Studentët dhe aktorë të tjerë nga sektori punëdhënës janë të përfshirë në procesin dhe instrumentet e sigurimit të cilësisë.</p>	<p><i>Statuti i UAL.pdf</i> <i>Rregullore e Universitetit ALDENT.pdf</i> <i>Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.pdf</i></p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Në përfundim të gjetjeve dhe konstatimeve të mësipërme, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimet e bëra ne Universitetin Aldent, rezulton se ky institucion i përmbush në tërësi standartet e përcaktuara për Sigurimin e Cilësisë, infrastrukturën dhe mekanizmat e nevojshëm për këtë qëllim, ndjek në dinamikë problemin e plotësimit dhe përmirësimit të cilësisë së studimeve në SPA.</p> <p>Institucioni ka të konsoliduar sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili tashmë kryhen analiza të avancuara në kuadër të përmirësimit të cilësisë. Përfshirja e aktorëve brenda institucionit si studentë, pedagogë dhe staf administrativ, si dhe aktorë të jashtëm si ekspertë, organizma apo të punësuar, përbën një hap cilësor në performancën e vlerësimit që kryen institucioni.</p> <p>Mënyra e vlerësimit nëpërmjet sondazheve apo mekanizmave të tjerë, raportimi dhe informimi, gjithashtu janë të konsoliduara, duke mundur në këtë mënyrë jo vetëm procese që synojnë vlerësimin, por mbi të gjitha transparencë, informim dhe besueshmëri.</p>	

Prachas *Juy*

PROGRAMI I STUDIMEVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Emërtimi i Diplomës (në shqip dhe anglisht), misioni dhe objektivat e programit/eve të studimit, organizimi i vitit mësimor, përmbajtja e plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Referuar RVB rezulton se, programi i specializimit afatgjatë në Stomatologji në profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonci, është liçensuar me VKM nr. 299, datë 22.07.2013 dhe është aktivizuar në vitin shkollor 2013-2014. Programi në SPA është hartuar në përputhje me strategjinë e institucionit dhe po ashtu duke marrë parasysh dhe eksperiencën e universiteteve perëndimore plotëson kërkesat e Direktivës 2005/36/EC të Këshillit dhe të Parlamentit Europian. Programet janë të harmonizuara, ka raporte të drejta midis pjesës teorike dhe asaj praktike, lëndëve specifike e atyre bazë dhe lëndëve karakterizuese, sipas udhëzimeve që ka dhënë MASH në kohën kur është bërë licensimi i tyre. Të dhëna mjaft të detajuara lidhur me përmbajtjen e programeve në të dy profilet pasqyrohen në tabelat e mëposhtme:

- Programi bën pjesë në ciklin e tretë të studimit;
- Emërtimi i diplomës: Diplomë Specializimi Afatgjatë në Stomatologji;
- Profili: - Specialist në Ortodonci, - Specialist në Kirurgji Orale;
- Kohëzgjatja e programit të studimit: 3 vite akademike – 6 semestra;
- ECTS totale: 180 kreditë ECTS;
- Forma e studimit: Ky program studimi është me kohë të plotë;

Ndarja e lëndëve sipas tipit të veprimtarisë:


SPECIALIZIM AFATGJATË NË STOMATOLOGJI		kredite / ECTS	Totali
PROFILI: KIURGJI ORALE			
	Praktikë klinike I,II,III	30	108
	Kirurgji Dentoalveolare 1	14	
	Kirurgji Dentoalveolare 2	8	
	Kirurgji OMF	15	
	Implantologji 1	6	
	Onkologji	3	
	Paradontologji	7	
Lëndë specifike 60 %	Kirurgji e Përgjithshme	5	
	Kirurgji Plastike		

Practica

jeff

	Implantologji 2		
	ORL	4	
	Radiologji orale		
	Diagnostikim imazherik dhe radioterapi	5	
	Kirurgji Orale	6	
	Mjekësi orale		
	Patologji odonto-stomatologjike	5	
Lëndë bazë, ndërdisiplinore, deontologjike, etj 10%	Tezë diplome	20	26
	Mjekësi ligjore	2	
	Farmakologji	4	
Lëndë karakterizuese 30%	Anatomi Normale	3	46
	Anatomi Topografike	3	
	Anatomi Patologjike	6	
	Mikrobiologji orale	4	
	Biostatitike	2	
	Radiologji		
	Shkenca teknike mjekësore të aplikuara	4	
	Gjuhe Angleze Profesionale	2	
	Informatikë Mjekësore	2	
	Sëmundje të Brendshme	6	
	Pediatri		
	Neuro psikiatri infantile	4	
	Anest.Reanimacion	4	
	Sëmundje Infektive	2	
		4	
Metoda Kërkimi / Bioetike dhe Psikologji			

SPECIALIZIM AFATGJATË NË STOMATOLOGJI, PROFILI : OROTODONCI		kredite / ECTS	Totali
	Praktikë klinike I,II,III	30	108

Practus 

Lëndë specifike 60 %	Ortodonci Paraklinike	14	
	Ortodonci e Lëvizshme	10	
	Ortodonci Fikse	15	
	Implantologji 1	6	
	Paradontologji	7	
	Dentistri Pediatrike	6	
	Neuro psikiatri infantile		
	Implantologji 2	4	
	ORL		
	Radiologji orale	5	
	Diagnostikim imazherik dhe radioterapi		
	Kirurgji Orale	6	
	Mjekësi orale	5	
Patologji odonto stomatologjike			
Lëndë bazë, ndërdisciplinore, deontologjike, etj 10%	Tezë diplome	20	26
	Mjekësi ligjore	2	
	Farmakologji	4	
Lëndë karakterizuese 30%	Anatomi Normale	3	46
	Anatomi Topografike	3	
	Anatomi Patologjike	6	
	Mikrobiologji orale	4	
	Biostatistikë	2	
	Radiologji	4	
	Shkenca teknike mjekësore të aplikuara		
	Gjuhe Angleze Profesionale	2	
	Informatikë Mjekësore	2	
	Sëmundje të Brendshme	6	
	Pediatri	4	
	Sëmundje infektive		
	Histologji-embriogji	4	

Prushes *gy*

Gjenetikë	2	
Metoda Kërkimi / Bioetikë dhe Psikologji	4	

Shpërndarja e veprimtarive formuese:

- Leksionet 6-12 orë në auditor dhe 19-13 orë punë e pavarur;
- Seminaret 6-8 orë në auditor dhe 19-17 orë punë e pavarur;
- Laboraret 18-25 orë në auditor dhe 7-0 orë punë e pavarur;
- Praktikat lëndore 1-2 orë në auditor 24-23 orë punë e pavarur;
- Praktikat Profesionale 20-25 orë në auditor dhe 5-0 orë punë e pavarur;
- Provimi përfundimtar 10 orë në auditor dhe 1.5 orë punë e pavarur;

Nga sa më sipër, GVJ arrin në konkluzionin se programi është i harmonizuar për të dy profilet Kirurgji Orale dhe Ortodondi, duke vendosur në raport të drejtë disiplinat e lëndëve specifike me ato bazë ndër disiplinore dhe ato karakterizuese. Gjithashtu, raporti i orëve në auditor dhe seminareve me ato të praktikave klinike janë të shpërndara në mënyrë proporcionale; veprimtarive klinike ju është dhënë sasia e duhur, praktikisht 53% e gjithë orëve mësimore janë planifikuar si praktika klinike. Edhe hartimi i orarit brenda një dite mësimi, është bërë në një mënyrë të tillë që lëndët teorike të zhvillohen në fillim dhe pastaj e gjithë pjesa tjetër e dites t'i lihet diskutimit të rasteve dhe të punës së pavarur të specializantëve, të mbikqyrur vazhdimisht nga pedagogët dhe tutorët e tyre.


Institucioni të shohë mundësinë e rritjes së krediteve të lëndëve specifike, apo të praktikave klinike, sipas vlerësimit nga vetë UAL dhe për atë që e lejojnë kufizimet e akteve ligjore dhe nënligjore për këto lloj programesh.

Plani mësimor miratohet çdo vit akademik, por gjatë pandemisë Covid 19 ka patur ndryshime të vazhdueshme në mënyrën e zhvillimit të vitit akademik në përputhje me udhëzimet e Komitetit të ekspertëve. Ndërkohë, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, personeli i angazhuar në lëndët / modulet dhe veprimtaritë e programit, jepet si vijon:

Pedagogët në SPA sipas lëndëve

Lënda /Moduli	Pedagogu/ Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Statusi	
				PAE	apo PAK

Prubus



1	Anatomi Normale	Z.C.	Prof.Asc	Lab.Dentar	PAE
2	Anatomi Topografike	Z. C.	Prof.Asc	Lab.Dentar	PAE
3	Anatomi Patologjike	M.A.	Prof.	QFSHK	PAE
4	Mikrobiologji orale	P. C.	Prof.	Farmaci	PAK
5	Farmakologji	K. Dh.	Dr.Sh.	Farmaci	PAE
6	Mjekësi Ligjore	M.A.	Prof.	Stomatologji	PAE
7	Biostatistikë	A. K.	Dr.Sh.	Farmaci	PAE
8	Radiologji	A. M.	Prof.Asc	QFSHK	PAK
10	Gjuhe Angleze Profesionale	V. K.	Ph.D.	QPSH	PAK
11	Informatikë Mjekësore	N.H.	Dr.Sh.	QFSHK	PAK
13	Anestezi Reanimacion	A. N.	Prof.Asc	Lab.Dentar	PAE
14	Kirurgji Dento-alveolare I,II	M.B.	Prof.Asc	Stomatologji	PAK
15	Histologji-embriologji	M. K.	Dr.Sh	QFSHK	PAK
16	Ortodonci Paraklinike	A.I.	PhD	QFSHK	PAE
17	Sëmundje të Brendshme	A. N.	Prof.Asc	Lab.Dentar	PAE
18	Pediatri	D. N.	Dr.Sh.	QFSHK	PAE
19	Mjekësi Orale	E. D.	Prof.	Stomatologji	PAE
20	Kirurgji Orale	A. M.	Prof.Asc	Stomatologji	PAE
21	Radiologji orale	A. I.	Dr.Sh.	Stomatologji	PAE
22	Implantologji	F. Xh	Dr .Sh	Stomatologji	PAE
		R. I.	Prof.	Stomatologji	PAK
	Praktikë Klinike	M. B.	Prof.Asc	Stomatologji	PAK
		A.K.	Dr.Sh	Stomatologji	PAE
		N. S.	Dr.Sh	Stomatologji	PAE
		D. S.	SPA Itali	Stomatologji	PAK

Praktikë *gjuhe*

23		R. S.	SPA Itali	Stomatologji	PAK
		O. T.	Dr.neproc	Stomatologji	PAE
		E. S.	Dr.neproc	Stomatologji	PAE
24	Kirurgji Përgjithshme	N. B.	Dr.Sh.	QPSH	PAE
25	Onkologji	J.N.	Dr.Sh	QFT	PAE
26	Sëmundje Infektive	N. B.	Dr.Sh.	QPSH	PAE
27	Ortodonci Lëvizshme	A. K.	Dr.Sh.	Stomatologji	PAE
28	Dentistri Pediatrike	D. B.	Prof	Stomatologji	PAE
29	Gjenetikë	E.S.	Dr.Sh.	Lab.mjekesor- imazheri	PAE
30	Paradontologji	E. D.	Dr.Sh.	Stomatologji	PAE
31	Ortodonci fikse	A. K.	Dr.Sh.	Stomatologji	PAE
		O.T.	Dr.ne proces	Stomatologji	PAE
		R. S.	SPA Itali	Stomatologji	PAK
32	Metoda Kërkimi Shkencor	A. K.	Dr.Sh.	Farmaci	PAE
33	Kirurgji OMF	R. I.	Prof.	Stomatologji	PAK
		A. I.	Dr.Sh.	Stomatologji	PAE

Nga sa më sipër, rezulton se syllabuset përmbajnë njohuritë e nevojshme për studentët, ngarkesa e tyre, përmbajtja e temave teorike dhe praktike janë në përputhje me objektivat që ka ky program studimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I. 6- Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Informacionet e ofruara nga institucioni mbi programet e studimit, modulet dhe syllabuset janë lehtësisht të konsultueshme për studentët si në formë të shkruar dhe elektronike.	Programi është i organizuar dhe ofrohet nga Universiteti Aldent, në përputhje me aktet e brendshme të institucionit. Në këto akte paraqitet edhe mënyra e plotë e mekanizmat e duhura se si shpërndahet informacioni për palët e interesuara

Prabhu *Jay*

<p>Kriteri 2 Institucioni bën të njohur si në formë të shkruar dhe elektronike rregulloret e ndryshme të pranimit të studentëve dhe të organizimit të programeve të studimit.</p>	<p>dhe studentët, përfshirë dhe studentët e rinj. Të gjithë kandidatët që duan të regjistrohen në këtë program, por jo vetëm ata, kanë marrë informacion të hollësishëm për përmbajtjen e programit dhe modalitetet e realizimit të tij.</p> <p>Të gjithë ata që kanë shprehur dëshirën të regjistrohen pranë këtij universiteti, apo të kenë njohuri lidhur me përmbajtjen e programit që zhvillohet, UAL iu ka dërguar në postën e tyre elektronike përmbajtjen e planit dhe programit mësimor, përmbajtjen e syllabuseve, si dhe të dhëna për stafin pedagogjik që jep mësim.</p> <p>Gjithashtu, materialet që lidhen me programet mund të tërhiqen në mënyrë elektronike edhe në sekretarinë e Fakultetit. Që në fillim, kandidatëve që paraqiten për tu regjistruar, ju bëhet e ditur edhe rregullorja e studimeve si edhe mënyra dhe kushtet e pranimit në këtë program. Informacioni jepet edhe në mënyrë verbale nga sekretaritë, stafi, etj.</p> <p><i>Statuti i UAL.</i> <i>Rregullore e Universitetit ALDENT.</i> <i>Rregullore programi studimi.</i></p>
<p>Standardi I. 7- Përmbatja e programeve të studimeve është e plotë dhe e qartë në përmbushje të objektivave të këtyre programeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve përmbajnë një përshkrim të të gjitha kërkesave për përfundimin me sukses të studimeve, përfshirë këtu dhe kreditet (ECTS).</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve përmbajnë një përshkrim të lëndëve të përgjithshme, lëndëve të specialitetit, përvojave klinike/praktike.</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve përmbajnë një përshkrim të pikëve dhe notës minimale për përfundimin me sukses të lëndës/kursit.</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve përfshihen në një koncept të përbashkët, në një “plan diplomimi”².</p>	<p>Referuar RVB, rezulton se në programin e studimit përfshihen gjithë kërkesat që duhen për përfundimin me sukses të studimeve. Caktohet numri i krediteve që duhet të plotësohen, në rastin tonë për të dy profilet duhet të grumbullohen 180 kredite (ECTS). Përveç krediteve të përgjithshme në syllabus për secilin modul përcaktohen kreditet që ka kjo lëndë, numri i leksioneve, seminareve, praktikave, detyrimet e paraqitjes për secilin modul, pjesëmarrja me përqindjet e duhura, etj.</p> <p>Nga takimi me studentët, GVJ u informua se atyre u vihet në dispozicion informacione që përmbajnë një përshkrim të lëndëve të</p>

² “Plani i diplomimit” të studentit shpjegon kurrikulën, kurset që duhet të ndiqen për përfundimin e studimeve, mënyrën e frekuentimit të tyre në një afat të caktuar.

Prachua *Jey*

	<p>përgjithshme, lëndëve të specialitetit, përvojave klinike/praktike etj. Specializantëve ju ndahen sipas tipologjisë përkatëse lëndët dhe kjo është konform udhëzimeve të MASH për ndarjen në lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese të profilit, kreditet e tezës së diplomës etj. Në syllabuset e çdo moduli janë të përcaktuara pikët që duhet të marrë një notë e caktuar, si dhe pikët minimale që i duhen studentit për të qenë kalues. Programi SPA në syllabuset e lëndëve kanë të përcaktuar qartë se çfarë detyrimesh ka kandidati që dëshiron të diplomohet në një profil të caktuar.</p> <p><i>Syllabuse V1.</i> <i>Syllabuse V2.</i> <i>Syllabuse V3.</i></p>
Standardi I. 8- Institucioni bën vlerësimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Vlerësimi i programeve të studimit bëhet duke përcaktuar pikat e forta dhe dobësitë për arritjen e objektivit, si dhe sugjerimet për përmirësim në të ardhmen.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni bën vetëvlerësimin institucional nëpërmjet instrumentave dhe metodologji ve matëse dhe vlerësuese, duke përfshirë gjithë procesin në një sistem të informatizuar.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një sistem të kodifikuar për klasifikimin dhe arkivimin (baza të dhënash në format elektronik, arkivim i dokumentacionit) e të dhënave të të gjitha aktiviteteve të zhvilluara dhe të rezultateve të arritura.</p> <p>Kriteri 4 Personeli akademik angazhohet në vlerësimin efektiv të programeve të studimit.</p>	<p>Vlerësimi i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike si nga njësi përgjegjëse, po ashtu edhe nga NJSBC. Edhe raporti i NJSBC ka përcaktuar pikat e forta dhe dobësitë për arritjen e objektivit, si dhe sugjerimet për përmirësim në të ardhmen. Personeli akademik dhe drejtuesit e programit ndjekin gjithashtu me vëmendje ecurinë e programit, marrin mendime nga specializantët, pedagogët, mjekët, që japin mësim dhe personeli ndihmës lidhur me atë se çfarë duhet të ndryshojë e të persoset në të ardhmen, për ta bërë atë më të asimilueshëm dhe për të rritur cilësinë e përgatitjes së tyre. <i>Raport i NJSBC 2020-2021.</i></p> <p>Sikundër është përmendur, më sipër dhe në raportin e paraqitur, institucioni ka realizuar në bashkëpunim me Institutin për Cilësi në Arsim, në maj 2021, pyetësorin e studentëve specializantë. Në takimet e zhvilluara na u deklarua se institucioni jo vetëm ka adresuar problematikat, por ato janë plotësuar prej tyre, bazuar në problematikat që kanë dalë në pah nga vlerësimet e studentëve.</p>

Practus

Jay

	<p>Edhe puna që ka bërë Grupi i Vlerësimit të Brendshëm dhe raporti i hartuar prej tij, janë në funksion të këtij procesi. Raporti i hartuar nga IQE dhe raporti i hartuar nga NJSBC, përveç analizës, përmban dhe një përmbledhje të pikave të forta dhe të dobëta të programit. Nga takimi me specialistët rezultojnë gjithashtu se ata janë të kënaqur me reagimin e institucionit, si dhe me interesin e treguar ndaj tyre, veçanërisht në përmbushje të detyrimeve të praktikës profesionale për shkak të situatës pandemike në të cilën kaloi vendi gjatë vitit 20-21. Nga takimi me stafin akademik rezultojnë se, personeli akademik i cili ndjek në vazhdimësi këtë program studimi, natyrisht që jep mendimet e tij për të rregulluar ato problematika të cilat lejohen nga ligji. Ndërsa për problematikën të cilat kërkojnë një miratim nga MAS, propozimet kalojnë në të gjitha instancat e duhura, në mënyrë që të jenë të vlefshme për ciklin tjetër të studimeve.</p>
<p>Standardi I. 10- Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli bëhet në përputhje me ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë (RSH), me ligjin për profesionet e rregulluara në RSH si dhe me direktivat europiane mbi profesionet e rregulluara.</p>	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e programeve të studimeve specializuese afatgjata, studenti duhet të grumbullojë jo më pak se 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e këtyre programeve të studimeve është jo më pak se 2 vite akademike, në përputhje me ligjin e profesioneve të rregulluara.</p> <p>Kriteri 2 Kohëzgjatja minimale e programeve të studimit të specializimeve afatgjata nuk është më e vogël se ajo e përcaktuar në shtojcën 1, bashkëlidhur këtyre standardeve.</p>	<p>Kohëzgjatja e studimeve në SPA dhe numri i krediteve në këtë program janë konform kërkesave ligjore për arsimin e lartë 80/2015. Konkretisht Programi aktual i specializimit afatgjatë në Universitetin Aldent zgjat 3 vjet dhe ka 180 kredite ECTS.</p> <p>Programi ka marrë në konsideratë Direktivën 2005/36/EC të Këshillit dhe Parlamentit Europian, duke u përshtatur njëkohësisht me programe të ngjashme të Universiteteve italiane, veçanërisht me ata që UAL ka marrëdhënie, profesorë të cilëve japin mësim në këtë program, si p.sh Universitetin e Kietit, Universitetin e Aqilës në Itali, etj.</p> <p>Eksperiencat europiane që janë marrë parasysh në hartimin e këtij programi studimi, janë me</p>

Practica *deep*

	kohëzgjatje 3 vjet, siç parashikohet në shtojcën nr.1. he në takimet me drejtuesit, u argumentua gjërësisht arsyeja se pse programi ka kohëzgjatjen 3 vite akademike dhe i akredituar me të njëjtin organizim edhe në vitin 2016.
Standardi I. 11 - Hartimi dhe realizimi i programit të studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë bëhet sipas kriterëve të parashikuara.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve specializuese afatgjata përfshijnë të paktën 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike profesionalizuese, sipas specializimit përkatës, dhe 20% për studime të organizuara teorike të shpërndara në vite sipas një programi të paracaktuar në fillim të programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2 Në studimet specializuese janë parashikuar raportet e ECTS-ve për formimin e përgjithshëm dhe për atë specifik sipas skemës së mëposhtme në raport me ECTS-të totale minimale të parashikuara për programin specializues të paraqitur në shtojcën 1: 2% për lëndë të formimit bazë për specializantin, 2% për lëndë ndërdisiplinore ose integruese 1% për aktivitete të tjera (lëndë informatike, gjuhë të huaja), 5% për provimin final/temën eksperimentale të diplomës, 30% për lëndë karakterizuese të fushës ku bën pjesë programi specializues (nga të cilat 15% e tyre duhet të jenë lëndë me zgjedhje) dhe 60% për lëndë specifike të programit specializues (nga të cilat 15% e tyre duhet të jenë lëndë me zgjedhje).</p> <p>Kriteri 3 Plani i detajuar mësimor është miratuar sipas akteve ligjore/nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 4 Në përfundim të çdo viti organizohet provimi vlerësues teorik dhe praktik i cili vlerësohet me notë. Vlerësimi vjetor kryhet nga një komision i përbërë nga 5 (pesë) specialistë me përvojë të fushës</p>	<p>Referuar RVB-së dhe planit mësimor rezulton se, programi SPA Stomatologji në profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonci ka një organizim të tillë, ku të paktën 80% të ECTS-ve totale janë për aktivitete klinike profesionale, sipas specializimit përkatës dhe 20% janë për studime teorike. Lëndët specifike zënë 60%, lëndëte formimit bazë, ndërdisiplinor, deontologjisë zënë 10%, lëndët karakterizuese zënë 30% dhe janë të realizuara me nënndarje, thuajse siç kërkohet në standart.</p> <p>Nga takimi me studentët, rezulton se, ata shlyejnë detyrimet e parashikuara në fund të çdo semestri, ose në përfundim të vitit akademik. Në fund të vitit të parë specializantët i janë nënshtruar provimit praktik kualifikues. Në UAL, studentët që diplomohen në këtë program studimi, japin fillimisht provimin praktik dhe vetëm mbasi studenti të kalojë me sukses testimin praktik, do të testohet dhe me gojë, ose do të mbrojnë temën eksperimentale. Si fillim jepet provimi i praktikës me demonstrime rastesh klinike. Mbasi të jetë kryer me sukses ky testim, do të bëhet provimi me gojë. Komisioni i provimit përbëhet nga 5 anëtarë, që janë specialistë të fushës ku kryhet specializimi, ose të një fushë të afërt me të. Provimi praktik konsiston në zgjidhje të rasteve klinike që do të paraqesë Komisioni dhe specializanti duhet të jetë i aftë që të përcaktojë diagnozën, planin e trajtimit dhe të parashikojë rezultatet e pritshme.</p> <p>Disa nga njohuritë bazë për të cilat aplikanti testohet në provimin përfundimtar, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendosja e diagnozës;

Prabh... *Jelly*

përkatëse ose të përafërt me të sipas moduleve të zhvilluara. Studentët që vlerësohen negativisht 5 herë marrin një dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe i ndërpresin studimet e specializimeve afatgjata. Studenti mund të riaplikojë për të konkuruar në një program tjetër specializues jo më shumë se 1 herë. Studentit mund t'i njihen ECTS-të e grumbulluara për studimet e organizuara teorike nga ana e Këshillit të Profesorëve nëse gjykohet se përputhen me fushën e programit të ri ku ai ka aplikuar.

Kriteri 5 Studenti i nënshtrohet provimit përfundimtar/final në përfundim të programit specializues i cili konsiston në testimin praktik dhe atë me gojë të studentit me kohëzgjatje prej të paktën 30 minutash si dhe paraqitjen e temës eksperimentale të diplomës. Për këtë ngrihet një komision i përbërë nga 5 specialistë të fushës, ose të një fushe të afërt, me eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare në fushën përkatëse, nga të cilët 2 të emëruar nga Ministri i Shëndetësisë, 1 nga Urdhri Profesional përkatës dhe 2 të emëruar nga fakulteti që ofron programin specializues. Kryetar i komisionit është një nga përfaqësuesit e emëruar nga Ministri i Shëndetësisë. Disa nga njohuritë bazë për të cilat aplikanti testohet në provimin përfundimtar, janë:


- a. Zhvillimi i sensit kritik lidhur me situatat e ndryshme klinike;
- b. Lidhjet mes fushave të ndryshme të mjekësisë;
- c. Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës në klinikë;
- d. d. Kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e situatave klinike dhe për të dhënë zgjidhje në rastë emergjente.

- -Masat preventive dhe interceptive të rastit nëshqyrtim;
- -Alternativat trajtuese;
- Zhvillimi i sensit kritik lidhur me situatat e ndryshme klinike;
- Lidhjet mes fushave të ndryshme të mjekësisë;
- Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës në klinikë;
- Kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e situatave klinike dhe për të dhënë zgjidhje në raste emergjente.

Një kontigjent i caktuar që ka patur rezultate të mira gjatë 3 viteve të studimit, do të ketë mundësi të zgjedhë dhe të mbrojë një temë studimore eksperimentale në përfundim të studimeve.

*Rregullore programi studimi.
Modaliteti i diplomës.*

Prush



Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i studimit SPA me profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonci, është liçensuar në përputhje me bazën ligjore në fuqi, duke kaluar hapat e vlerësimit nga ASCAL dhe MAS. Programi është i hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi të asaj periudhe, bazuar në eksperiencat më të mira Europiane.

Kohëzgjatja, numri i krediteve, shpërndarja e lëndëve, raportet midis formimit teorik, praktik e klinik janë në përputhje me nevojën që kanë specialistët e kësaj fushe. Ky program është konstruktuar në mënyrë të ekuilibruar, ku disiplinat e ndryshme zënë vendin e tyre sipas rëndësisë që kanë në këtë program studimi, po ashtu është ndarë në mënyrë të drejtë raporti i orëve teorike me ato të praktikës klinike. Specializantët informohen para regjistrimit dhe gjatë shkollës, në përputhje me aktet e brendshme dhe ky informim zhvillohet në mënyrë transparente. Shlyerja e detyrimeve akademike përveç testeve semestrale e vjetore përmbajnë edhe vlerësimin para një komisioni profesionistësh ku rëndësi kryesore ka aftësimi profesional e klinik.

Në përfundim gjykojmë se tërësia e standardeve dhe kriterëve të mësipërme përmbushen nga ana e institucionit.

Prubus *guy*

8. Mësimdhënia –mësimnxënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë, kontrolli i njohurive të studentëve, udhëheqja shkencore e studentit etj.

Një ngaveprimtaritë tashmë të konsoliduara në Universitetin Aldent rezultojnë të jetë zhvillimi i procesit mësimor. Si në dokumentacionin mbështetës të raportit, edhe në takimet në institucion, me drejtuesit, personelin akademik, studentët, u deklarua se aktualisht institucioni aplikon metodat më inovative të mësimdhënies në fushën e shkencave mjekësore.


Pavarësisht problematikës së hasur nga pandemia Covid 19, institucioni ka arritur të verë në përdorim sisteme të dedikuara të menaxhimit të mësimdhënies online UAL- e Learning, i cili përdoret edhe aktualisht. Kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e veprimtarive mësimore, jo vetëm për programin SPA, por për të gjitha programet që UAL ofron, jep infrastruktura fizike. Me kampusin e ri universitar, mjediset në funksion të mësimdhënies janë me hapësira të bollshme, kushte komode, infrastrukturë logjistike të përditësuar, çka mundëson një mësimdhënie në kushtet optimale. Nga takimi me studentët, rezultojnë se vlerësimi për kapacitetet që institucioni ofron, është maksimal. Në përmbajtje, procesi mësimor është realizuar në përputhje me planin mësimor sipas veprimtarive të parashikuara.

Veprimtaritë kryesore në kuadër të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, praktikat laboratorike, projektet dhe temat studimore, praktikat klinike, trajnimet me profesorë të huaj, seminare të hapura, workshop-e, etj.

Raportet midis veprimtarive të parashikuara janë të paraqitura në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve. Bazuar në rregulloren e programit, ndjekja e leksioneve nga specializantët është e detyruar në masën mbi 75% të oreve të mësimit. Megjithatë pedagogët inkurajojnë ndjekjen e leksioneve në të gjitha orët e tyre dhe bëjnë përpjekje që këto orët të realizohen sa më interaktive, të jenë interesante dhe sa më produktive në drejtim të përvetësimit të lëndës.

Në këto dy vite pandemie, organizimi i mësimdhënies është kryer në zbatim të akteve normative të Komitetit teknik të ekspertëve për menaxhimin e pandemisë Covid 19 dhe urdhërave të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë. Një pjesë e leksioneve është zhvilluar online, duke kryer orë konsultimi në auditor. Nga studentët u deklarua se mësimdhënia online ka qënë mjaft e dobishme, jo vetëm për të zhvilluar një koncept të ri pak të njohur sipas tyre, sikundër është mësimdhënia online, por më tepër duke zbatuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë njohuritë në praktikën klinike, duke qënë se klinikat dentare kanë qëndruar të mbyllura vetëm për një periudhë të shkurtër kohore. Gjatë pandemisë, mësimdhënia është zhvilluar nëpërmjet platformës online. Në të përveç materialeve të ngarkuara, janë paraqitur leksionet në video, materiale simulative, si dhe materiale shtesë të aksesueshme nga studentët në çdo kohë. Ndërkohë për vitin akademik 2021-2022, aktiviteti ka filluar rregullisht në auditor në përputhje me planin e parashikuar. Edhe seminarët janë zhvilluar në platformë duke u fokusuar kryesisht në diskutimin dhe shqyrtimin e njohurive me pjesëmarrjen aktive të studentëve. Zhvillimi i

Prubus



praktikës klinike është një tjetër komponent i rëndësishëm në funksion të programit të studimit. Praktika organizohet në klinikën universitare stomatologjike Aldent dhe është komplekse dhe specifike për nivelin e tretë të studimeve. Në përbërjen e saj janë të planifikuara rreth 400 orë të programit mësimor, të grupuara në laboratore, workshop-e dhe raste klinike.

Gjatë takimeve në institucion u deklarua nga specialistët e kirurgjisë, se operohet në 3 salla kirurgjikale, të pajisura me aparaturat dhe instrumentariumin e nevojshëm, si dhe në kabinetet laboratorike për temat e laboratorëve. Sallat kirurgjikale janë të pajisura me aparatura moderne në fushën e Kirurgjisë orale, si kamera operatore Ekler, aparati i grafisë endo-orale dhe panorameks, bisturia piezo-elektrike, lazeri, centrifuga, motori kirurgjikal i vendosjes së implanteve, mikroskopi kirurgjikal, si dhe se fundmi aparatura e sedacionit koshient. Sallat operative janë të plotësuara me instrumentariumin e nevojshëm kirurgjikal me kite të plota për ndërhyrje kirurgjikale si sinus lifting, kirurgji paradontale, kiti i fiksimit dhe stabilizimit të membranave GBR dhe kite kirurgjikale të përgjithshme. Kabinetet laboratorike janë të pajisura me sisteme kompjuterike dhe ofrojnë mundësinë e laboratoreve dixhitale në Kirurgji Orale dhe Implantologji. Praktikant laboratorike janë organizuar në bazë të temave përkatëse të syllabusit, sipas çdo viti akademik. Qëllimi i tyre është simulimi i teknikave të ndryshme operatore dhe përgatitja e specialistëve për menaxhimin e rasteve klinike.


Janë organizuar laboratore me tema të ndryshme si psh:

- anatomia topografike kirurgjikale dhe peri-implantare;
- instrumentariumi në Kirurgjinë Orale dhe Implantologji;
- leximi dhe interpretimi i skanerit dentar;
- llojet e lembove dhe aplikimi i tyre në nofulla derri;
- llojet e suturave dhe aplikimi i tyre në nofulla viji;
- protokoll kirurgjikal i vendosjes të implanteve në nofulla sintetike dhe në nofulla derri;
- llojet e suturave në Kirurgjinë Paradontale në nofulla viji;
- marrja e masës mbi implante dhe teknikat e saj;
- protokoll All on 4 në Implantologji në nofulla sintetike;
- aplikimi i sistemit Rhein – 83 për stabilizim të protezës totale, etj.

Studentët deklaruan se rastet klinike janë komplekse dhe të mirëorganizuar. Pasi kalon në sallën e filtrit, rasti klinik planifikohet për konsultë për ndërhyrjen kirurgjikale. Pacienti në konsultë i nënshtrohet ekzaminimeve plotësuese, diagnostikimit dhe planifikimit të ndërhyrjes kirurgjikale. Kartelës klinike të pacientit i bashkëngjitet konsenti i firmosur prej tij. Konsenti është i detajuar në lidhje me ndërhyrjen kirurgjikale apo me vendosjen e implanteve. Parapërgatitja e pacientit, ndërhyrja kirurgjikale dhe monitorimi postoperator bëhet nga specialistët nën mbikqyrjen e plotë dhe të kujdesshme të mjekëve në shërbimin klinik, shqiptarë dhe italianë.

Rastet klinike të trajtuara në Kirurgjinë Orale janë:

- ekstraksioni i dhëmbëve të impaktuar, si molarët e tretë dhe kaninët;
- rikuperimi ortodontik-kirurgjikal i kaninëve maksilarë – mandibularë;
- ekstraksioni i dhëmbëve supranumeratum;

Practica 

- trajtimi i kistave radikulare nëpërmjet teknikës të cistektomisë dhe dekompresionit transalveola;
- ndërhyrje në kirurgjinë preprotetike, si frenektomi;
- hiperplazitë gingivare, ekzostozat dhe thellimet e sulkusit vestibular;
- apikotomitë në kirurgjinë endodontike;
- trajtimi i xhepave dhe defekteve kockore;
- teknika Widman e modifikuar;
- teknikat rezektive dhe regjenerative në kirurgjinë paradontale;
- gingivektomitë me laser;
- trajtimi kirurgjikal i epuliseve, polipeve dhe fibromave;
- trajtimi i abseseve, drenimi kirurgjikal i tyre;
- trajtimi kirurgjikal i mukocelave, si dhe ekstraksionet komplekse të dhëmbëve;

Rastet klinike të trajtuara në Implantologji janë:

- vendosja e implanteve;
- ngritjet e mëdha -laterale të sinusit dhe ngritjet e vogla -kreshtale;
- teknikat si split-crest dhe socket -preservation, si dhe teknikat e augmentimit kockor nëpërmjet GBR dhe përdorimit të centrifugës;
- marrja e grafteve të indeve të buta nga palatum;
- përdorimi i dhëmbëve të ekstraktuar nga pacienti si shtesë kockore autologe nëaugmentimet kockore;
- aplikimi i implanteve për stabilizim të protezës totale;
- vendosja e mini-implanteve për ankorim ortodontik;
- explantime dhe trajtimi i peri-implantiteve;

Rastet klinike në Implantologji përfshijnë dhe vendosjen e protezave mbi implante, duke filluar nga teknikat e marrjes së masës me lugë standarte/ të individualizuar dhe të gjitha llojet e protezimeve, si punime të cementura, punime me filetimit, si dhe proteza mbuluese overdenture.

Specializantët përgatisin dhe plotësojnë kartelën klinike të pacientit, bëjnë premedikimin dhe parapërgatitjen e pacientit, konsultojnë dhe përvetësojnë qartë protokollin kirurgjikal, sipas çdo rasti klinik, kryejnë ndërhyrjen operatore dhe bëjnë monitorimin postoperator të rastit klinik.

Gjatë takimeve në institucion nga specializantët e Ortodontisë u deklarua se ata operojnë në 2 salla operatore, ku ata mund të punojnë njëkohësisht për aktivizimin e aparateve. Studentët fillojnë me analizën e modeleve të studimit, radiografive dhe vendosjen e diagnozës klinike në vitin e parë dhe vijojnë më pas me ndërtimin dhe aplikimin e aparateve të lëvizshme e funksionale në vitin e dytë. Në vitin e tretë fokusohen në aparatet fikse të tipologjive tëndryshme, aparatet e ankorimit, retensionit, etj. Pacientët e ortodontisë trajtohen me kosto minimale të laboratorit apo kosto të aparatit. Ata paraqiten në takime të vazhdueshme, të përmuajshme për aktivizimin e aparateve, që kryhet nga vetë specializanti, i mbikqyrur nga mjeku shqiptar/italian tutor dhe asistentët e sallës. Trajtimet më frekvente në klinikën universitare janë :

Prusha *Jey*

- klasat e para me grumbullime dentare;
- trajtimet interceptive të klasave të dyta dhe të treta;
- trajtimi i klasave të dyta apo të treta tek pacientët adultë;
- kafshimi i thellë;
- kanini ektopik apo i impaktuar;
- kafshimi i hapur, etj

Aparatet që vendosin specializantët realizohen në laboratorin e universitetit.

Aparate te tilla si:

- aparat i lëvizshëm superior dhe inferior;
- zgjeruesi i shpejtë maksilar;
- distalizues të ndryshëm;
- buton Nance, hark TPL, hark lingualë
- aparatet e retensionit (maskerina / pllake Hawley);
- aparate funksionale (twin block, Andresen, etj).

Stafi në shërbimin klinik përbëhet nga mjekët primarë, asistentët dhe infermierët e sallës.

Shërbimet në Klinikën Stomatologjike Universitare të UAL-së janë falas dhe me kosto të reduktuar në Implantologji dhe Ortodonci, duke patur në fokus pacientët me mundësi financiare të kufizuara, kryesisht moshat e treta dhe fëmijët. Praktikrat klinike, të cilat zhvillohen në të 3 vitet akademike kanë një përqindje të konsiderueshme të programit të specializimit. Këto praktika mund të zhvillohen në laboratorët dhe klinikat e fakultetit, por dhe në institucione të ndryshme publike ose private me të cilat Universiteti Aldent ka kontrata te rregullta.

Kryerja e tyre zë një vënd të veçantë në procesin mësimor, sepse lidhet direkt me gjithëformimin e specialistëve të ardhshëm. Sipas kërkesave të rregullores të fakultetit, punët e laboratorit duhet të zhvillohen me seriozitet e përpikmëri, pa anashkalar asnjë seancë të tillë. Rezultatet, që merren nga punët laboratorike duhet të përpunohen dhe të paraqiten në formën e një raporti e të mbrohen nga ana e specializantit. Pa realizuar e mbrojtur punët e laboratorit, rregullorja e ndalon specializantit që të hyjë në provim. Ngarkesa e laboratoreve është e detyrueshme që të shlyhet në masën 100%. Rastet klinike dhe ecuria e tyre janë objekt i kërkimit shkencor në bashkëpunimin mjek-specializant, si dhe në projekte të universitetit "Aldent" me bashkëpunëtorët, si "Dental Leader Corsi" dhe partnerët e huaj të institucionit.

Punimet e kryera nga specializantët janë tema ose punime individuale, që vlerësohen në kuadër të detyrave ose projekteve të kursit. Kandidatët marrin temën e detyrës së kursit, kryejnë kërkimet rreth saj dhe më pas përpilojnë detyrën sipas një strukture të konsultuar më parë me pedagogun. Detyrat e kursit paraqiten dhe mbrohen nga specializanti, ai nuk lejohet të futet në provim pa bërë më parë paraqitjen dhe mbrojtjen e tyre. Një tjetër aspekt i evidentuar është konsultimi me literaturën e nevojshme. Në të gjitha programet që ofron UAL, procesi mësimor bazohet në literaturë shkencore bashkëkohore, të asaj që përdoret në fakultetet e tjera shtetërore apo private, në vendin tonë apo në universitetet e huaja. Literatura zgjidhet me kujdes dhe miratohet në Departamentin përkates dhe në Dekanat, duke u bazuar në programin që është ofruar. Për çdo veprimtari të zhvilluar, studenti vlerësohet me pikë dhe/ose notë. Nota

Practica *du*

përfundimtare që vlerëson specializantin është kërkuar të bazohet në ecurinë vjetore të studentit nëçdo komponent të procesit mësimor: si aktivizime në seminare, praktika dhe bashkëbisedimin përfundimtar etj. Studentët kanë akses në llogarinë e tyre personale në sistemin e sekretarisë mësimore, ku mund të konsultohen me vlerësimet. Çdo vlerësim përfundimtar u bëhet i ditur studentëve paraprakisht. Testet dhe provimet zhvillohen në mënyrë anonime dhe rezultatet u bëhen të ditura individualisht studentëve nëpërmjet llogarive të tyre në sistemin e brendshëm.

Në platformën e mësimdhënies u evidentuan cikle leksionesh të përgatitura nga stafi, respektivisht:

- Tekste të shkruara nga pedagogu apo grupe autorësh në gjuhën shqipe;
- Tekste në gjuhë të huaj;
- Leksione të përgatitura nga pedagogu i lëndës;
- Materiale të përgatitura në funksion të tematikës nga ana e lektorit;
- Artikuj shkencorë të botuar rreth temës që trajtohet;

Një pjesë e mirë e literaturës është e pranishme në bibliotekën e institucionit, ku mund të shfrytëzohet lehtësisht e pa pagesë, ose mund të aksesohet libraria online Hinari me libra mjekësore, në të cilën ka vite që UAL është abonuar;

Planet mësimore të programeve të këtij specializimi afatgjatë përfshijnë edhe forma të tjera studimi për specializantët si: leksione interaktive, leksione të hapura, zhvillimin e konsultimeve në auditor, seminare dhe workshop-e të zhvilluara në institucion ose jashtë tij. Programi i studimit ka pësuar pak ndryshime në vite, por përmirësimi i planit dhe syllabuseve ka qenë një proces dinamik, duke ndjekur veçanërisht udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe kërkesat e standardet aktuale për akreditimin e programeve të studimit.

Programi i Studimit		
Specializim Afatgjatë në Stomatologji		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	600
b.	Seminare	260
c.	Kërkimi shkencor	240
d.	Projekte	2
e.	Praktika	1090
	Në total	2192

Koordinatori i programit ndjek nga afër ecurinë e specializantëve duke monitoruar mbarëvajtjen e procesit mësimor, si në auditor, ashtu edhe në institucionet shëndetësore ku kryhen praktikat e specializantëve.

Prachas *guy*

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit për lëndët vjetore që janë teorike dhe praktike	Pjesa (në %) ndaj totalit për lëndët që zhvillohen dhe vlerësohen me praktika
Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	10%	20%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	10%	-
Testimet gjatë vitit	20%	
Provimi përfundimtar	60%	80%
	100 %	100 %

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I. 9- Institucioni përdor instrumente matës, vlerësues, metodologji vlerësimi.	
<p>Kriteri 5 Institucioni për kryerjen e vlerësimit përdor instrumente/metoda vlerësimi të drejtpërdrejta ose të tërthorta.</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Ndjekje të studentëve gjatë zhvillimit të praktikave dhe angazhimi i tyre në ndjekjen e rasteve klinike konkrete; Vlerësimi me nota/pikë në fund të çdo viti; Testime paraprake dhe dytësore: provime për module, praktikë; Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës; Vlerësimi përfundimtar. <p><u>Të tërthorta</u></p>	<p>Sikundër është theksuar në paragrafët e mësipërm, UAL është institucion që funksion tashmë prej më shumë se 15 vitesh. Rezulton se institucioni ka të konsoliduar mekanizmat e vlerësimit dhesigurimit të brendshëm të cilësisë, duke përfshirë edhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Universiteti Aldent ka krijuar mekanizmat e nevojshëm për realizimin dhe përvetësimin e programit të SPA. Ai ka krijuar instrumenta matëse dhe vlerësuese periodike për ecurinë e këtij programi studimi. Këto informacione janë përfshirë në të gjitha vlerësimet e brendshme të cilësisë.</p> <p>Referuar RVB-së, metodat e vlerësimit kanë qënë të tërthorta dhe të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Metoda të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe nëpërmjet pyetësorëve që u janë paraqitur specialistëve dhe që janë plotësuar prej tyre. Ata kanë patur mundësi që të shprehen për

Prabhua *Jey*

<p>a. Sondazhet: të studentëve të rinj/të vjetër, të të diplomuarve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të kurrikulës (pjesës teorike dhe asaj praktike, kapaciteteve logjistike infrastrukturore dhe të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, etj.);</p> <p>c. Intervista.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni disponon një sistem të kodifikuar për klasifikimin dhe arkivimin (baza të dhënash në format elektronik, arkivim i dokumentacionit) e të dhënave të të gjitha aktiviteteve të zhvilluara dhe të rezultateve të arritura.</p>	<p>gjithë ecurinë e procesit mësimor në kushte anonimati.</p> <p>b. Sistemi i Tutorëve/ kujdestarëve të grupeve, që u ka krijuar atyre mundësinë që të shprehen në vazhdimësi rreth problemeve që kanë patur dhe si e mendojnë ata mundësinë e përmirësimit të tyre.</p> <p>c. Informacione janë marrë edhe nga institucionet relevante.</p> <p>d. Staf i akademik dhe ai administrativ i UAL-së ka organizuar shpesh edhe diskutime të hapura me specialistët dhe ju ka krijuar atyre mundësinë që të marrin pjesë aktive në procesin e përmirësimit të procesit mësimor dhe arritjes së rezultateve sa më të mira.</p> <p>e. Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve të specialistëve është bërë sipas formave të përcaktuara ligjore, të cilat janë të shprehura edhe në Statutin e Universitetit e Rregulloren e Specializimit.</p> <p><u>Metoda të drejtpërdrejta:</u></p> <p>a. Specialistët janë ndjekur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme nga pedagogët dhe tutorët e tyre gjatë gjithë procesit të mësimit, zhvillimit të praktikave dhe zgjidhjes së rasteve klinike dhe janë vlerësuar për cilësinë e kryerjes së tyre.</p> <p>b. Në fund të çdo semestri është zhvilluar moduli përkatës dhe janë bërë vlerësimet.</p> <p>Këto testime paraprake kanë shërbyer edhe gjatë vlerësimit përfundimtar të lëndës.</p> <p>c. Testimet, seminarët, detyrat e kursit, projektet, prezantimet në power-point etj., kanë qënë pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm të specialistëve.</p> <p>d. Vlerësimi përfundimtar është bërë në fund të semestrit apo të vitit, kur lënda përkatëse ka përfunduar. Këto vlerësime kanë qënë të paraprirë nga gjithë puna vjetore e kontrollit të ushtruar në çdo temë e orë mësimi. Kontrolli përfundimtar është zhvilluar me raste praktike e kontroll teorik, me gojë</p>
--	--

Prabhakar *July*

ose me shkrim, ose me mënyrat që njih ligji për këtë problem.

Konkluzionet e vlerësimit:

Në Universitetin Aldent përdoren metoda bashkëkohore të mësimdhënies si: leksione, seminare, punë laboratorike, praktika me manekinë, praktika klinike.

Zhvillimi i tyre realizohet jo vetëm me metodat më bashkëkohore të prezantimit, si powerpoint, video, etj., por edhe interaktivizimi student-pedagog, e bën akoma më bashkëkohor mësimdhënien dhe mësimnxënien.

Mënyrat kryesore të mësimdhënies janë: - Leksione, seminare, laboratore dhe praktikat klinike me pacientë realë. Fakti që UAL ka shumë laboratorë e bënë më të lehtë për studentët lidhjen midis teorive dhe praktikës. UAL organizon sondazhe të ndryshme me studentët dhe reflekton në të gjithë vërejtjet dhe sygjerimet që japin studentët për mbarëvajtjen e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Practica
juy

9. Studentët e SPA

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Kriteret akademike dhe procedurat e pranimit të studentëve SPA, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve të SPA, statistika, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Referuar vizitës në sekretarinë mësimore, rezultoi se në programin SPA për vitin akademik 2021-2022, studiojnë 64 specializantë në profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonci, të cilët përzgjidhen nëpërmjet një procedure të detajuar selektimi, me sistem pikëzimi me 150 pikë në total. Në këtë pikëzim nota mesatare e studimeve universitare vlerësohet me 100 pikë, trajnimet, referimet, prezantimet, vlerësohen deri në 20 pikë, eksperiencia profesionale deri në 10 pikë dhe intervista 20 pikë. Bashkë me dokumentacionin, studentët vlerësohen edhe për paraqitjen e tyre para komisionit. Nga takimi me studentët rezultoi se, të gjithë ishin nënshtruar një procedure të tillë seleksionimi. Shumica e studentëve të pranuar në këtë program studimi rezultoi të jenë me mesatare të lartë mbi 8. (Tabelat)

Nga takimi me studentët, GVJ u informua se janë të punësuar pothuaj të gjithë studentët. Referuar rezultateve të pyetësorit, ku një prej pyetjeve i referohej statusit aktual të punësimit, rezultoi se përqindja më e madhe ishin të vetëpunësuar në klinika private:

I vetëpunësuar (klinikë private)	75.00%
I punësuar në një klinikë private	19.23%
I punësuar në sektorin publik (në profesion)	3.85%
I punësuar jashtë profesionit	0.00%
Aktualisht i papunë	0.00%
Tjetër	1.92%

Ky është një faktor mjaft i rëndësishëm që tregon se programin e ndjekin studentë, që kanë njohuri të thelluara profesionale dhe që duan të avancojnë në karrierë. Institucioni ruan kontakte të drejtpërdrejta si me studentët që janë në proces studimesh, por edhe me studentët e diplomuar më parë. Interesante është dhe gjeografia apo institucioni nga vijnë. Nga 64 studentët aktivë (38 në profilin Kirurgji Orale dhe 26 në profilin Ortodonci) 25 prej tyre janë nga trojet: Kosovë, Maqedoni etj. (Raport i NJSBC 2020-2021).

Ndërkohë sipas universitetit ku kanë përfunduar studimet master, shpërndarja është si më poshtë vijon:

Universiteti Aldent	21.15%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	32.69%
Universitet tjetër privat brënda vëndit	19.23%
Universitet jashtë vëndit	19.23%
Pa përgjigje	7.69%

Prushas

Jey

Nga takimi me studentët, rezulton se institucioni iu kushton vëmëndje studentëve gjatë gjithë vitit akademik. Në mënyrë të vazhdueshme realizohen veprimtari që përfshijnë studentët, veçanërisht ato që lidhen me trajnimet profesionale dhe që zhvillohen me profesorë të huaj. Çdo veprimtari që zhvillohet në UAL, në të cilën studentët janë të përfshirë, është pa kosto shtesë për ta, mbasi të gjitha shpenzimet në këtë rast përballohen nga institucioni.

Ndërsa, infrastruktura fizike dhe logjistike e vënë në funksion të studentëve, rezulton të jetë në nivelin e dëshiruar, pasi në pyetësorin e realizuar në vitin 2021, apo edhe nga takimi me ta, ata shprehen mjaft të kënaqur. Pavarësisht vlerësimit mjaft pozitiv të studentëve, në tregues të veçantë, janë evidentuar tematika të caktuara për të cilat studentët i vlerësojnë pozitivisht, por në nivel pak më të ulët se indikatorët e përmendur më lart. Konkretisht, disa nga çështjet e përmendura nga studentët e që kërkojnë të adresohen është angazhim më i madh i tyre në projekte kërkimore dhe studime shkencore në fushën e dentistrisë, si dhe më shumë mundësi për eksperiencë jashtë vendit të studentëve të SPA-së. (Raport i NJSBC 2020-2021).

Nga diskutimi me stafin dhe drejtuesit për këtë çështje, rezulton se një pengesë e rëndësishme në këtë drejtim ka qënë dhe COVID – 19, mbasi gjatë kësaj periudhe si konferencat brenda vendit dhe shkëmbimet ndërkombëtare janë ndërprerë, ose janë realizuar minimalisht dhe me shumë vështirësi. Në këtë kontekst, duke shpresuar në një përmirësim të gjendjes në të ardhmen, ne sygjerojmë angazhim më të madh të studentëve në aktivitete kërkimore dhe projekte të ndryshme.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I. 13- Pranimi i studentëve në një program studimi specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë	
Kriteri 1 Studenti i pranuar në programin e studimit specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë ka përfunduar programin e integruar të studimeve universitare të integruara të ciklit të dytë me kohëzgjatje 5 vjeçare (300 ECTS) për degët Farmaci dhe Stomatologji dhe 6 vjeçare (360 ECTS) për degën Mjekësi e përgjithshme, pranë një universiteti të akredituar për programin në fjalë dhe ka fituar diplomën universitare “Master i Shkencave”. Për studentët e diplomuar në të njëjtat degë jashtë shtetit të cilëve u njihet diploma për ushtrimin e profesionit përkatës në këto vende, nuk	Studentët e këtij programi studimi, janë studentë të cilët kanë përfunduar studimet e integruara në fushën e stomatologjisë dhe vijnë kryesisht nga universitete brenda vendit, por edhe nga trojet (rreth 25). Për tu regjistruar në këtë program studimi ata duhet të plotësojnë disa kriteret, të përcaktuara në rregulloren e programi të studimit. (Rregullore programi studimi) Departamenti, fakulteti dhe komisioni përcakton kriteret për t’u pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata, të pasqyruara në rregulloren e programit të studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë dhe të miratuara nga Senati Akademik.

(Pacibus)

Jey

ka kriter për notën mesatare për t'u pranuar në programet e specializimeve afatgjata në mjekësi. Lista e vendeve më sipër përcaktohet me udhëzim të përbashkët të MASH dhe MSH.

Kriteri 2 Kandidati që aplikon për të vazhduar programin e studimeve të ciklit të tretë, për specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë, i nënshtrohet një konkursi pranimit për të testuar njohuritë në fushën përkatëse të studimit.

Kriteri 3 Vlerësimi i studentit për pranimin në një program studimi bëhet me pikë duke vlerësuar notën mesatare (notën përfundimtare sipas tipologjisë së diplomës që ai disponon) për jo më shumë se 20% të pikëve totale, testimin e përgjithshëm me shkrim për 30-40% të pikëve totale, testimin me shkrim specifik sipas programit të specializimit për të cilin konkuron për 40-50% të pikëve totale, intervistën me gojë për jo më shumë se 10-20% të pikëve totale duke përfshirë këtu, eventualiasht, dhe letrat e rekomandimit nga profesorë të fushës të cilët deklarojnë se kanë patur bashkëpunim shkencor me kandidatin. Kohëzgjatja e provimit me gojë nuk mund të jetë më e shkurtër se 30 minuta.

Kriteri 4 Studenti duhet të ketë përfunduar me sukses provimin e shtetit në profesionin përkatës ose të ketë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në RSH ose jashtë saj (e njohur në RSH). Në rastet kur nuk e ka përfunduar ende provimin e shtetit pranohet me kusht që ta përfundojë atë me sukses brenda vitit të parë të specializimit, në të kundërt përjashtohet nga specializimi dhe shlyen financiarisht pagesat eventuale që ka përfituar gjatë specializimit.

Kriteri 5 Këshilli i Profesorëve përcakton kriteret për t'u pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata të pasqyruara në rregulloren e

Sipas (*nenit 6*) të rregullores së programit, procesi i pranimit të kandidatëve bëhet me anë të dokumentacionit, më pas Dekanati shpall listën emërore të kandidatëve të regjistruar që plotësojnë kriteret dhe ngrenë komisionet e pranimit.

Sipas (*nenit 8*) të rregullores së programit kandidatët specializues afatgjatë në stomatologji përzgjidhen sipas një sistemi pikëzimi me 150 pikë në total konkretisht:

- Mesataren e studimeve – 100 pikë;
- Trajnime, referime, prezantime – 20 pikë;
- Eksperienca profesionale – 10 pikë;
- Intervista – 20 pikë;

Referuar RVB-së dhe vizitës në sekretarinë mësimore, rezulton se, dosja e studentit përmban dokumentacionin lidhur me arsimin që studenti ka kryer, liçensimin profesional, pjesëmarrjen e specializantit në aktivitete të ndryshme shkencore, si në kongrese dhe konferenca, workshop-e, kualifikime të mëparshme etj. Komisioni që kryen intervistën me gojë, pyet zakonisht për eksperiencën klinike që ata kanë, lidhjen e saj me fushën e specializimit që kërkojnë, arsyen dhe motivimin për profilin e zgjedhur etj. Më pas hidhen të dhënat përmbledhëse me rezultatet e gjithësecilit, dhe në fund bëhet renditja përfundimtare e aplikantëve.

Kandidatët e regjistruar në SPA kanë dhënë provimet e shtetit dhe kanë qenë diplomuar më parë. Gjithashtu, ata janë të pajisur me licencë profesionale dhe të regjistruar tek Urdhëri i Stomatologut në Shqipëri, ose në vendin nga vijnë. Studentët informohen rregullisht për çdo kriter që miratohet nga UAL. Informacioni publikohet në faqen zyrtare të institucionit. Rregullorja e programit SPA ka marrë miratimin e ministrive përkatëse në fazën e licensimit të tij. Me studentin lidhet kontrata individuale, pasi merr paraprakisht informacion të detajuar për programin e studimit specializues. Specializanti para se të nënshkruajë kontratën informohet për çdo detaj të kontratës dhe

Prabhua *Jay*

<p>programit të studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë dhe të aprovuara nga Senati Akademik. Rregullorja e specializimit duhet të ketë marrë pëlqimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Kriteri 6 Aplikanti merr paraprakisht informacion të detajuar për programin e studimit specializues, para se të pranohet në të.</p>	<p>informacione të tjera shtesë nëse dëshiron. <i>(Rregullore programi studimi.)</i></p>
---	--

STANDARDI V – STUDENTËT

Standardi V. 1- Studenti që ka përfunduar një program të integruar të studimeve në fushat e mjekësisë, farmacisë, stomatologjisë, plotëson standardet akademike të kritereve të pranimit të institucionit respektiv dhe gëzon të drejtën për t'u regjistruar në programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë.

<p>Kriteri 1 Aplikanti që kërkon të pranohet në programin e studimeve specializues ka parashtruar kërkesën për një fushë të veçantë specializimi dhe i nënshtrimit provimit të pranimit në programin e studimit specializues për të cilin ka aplikuar.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një model teorik të informatizuar për përcaktimin e njohurive, kapacitetit, aftësive të aplikantëve në këndvështrime të ndryshme (operativ, konjitiv e relacionues).</p> <p>Kriteri 3 Institucioni shpall paraprakisht programin e parashikuar për provimin e pranimit dhe instrumentat që përdor për përcaktimin e njohurive, kapacitetit, aftësive të aplikantëve në këndvështrime të ndryshme.</p> <p>Kriteri 4 Institucioni vlerëson në mënyrë të vazhdueshme politikatat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit.</p>	<p>Çdo aplikant fillimisht paraqet një kërkesë për t'u regjistruar dhe plotëson një formular aplikimi, i detyrueshëm për të gjithë.</p> <p>Ata gjithashtu kanë paraqitur pranë sekretarisë së fakultetit dosjen me dokumentacionin e kërkuar, e cila përmban diplomën e studimeve universitare, listën e notave të shkollës së lartë, fotokopjen e liçencës profesionale, trajnimet e mëparshme, çertifikatat e aktiviteteve që ka ndjekur, listën e referimeve, botimeve etj. Aplikantët përveç dokumentave të paraqitura realizojnë edhe një intervistë e cila vlerësohet deri në 20 pikë <i>(në 8 rregullores)</i>, për të përcaktuar njohuritë dhe aftësitë e ndryshme komunikative. UAL ka pranuar studentë vetëm në vitin akademik 2019-2020, duke zbatuar gjithë kriteret që përmban rregullorja e programit të studimit. Nga takimi me dekanin dhe drejtuesin e departamentit, GVJ u informua se, programi i studimit dhe rregullorja e programit, do të nënshtrimit rishikimit të herëpashershëm në kuadër të përshtatjes me aktet ligjore dhe nënligjore. <i>(Rregullore programi studimi.)</i></p>
---	---

Prabh... *July*

Standardi V. 2- Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin dhe të dhënat e studentëve që ndjekin programet e studimit specializuese afatgjata.

Kriteri 1 Institucioni ka një pasqyrë të përvitshme për numrin e të diplomuarve, në programet specializuese afatgjata, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.

Kriteri 2 Institucioni zotëron të dhëna individuale për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi (notat e mëparshme p.sh. vlerësimin e studentëve në programin e mëparshëm të studimit, etj.).

Institucioni disponon disa sisteme menaxhimi, sikundër është ai i sekretarisë mësimore, mësimdhënies online, kërkimi shkencor etj, çka mundëson ruajtjen e të dhënave në formë dixhitale.

Nga vizita në sekretarinë mësimore, rezulton se UAL ruan statistika, në lidhje me numrin e studentëve, transferimin, vlerësimin e tyre me nota dhe kredite, detyrimet e prapambetura dhe transferimet e studentëve nga ky program studimi dhe drejt këtij programi.

Ndërkohë në sistemin e sekretarisë mësimore ka të dhëna individuale për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi, notat e mëparshme p.sh. vlerësimin e studentëve në programin e mëparshëm të studimit, etj.

Standardi V. 3- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Studenti informohet në mënyrë të detajuar për programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit.

Kriteri 2 Studenti informohet për rezultatet e vlerësimit. Ato publikohen në ambientet e fakultetit.

Funksionimi i kombinuar në auditor dhe online në këto dy vite akademike gjatë pandemisë Covid 19, ka mundësuar që specialistët të informohen në mënyrë të detajuar për përmbajtjen e programit të studimit.

Nga takimi me studentët dhe analizimi i syllabuseve, rezulton se studentët informohet për vitin, semestrin se kur do të zhvillohet secila lëndë, detyrimet e pjesëmarrjes, pikët për të qenë kalues, literatura kryesore dhe ndihmëse. Studenti informohet se cili është pedagogu që do të zhvillojë lëndën, titulli dhe grada e pedagogut, veprimtaria e tij klinike dhe shkencore etj.

Sikundër në programet e tjera edhe për specialistët, ndiqet e njëjta procedurë informimi për titullarin e lëndës, stafin mësimdhënës që do të zhvillojë lëndën, eksperiencën e tij shkencore e klinike, titullin dhe gradën shkencore që ai ka. CV-të e përditësuara janë publikuar jo vetëm në faqen e internetit, por në çdo lëndë / modul në sistemin UAL – LMS përshkruhet një CV e shkurtër për

Prabh... *guy*

	<p>pedagogun dhe përmbajtjen e lëndës. Gjithashtu, nëpërmjet UAL – LMS, për çdo lëndë / modul publikohen rezultatet individuale të cilat studentë i marrin në mënyrë të pavarur nganjëri – tjetri.</p> <p><i>Syllabuse V1.</i> <i>Syllabuse V2.</i> <i>Syllabuse V3.</i> <i>(CV e stafit akademik)</i></p>
<p>Standardi V. 5 - Studenti ka të gjitha kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studenti i pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata ka kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit me karakter akademik e klinik.</p> <p>Kriteri 2 Programi i studimeve specializuese afatgjata siguron harmonizim të synimeve të studentit në fushën klinike dhe kërkimore-shkencore dhe, në përfundim të tij, edhe të mundësisë për karrierë profesionale ose punësim.</p> <p>Kriteri 3 Studenti që ndjek programet specializuese afatgjata të studimit ka në dispozicion një bibliotekë shkencore të pasur me botime në letër dhe në formë elektronike si dhe infrastrukturë të plotë të IT-së.</p> <p>Kriteri 4 Studenti ka mbështetje teknike të mjaftueshme për zhvillimin e aktivitetit klinik dhe kërkimor të lidhur me të.</p> <p>Kriteri 5 Hulumtimet që kanë të përfshira kërkime laboratorike mbështeten me bazë laboratorike të mjaftueshme.</p> <p>Kriteri 6 Studenti është i siguar gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin specializues. Për këtë disponohet dokumentacion i mjaftueshëm nga institucioni. Një kopje</p>	<p>Sikundër kemi shprehur më lart, një ngapikat më tëforta që aktualisht ka institucioni, është infrastruktura fizike, logjistike, IT etj. Kjo infrastrukturë është e nivelit bashkëkohor dhe e mjaftueshme për të realizuar programin e studimit, si nga ana akademike, ashtu edhe në aspektin klinik e mjekësor të tij. Dy godinat e kampusit të ri janë ndërtuar në vitin 2020. Për studentët janë në dispozicion 10 klinika dentare me rreth 40 unite dentare moderne, laboratore si ai i Ortodoncisë, i Protetikës fikse dhe të lëvizshme, laborator i anatomisë, i informatikës etj. Në çdo poliklinikë ka aparate grafie dixhitale, të gjitha aparatat për sterilizim dhe paketim të veglave dhe pajisjeve që përdorin specializantët.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në mënyrë të tillë që studentët fillimisht të marrin njohuri teorike dhe gradualisht të kalojnë në realizimin praktik të tyre.</p> <p>Praktika klinike në programin e studimit “Specializim afatgjatë në Kirurgji Orale” përfshin praktikën e Kirurgjisë Orale dhe Implantologjisë. Praktika organizohet në klinikën universitare stomatologjike “Aldent “ dhe është komplekse dhe specifike për nivelin e tretë të studimeve. Në përbërjen e saj janë rreth 400 orë të programit mësimor të grupuara në laboratore, workshope dhe raste klinike. Nga vëzhgimi i ambjenteve gjatë vizitës në institucion, rezulton se UAL ofron infrastrukturën e nevojshme për organizimin dhe funksionimin e praktikës klinike. Aktualisht operohet në 3 salla kirurgjikale të pajisura me</p>

Prabhu *gery*

e policës së sigurimit i dorëzohet studentit në momentin e lidhjes së saj.

aparaturat dhe instrumentat e nevojshëm, si dhe në kabinetet laboratorike për temat e laboratoreve. Sallat kirurgjikale janë të pajisura me aparatura moderne në fushën e Kirurgjise Orale, si kamera operatorë Ekler, aparati i grafisë endo-orale dhe panorameks, bisturia piezo-elektrike, lazeri, centrifuga, motori kirurgjikal i vendosjes të implanteve, mikroskopi si dhe së fundmi aparatura e sedacionit. Sallat operatore janë të plotësuara në instrumentariumin e nevojshëm kirurgjikal me kite të plota për ndërhyrje kirurgjikale si sinus lift, kirurgji paradontale, kiti i fiksimit dhe stabilizimit të membranave në GBR dhe kite kirurgjikale të përgjithshme. Kabinetet laboratorike janë të pajisura me sisteme kompjuterike dhe ofrojnë mundësinë e laboratoreve dixhitale në Kirurgji Orale dhe Implantologji.

Praktikat laboratorike janë organizuar në bazë të temave përkatëse të syllabusit sipas çdo viti akademik. Qëllimi i tyre është simulimi i teknikave të ndryshme operatore dhe përgatitja e specialistëve për menaxhimin e rasteve klinike. Janë organizuar laboratorë me temë anatomia topografike kirurgjikale dhe peri-implantare; instrumentariumi në kirurgjinë orale dhe implantologji; leximi dhe interpretimi i skanerit dentar; llojet e lambove dhe aplikimi i tyre në nofulla derri; llojet e suturave dhe aplikimi u tyre në nofulla viçi; protokoli kirurgjikal i vendosjes të implanteve në nofulla sintetike dhe në nofulla derri; llojet e suturave në kirurgjinë paradontale në nofulla viçi; marrja e masës mbi implante dhe teknikat e saj; protokoli All on 4 në Implantologji në nofulla sintetike; aplikimi i sistemit Rhein – 83 për stabilizim të protezës totale, etj.

Referuar RVB-së, GVJ u informua se rastet klinike janë komplekse dhe të mirëorganizuara. Pasi kalon në sallën e filtrit, rasti klinik planifikohet për konsultë për ndërhyrjen kirurgjikale. Pacienti në konsultë i nënshtrohet ekzaminimeve plotësuese, diagnostikimit dhe planifikimit të ndërhyrjes kirurgjikale. Kartelës klinike të tij i bashkëngjitet

Practus

konsenti i firmosur. Konsenti është i detajuar në lidhje me ndërhyrjen kirurgjikale apo me vendosjen e implanteve. Parapërgatitja e pacientit, ndërhyrja kirurgjikale dhe monitorimi postoperator bëhet nga specialistët në mbikqyrjen e plotë dhe të kujdesshme të mjekëve nëshërbimin klinik shqiptar dhe italian. Rastet klinike të trajtuara në Kirurgjinë Orale janë ekstraksioni i dhëmbëve të impaktuar si molarët e tretë dhe kaninët, rikuperimi ortodontik-kirurgjikal i kaninëve maksilarë-mandibularë, ekstraksioni i dhëmbëve supranumeratum, trajtimi i cistave radikulare përmes teknikës të cistektomisë dhe dekompressionit transalveolar, ndërhyrje në Kirurgjinë paraprotetike, si frenektomia, hiperplazitë gingivare, ekzostozat dhe thellimet e sulkusit vestibular, apikotomitë në kirurgjinë endodontike, trajtimi i xhepave dhe defekteve kockore, teknika Widman e modifikuar, teknikat resektive dhe regenerative në kirurgjinë paradontale, gingivektomitë me lazer, trajtimi kirurgjikal i epuliseve, polipeve dhe fibromave, trajtimi i abseseve, drenimi kirurgjikal i tyre, trajtimi kirurgjikal i mukocelave, si dhe ekstraksionet komplekse të dhëmbëve.

Rastet klinike të trajtuara në Implantologji janë vendosja e implanteve, ngritjet e mëdha laterale të sinusit dhe ngritjet e vogla kreshtale, teknikat si split-crest dhe socket preservation, si dhe teknikat e augmentimit kockor përmes GBR dhe përdorimit të centrifugës, marrja e grafeve të indeve të buta nga palatum, përdorimi i dhëmbëve të ekstraktuar nga pacienti si shtesë kockore autologe në augmentimet kockore, aplikimi i implanteve për stabilizim të protezës totale, vendosja e miniimplanteve për ankorim ortodontik, explantime dhe trajtimi i periimplantiteve. Rastet klinike në Implantologji përfshijnë dhe protezimin e implanteve, duke filluar nga teknikat e marrjes të masës me lugë standarde/ të individualizuar dhe të gjitha llojet e protezimeve, si punime të cementura, punime me filet, si dhe proteza mbuluese overdentures.

Practica

Jeny

Specializantët përgatisin dhe plotësojnë kartelën klinike të pacientit, bëjnë premedikimin dhe parapërgatitjen e pacientit, konsultojnë dhe përvetësojnë qartë protokollin kirurgjikal sipas çdo rasti klinik, kryejnë ndërhyrjen operatore dhe bëjnë monitorimin postoperator të rastit klinik. Stafi në shërbimin klinik përbëhet nga mjekët primarë-supervisorë, si dhe asistentët dhe infermierët e sallës. Shërbimet në Kirurgjinë Orale në Klinikën Universitare Stomatologjike Aldentjanë falas dhe me kosto të reduktuar në Implantologji, duke patur në fokus pacientët në moshë të tretë dhe pacientët me mundësi financiare të kufizuara.

Rastet klinike dhe ecuria e tyre janë objekt i kërkimit shkencor në bashkëpunimin mjek-specializant, si dhe në projekte të universitetit "Aldent" me bashkëpunëtorët si "Dental Leader Corsi" dhe kolegët italianë. Disa studentë kanë kryer edhe punime shkencore, i kanë referuar ato në kongrese apo konferenca shkencore dhe kanë bërë botime edhe në revista brenda e jashtë vendit. Këtu studion një specializant që ka fituar çmim ndërkombëtar për studimin që ka kryer në Universitetin Aldent.

Në këtë institucion specializantët kanë kushtet e nevojshme për studim, por dhe për punë studimore shkencore, kanë laboratore e bazë materiale dhe asistohen nga pedagogë specialistë në profesion, por edhe në punën kërkimore/shkencore. Gjatë takimeve në institucion nga specializantët e Ortodontisë u deklarua se ata operojnë në 2 salla operative, ku realizojnë edhe aktivizimin e aparateve. Studentët fillojnë me analizën e modeleve të studimit, radiografive dhe vendosjen e diagnozës klinike në vitin e parë dhe vijojnë më pas me ndërtimin dhe aplikimin e aparateve të lëvizshme e funksionale në vitin e dytë. Në vitin e tretë fokusohen në aparatet fikse të tipologjive të ndryshme, aparatet e ankorimit, retensionit, etj. Pacientët e ortodontisë trajtohen me koston minimale të laboratorit, apo vetëm me koston e aparatit. Ata paraqiten në takime të vazhdueshme,

Prushas
Jey

	<p>çdo 3-4 javë, për aktivizimin e aparateve që kryhet nga vetë specializanti i mbikqyrur nga mjeku shqiptar/italian tutor dhe asistentët e sallës. Trajtimet më frekvente në klinikën universitare janë klasat e para me grumbullime dentare;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. trajtimet interceptive të klasave të dyta dhe të treta; 2. trajtimi i klasave të dyta apo të treta tek pacientët adultë; 3. kafshimi i thellë; 4. kanini ektopik apo i impaktuar; 5. kafshimi i hapur, etj; <p>Aparatet që vendosin specializantët realizohen në laboratorin e universitetit. Aparatet e tilla si: aparat i lëvizshëm superior dhe inferior, zgjeruesi i shpejtë maksilar, distalizues të ndryshëm, buton Nance, hark TPL, hark lingual, aparatet e retensionit (maskerina / pllakë Hawley), aparate funksionale (twin block, Andresen, etj). Studenti është i siguar gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin specializues. Për këtë disponohet dokumentacion i mjaftueshëm nga institucioni. Një kopje e policës së sigurimit i dorëzohet studentit në momentin e lidhjes së saj. Në dosjen e çdo studenti gjendet sigurimi shëndetësor.</p> <p><i>(Sigurimi i shëndetit.)</i> <i>Planimetri Kampusi i ri.</i> <i>Planimetri të Kampus A+B.</i> <i>(Plani mësimor.)</i> <i>Plani mësimor.</i> <i>Syllabuse V1.</i> <i>Syllabuse V2.</i> <i>Syllabuse V3.</i></p>
<p>Standardi V. 6- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikën e studentëve që kanë përfunduar programet e studimit specializues afatgjatë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar dhe vendet e punësimit.</p>	<p>Funksionon Zyra e Alumnit, e cila mbështet në mënyrë aktive të diplomuarit për karrierën dhe përshatjen me tregun e punës. Institucioni disponon të dhëna të mjaftueshme për secilin prej tyre për</p>

Prachua *guy*

	vendin e punësimit, angazhimet e tjera akademike etj. Këto të dhëna përditësohen në forma të ndryshme përfshirë dhe formularët për studentët sikundër është bërë në vitin 2021. (Tabela)
Standardi V. 7- Institucioni ndjek procedura të qarta për vlerësimin e njohurive të studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura të qarta dhe transparente për vlerësimin në vazhdimësi të dijeve të studentit, të përcaktuara dhe të bëra të ditura që në fillim të programit të studimeve në rregulloren e specializimit.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin e njohurive të marra nga studentët gjatë programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3 Konkluzionet e vlerësimit në vazhdimësi, janë të qarta dhe transparente, përfshirë pezullimin, zgjatjen ose përjashtimin nga studimet specializuese.</p> <p>Kriteri 4 Vlerësimi vjetor i studentëve bëhet sipas moduleve që ka ndjekur specializanti gjatë atij viti akademik.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve, njohurive, aftësive profesionale tashmë është i konsoliduar. Për çdo lëndë nisur nga specifikat e saj, janë ndjekur procedura të qarta e transparente për vlerësimin e specializantëve. Institucioni ndjek procedura të qarta dhe transparente për vlerësimin e studentëve. Mënyra dhe llojet e vlerësimit i bëhen të qarta studentit në fillim të specializimit. Po ashtu, mënyra e vlerësimit, përqindja e llojeve të ndryshme të vlerësimit, pikët që nevojiten për të marrë një notë të caktuar janë të shprehura në syllabuset e çdo moduli.</p> <p>Nga takimi me studentët dhe sekretarinë mësimore, GVJ u informua se, rezultatet pasqyrohen në regjistra sikundër është ai i sekretarisë mësimore për hedhjen e notave, ose UAL – LMS për shpalljen e rezultateve të çdo testimi apo provimi të realizuar nga kandidatët. Vlerësimi semestral dhe vjetor i specializantëve është bërë vetëm sipas moduleve të lëndëve të zhvilluara në atë semestër apo vit akademik dhe që natyrisht janë në përputhje me planin mësimor të shpallur e njohur që në fillim. Këto sisteme kanë qënë mjaft të nevojsheme sidomos për zhvillimin e veprimtarive mësimore gjatë pandemisë Covid 19.</p> <p><i>Syllabuse V1.</i> <i>Syllabuse V2.</i> <i>Syllabuse V3.</i></p>
Standardi V. 8 - Vlerësimi përfundimtar i studentëve	
<p>Kriteri 1 Studenti jep prova që ka fituar:</p> <p>a. Njohuri të thelluara në fushën përkatëse;</p> <p>b. Njohuri të thelluara në disa fusha të afërta me të;</p>	<p>Përfundimi i studimeve në programin e studimit, e pajis studentin me njohuri të thelluara në fushën përkatëse apo në fusha të përfaqësuara me të, aftësi profesionale dhe shkencore në përdorimin e teknologjisë bashkëkohore për të zgjidhur problemet klinike që lidhen me fushën e tij të</p>


Pachira *Jey*

<p>c. Aftësi profesionale dhe shkencore në përdorimin e teknologjisë bashkëkohore për të zgjidhur problemet klinike që lidhen me fushën e tij të specializimit dhe integrimin e njohurive të fituara për zgjidhjen e situatave komplekse;</p> <p>d. Risi, për të zgjeruar dhe për të rifreskuar njohuritë ekzistuese;</p> <p>e. Autonomi, integritet shkencor, profesional dhe përkushtim për zhvillimin e ideve të reja;</p> <p>f. Aftësi bashkëpunimi në grup për zgjidhjen e situatave të ndryshme klinike;</p> <p>g. Sjellje etike dhe profesionale.</p> <p>Kriteri 2 Studenti jep prova që me anë të punës së tij klinike ka fituar aftësinë dhe kompetencat profesionale dhe shkencore të nevojshme për të ushtruar profesionin në mënyrë të pavarur.</p> <p>Kriteri 3 Studentit i jepet e drejta për të hyrë në provimin përfundimtar pas shqyrtimit të dosjes së tij nga këshilli i programit specializues i cili e vlerëson atë pozitivisht ose negativisht. Dosja e kandidatit përmban vlerësimet mbi praktikat dhe modulet e kryera si dhe vlerësimet periodike nga ana e tutorit. Në rast vlerësimi negativ nga këshilli i programit specializues, studentit i komunikohet vendimi si dhe pjesët që duhet të përsërisë në mënyrë që të mund të hyjë në provimin përfundimtar.</p> <p>Kriteri 4 Vlerësimi përfundimtar i specializantëve bazohet në rezultatet e vlerësimeve periodike vjetore, në provimin përfundimtar dhe temën eksperimentale të diplomës si dhe gjykimin e pedagogeve dhe të udhëheqësit.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin</p>	<p>specializimit dhe integrimin e njohurive të fituara për zgjidhjen e situatave komplekse, për të zgjeruar dhe për të rifreskuar njohuritë ekzistuese, autonominë, integritetin shkencor, profesional dhe përkushtimin për zhvillimin e ideve të reja, aftësitë e bashkëpunimit në grup për zgjidhjen e situatave të ndryshme klinike, sjellje etike dhe profesionale etj. Tashmë programi rezulton të jetë i konsoliduar pasi janë diplomuar dy breza studentësh.</p> <p>Në UAL provimet zhvillohen sipas një strukture të parapërcaktuar ku bëhet i mundur testimi i gjithëanshëm i studentit.</p> <p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentët, GVJ u informua se studentët janë të aftë që duke u bazuar në mundësitë që u jep teknologjia të përcaktojnë një plan të qartë mjekimi, të udhëhequr dhe në diskutim me pedagogun përkatës. Pas përcaktimit të këtij plani dhe vendosjes së diagnozës, vlerësohen mundësitë e trajtimit të pacientit.</p> <p>Pedagogët në UAL i kanë kushtuar rëndësi të mësuarit kritik, për t'i bërë specializantët të aftë për tu orientur në zgjidhjen e rasteve të vështira, për tu konsultuar me literaturën apo me specialistë të tjerë më me eksperiencë kur kjo është e nevojshme.</p> <p>Studentët kanë kontakte me email apo forma të tjera komunikimi me pedagogun e lëndës apo me tutorin me të cilit konsultojnë raste të ndryshme klinike. Nga shqyrtimi i planit mësimor, GVJ, konfirmon se në përfundim të këtij programi studimi studentët do të kenë përfituar kompetencat profesionale dhe shkencore për të ushtruar profesionin në mënyrë të pavarur. Studentët e SPA-së, sipas rregullores së programit, mund të hyjnë në provimin përfundimtar vetëm mbasi të kenë plotësuar numrin e duhur të krediteve dhe të kenë shlyer gjithë detyrimet praktike të paracaktuara. UAL zotëron një sistem të informatizuar të menaxhimit të studentëve dhe të vlerësimit të tyre</p> <p><i>Plani mësimor. Rregullore programi studimi. (Model diplome. suplement Spa Stomatologji.) (Rregullore programi studimi.)</i></p>
---	---

Prabura

dey

dhe vlerësimin final të njohurive të marra nga studentët.	
STANDARDI VI- INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE INFORMACIONE NGA BURIME TË TJERA	
Standardi VI. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Biblioteka vë në dispozicion të programit të studimit një listë titujsh aktualë të literaturës së detyruar, e cila ndodhet realisht në bibliotekë.</p> <p>Kriteri 2 Biblioteka zotëron një listë të botimeve periodike dhe programeve kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit.</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të.</p> <p>Kriteri 4 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Në kampusin e ri është ndërtuar një bibliotekë moderne me hapësira të bollshme leximi e studimi, e cila përmban literaturë mjekësore të viteve të fundit në gjuhën shqipe, por dhe në gjuhën angleze e italiane. Kjo bibliotekë ka orare të përshtatshme për tu shfrytëzuar nga specializantët e studentët.</p> <p>Nga vizita në ambjentet e bibliotekës, GVJ u informua se, UAL prej vitesh është e abonuar në bibliotekën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (HINARI), dhe ju ofron studentëve e specializantëve të saj akses pa pagesë në shfrytëzimin e inventarit të kësaj biblioteke online. Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve për të gjitha programet e studimit që UAL ofron. Përveç donacioneve të teksteve të dhëna, në bibliotekë gjenden të gjitha punimet e diplomave të studentëve, botime shkencore të stafit, etj.</p> <p><i>Planimetri Kampusi i ri.</i> <i>Planimetritë Kampus A+B.</i></p>
Standardi VI. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë, mjedise të përshtatshme mësimore dhe struktura klinike.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka laboratorë, klasa, zyra, studio, auditore dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit.</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit, si dhe në përmirësim të vazhdueshëm.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion të studentëve strukturat klinike pjesë e</p>	<p>Siç është përmendur më lart gjërësisht në këtë raport, referuar vizitës në ambjentet e institucionit, GVJ konfirmon se, UAL ofron infrastrukturën e nevojshme për organizimin dhe funksionimin e praktikës klinike. Aktualisht operohet në 3 salla kirurgjikale dhe 2 salla ortodoncie, të pajisura me aparatat dhe instrumentat e nevojshëm, si dhe me kabinetet laboratorike për temat e laboratoreve. Sallat janë të pajisura me aparatura moderne në fushën e stomatologjisë si kamera operatore Ekler, aparate i grafie endo-orale dhe panorameks, bisturi piezo-elektrike, lazer, centrifuga, motorë</p>


Prachina 

rrjetit formues për zhvillimin optimal të programit specializues.

kirurgjikalë të vendosjes së implanteve, mikroskopi kirurgjikal dhe endodontik, si dhe se fundmi aparatura e sedacionit koshient. Sallat janë të plotësuara me instrumentariumin e nevojshëm për të gjithë gamën e ndërhyrjeve kirurgjikale dhe trajtimeve ortodontike. Kabinetet laboratorike janë të pajisura me sisteme kompjuterike dhe ofrojnë mundësinë e laboratoreve dixhitale në të dy profilet e specializimit. Institucioni ka infrastrukturë të përshtatshme për të realizuar programin e studimit në SPA dhe për të gjithë programet për të cilat është licensuar. Ndërkohë, në total janë rreth 40 laboratore, të cilat janë në dispozicion të studentëve, shumë prej tyre ju përkasin programeve të studimit të të gjitha viteve të profilit të stomatologjisë. Po ashtu ka salla leksionesh e seminaresh, salla për stafin mësimdhënës e administrativ, salla mbledhjes e takimesh, etj.

Konkluzionet e vlerësimit:

Në përfundim të vlerësimit të standardeve dhe kritereve që lidhen me studentët, GVJ arrin në konkluzionin se institucioni i përmbush ato. Institucioni pranon kandidatë me kritere specifike që janë të përcaktuara në rregulloren përkatëse. Aktualisht mesatarja e studentëve të këtij programi, në hyrje është 8. Institucioni disponon infrastrukturë dhe logjistikë të teknologjisë së informacionit në nivelin e duhur, çka i mundëson jo vetëm ruajtjen e të dhënave, por më së shumti shpërndarjen e informacionit në kohë reale për studentët. Infrastruktura fizike, laboratorike e mësimore, është në nivelin e dëshiruar. UAL ofron infrastrukturën e nevojshme për organizimin dhe funksionimin e praktikës klinike. Aktualisht operohet në 3 salla kirurgjikale dhe 2 salla ortodontie, të pajisura me aparatat dhe instrumentariumin e nevojshëm, si dhe me kabinetet laboratorike për temat e laboratoreve. Sallat janë të pajisura me aparatura nga më modernet në fushën e stomatologjisë. Sallat janë të plotësuara me instrumentariumin e nevojshëm për të gjithë gamën e ndërhyrjeve kirurgjikale dhe trajtimeve ortodontike. Kabinetet laboratorike janë të pajisura me sisteme kompjuterike dhe ofrojnë mundësinë e laboratoreve dixhitale në të dy profilet e specializimit. Ndërkohë në total janë rreth 40 laboratore të cilët janë në dispozicion të studentëve, shumë prej të cilëve u përkasin programeve të studimit të të gjitha viteve të profilit të stomatologjisë. Po ashtu, ka salla leksionesh e seminaresh, salla për stafin mësimdhënës e administrativ, salla mbledhjes e takimesh etj. UAL disponon bibliotekë dhe librari online të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Hinari, sistem interneti 24 orë dhe facilitetet e duhura përfshirë facilitete sportive dhe lokacioni në një nga pozicionet më të përshtatshme dhe më me zhvillim në Tiranë.

Prubus 

POLITIKA E KËRKIMIT SHKENCOR TË INSTITUCIONIT

10. Kërkimi shkencor dhe përfshirja në kërkime të studentëve të SPA-s.

Pjesa përshkrimore:


Terma reference: politikat e kërkimit shkencor të IAL, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja e studentëve specializantë në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, etj.

Nga drejtuesit dhe stafi i UAL-së u deklarua se kërkimi shkencor është përcaktuar si prioritar edhe në programin e studimeve të SPA-s. Në nivel universiteti janë realizuar veprimtari të ndryshme si referime, botime shkencore në revistën e universitetit Albanian Journal of Biomedical Sciences (AJBS)³, në të cilën botohen në mënyrë periodike, punime të stafit dhe studentëve. Po ashtu ka dhe shumë botime, sidomos nga stafi, në revista prestigjioze ndërkombëtare me faktor impakti. Këto botime kanë ndihmuar stafin midis të tjerash edhe për mbrojtjen e gradave shkencore, si Doktor i Shkencave, apo dhe fitimin e titujve akademikë si Profesor i Asociuar. Universiteti disponon gjithashtu edhe një platformë të kërkimit shkencor në fushën e shkencave mjekësore “International Conference of Medical Sciences (ICMS)”, nëpërmjet së cilës bëhet e mundur zhvillimi i konferencave dhe veprimtarive të tjera shkencore të institucionit. (*Print screen platforma online.*)

Universiteti organizon konferencën e përvitshme ICMS, ku një nga seksionet e përvitshme të konferencës është e dedikuar posaçërisht për studentët. Megjithatë, nga takimi me studentët, ata u shprehën për një angazhim më të madh në kërkim shkencor dhe projekte. Një kërkesë të tillë ata e kanë shprehur edhe në rezultatet e pyetësorit të zhvilluar në vitin 2021, prej të cilave rezultojnë se studentët dëshirojnë të përfshihen më shumë në kërkim shkencor dhe projekte.

Një ndikim negativ ka patur dhe pandemia Covid 19, veçanërisht në zhvillimin e projekteve të mobilitetit, sikundër u deklarua edhe nga personeli akademik. Shumë nga këto projekte të parapara, ose u anuluan, ose u realizuan pjesërisht me shumë vështirësi; gjithmonë për arsye të pandemisë së Covid19. Pas hapjes së pjesshme, nga UAL janë zhvilluar disa aktivitete të rëndësishme, ku më kryesore është Konferenca Ndërkombëtare e Shkencave Mjekësore ICMS 2021, në të cilën ka patur një pjesëmarrje të gjërë jo vetën nga stafi i UAL-së, por dhe nga institucione partnere brënda vëndit, si Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Universiteti i Elbasanit, Durrësit etj. Vlen të theksohet se në këtë konferencë pati dhe një pjesëmarrje të gjërë dhe nga shumë universitete jashtë vëndit. UAL ka qenë bashkorganizatore dhe pjesëmarrësee Kongresit të 3-të të Stomatologjisë Shqiptare, Nëntor 2019, në Simpoziumin e 4-të të Ortodontisë, me pjesëmarrjen aktive të stafit dhe studentëve, Takimin e ortodontëve, dhjetor 2020 etj. Në RVB janë paraqitur disa nga veprimtaritë dhe të dhënat mbi aktivitetin shkencor në UAL. Me poshte po paraqesim nje tableqe qe jep te dhena mbi aktivitetin shkencor ne UAL.

³<https://www.ajbsonline.com/>



Aktiviteti Shkencor ne Universitetin "Aldent

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang Institucioni në të cilët janë përfshirë studentët specializantë		Numri	Të dhënat (Titujt) për Revistat shkencore, projektet, aktivitetet shkencore
1.	Botime ku studentët kanë artikujt shkencorë	12	Revista Stomatologjike Shqiptare, Revista Apollonia, Konferenca Stomatologjike, Revista AJBS, Konferenca te huaja dhe vendase
2.	Projektet kërkimore të fituara nga udhëheqësit dhe /ose studentët e SPA	2	Projekt me Universitetin e Marmarasë dhe brenda UAL
3.	Projekte të zbatuara	1	
4.	Aktivitete shkencore të organizuara nga IAL	20	
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL	35	
6.	Studentët e SPA përfshirë në kërkimin shkencor, etj	8	Referime, poster, botime ne Konferencat e Stomatologjise, Ortodoncise, Kirurgjisë, etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 4 - Objektiva të programit të studimit të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë janë angazhimi i vazhdueshëm në punën klinike e kërkimore dhe nxitja e punës në ekip e studentëve.	
<p>Kriteri 1 Studenti angazhohet në punën klinike e kërkimore për aftësimin dhe përfundimin me sukses të programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2 Studenti merr pjesë në aktivitete të ndryshme klinike të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ndjek studimet e specializimeve, të cilat e ndihmojnë të aftësohet për:</p>	<p>Praktikat klinike dhe kërkimore janë komplekse dhe të mirëorganizuara. Këto veprimtari shërbejnë për rritjen e aftësive profesionale të specializantëve dhe njëkohësisht krijojnë mundësi për angazhim në kërkim shkencor, botime, etj. Këto aktivitete zhvillohen sipas një programi të caktuar dhe janë fokusuar në edukimin e vazhdueshëm, ku përfshihen përveç leksioneve dhe seminareve, edhe trajnime dhe</p>

Prubus *Jay*

<p>a. Përvetësimin e metodologjive dhe njohurive klinike e kërkimore për veprimtari krijuese të pavarura si: artikuj shkencorë, prezantime, etj.;</p> <p>b. Punën e pavarur në laborator/klinikë;</p> <p>c. Përdorimin e burimeve të informacionit (p.sh. bibliotekat dhe internetin, databazat me karakter shkencor/klinik) dhe administrimin e informacionit;</p> <p>d. Përdorimin e teknologjive bashkëkohore për prezantime publike;</p> <p>e. Përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të të dhënave;</p> <p>f. Njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar lidhur me fushën klinike të specializantit.</p> <p>Kriteri 3 Studenti i programit specializues merr pjesë në aktivitetet e parashikuara të programit të studimit jashtë punës së tyre klinike.</p> <p>Specializanti është i lirë të marrë pjesë si dëgjues apo si referues në:</p> <p>a. Ligjërata;</p> <p>b. Seminare;</p> <p>c. Debate ndërdisiplinore, të organizuara në kuadër të programit të studimit të specializimeve;</p> <p>d. Mundësi të tjera të të mësuarit si: ndjekja e prezantimeve të konferencave dhe seminareve të ndryshme me karakter klinik.</p> <p>Udhëheqësit i këshillojnë studentët të marrin pjesë në aktivitete dhe konferenca shkencore që i ndihmojnë në punën e tyre dhe klinike.</p> <p>Kriteri 4 Studenti fiton aftësi për komunikimin e duhur me nivel profesional</p> <p>Kriteri 5 Studenti ndjek rregullat e sjelljes etike dhe profesionale me pacientët dhe</p>	<p>workshope për metoda të reja mjekimi, apo për përdorimin e materialeve bashkëkohore të trajtimit të nozologjive të ndryshme.</p> <p><i>Gjithsesi referuar evidencave bashkëlidhur RVB-së, mendojmë se institucioni ka nevojë të përmirësojë pjesëmarrjen e specializantëve në lidhje me punimet kërkimore shkencore.</i></p> <p>Po ashtu, ato ndikojnë në përvetësimin e metodologjive dhe njohurive klinike e kërkimore, përgatitjen e artikujve shkencorë, prezantimeve, punën e pavarur në laborator/klinikë, përdorimin e burimeve të informacionit, përdorimin e teknologjive bashkëkohore për prezantime publike, përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të të dhënave, njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar etj.</p> <p>Disa lëndë në vitin e parë shërbejnë për formimin e përgjithshëm me aftësi informatike e statistike si lënda e Biostatikës dhe Informatikës, të cilat i ndihmojnë specializantët në mënyrën e mbledhjes së materialit, si edhe organizimin dhe realizimin e një studimi, përpunimin statistikor të tij, etj. Pjesëmarrja e studentëve në këto veprimtari është aktive mbasi shpesh herë ato organizohen me pyetje-përgjigje dhe ku auditori merr pjesë në diskutimin e rasteve të caktuara klinike apo në përcaktimin e planeve të mjekimit. Studentët gjatë periudhës së specializimit sjellin raste konkrete pacientësh të cilat bëhen objekt diskutimi në grup, gjithmonë nën mbikqyrjen dhe udhëheqjen e pedagogut të lëndës.</p> <p>Në aktiviteteteve kanë referuar profesorë e shkencëtarë të shquar të stomatologjisë, teknologjisë e të materialeve dentare. Problematika e këtyre referimeve është e gjërë dhe e shumëanëshme, ajo përfshin teori dhe metoda të reja diagnostikimi e mjekimi sidomos në fushat me interes të Stomatologjisë së sotme si Implantologjia dhe Ortodoncia fikse, që janë</p>
--	---

Prubus

[Signature]

<p>kolegët dhe fiton aftësi për komunikim korrekt me të tjerët.</p>	<p>dhe pjesë e programit të SPA-së që ofron Universiteti Aldent. Specializantët këtu marrin pjesë aktivisht, bëjnë pyetje dhe përfshihen në diskutime.</p> <p><i>(Veprimtaria kërkimore, monitorimi dhe rezultatet.)</i> <i>Plani mësimor.</i> <i>Syllabuse V1.</i> <i>Syllabuse V2.</i> <i>Syllabuse V3.</i></p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Universiteti Aldent mundëson veprimtari të shumta në fushën e aftësisimit profesional, klinik të studentëve. Trajnimet me pedagogë të huaj, konferencat dhe veprimtaritë e tjera u mundësojnë specializantëve dhe studentëve kushte optimale studimi, për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete e veprimtari shkencore brenda e jashtë vendit, si dhe për realizimin e studimeve me karakter shkencor dhe prezantimin apo botimin e tyre në revistën e universitetit apo edhe revista të tjera brënda dhe jashtë vëndit. Pandemia Covid 19 ka krijuar disa problematika që lidhen me veprimtaritë kërkimore, pjesëmarrjen në projekte dhe mobilitete të studentëve të SPA-së.</p> <p><i>Në këtë drejtim institucioni duhet të fokusohet më shumë për të plotësuar mangësitë e krijuara gjatë kësaj periudhe dy vjeçare.</i></p>	


11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar në funksion të programit të SPA-së

Pjesa përshkrimore:

Terma reference: bashkëpunimi i Shkollës së SPA me institucione/organizata kërkimore në nivel kombëtar/ndërkombëtar, personeli akademik i ftuar, etj.

Universiteti Aldent në gjithë veprimtarinë e tij për përgatitjen e specialistëve të fushës së mjekësisë dhe të mjekëve stomatologë të specializuar në profile të veçanta, siç janë ato të Kirurgjisë Orale dhe Ortodontisë që ofron ky program i SPA-së, ka patur edhe një objektiv prioritar që është bashkëpunimi i tij me institucione, firma apo individë të shquar brenda e jashtë vendit. UAL dokumenton marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, Qendrën spitalore universitare "Nënë Tereza", Spitalin e Traumës, Shoqatën Dentare Shqiptare, Shoqatën e Pedodontëve, Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, Shoqërinë "Dental Leader Corsi", Shoqërinë e Sigurimit Albsig Sha, Banka të ndryshme të nivelit të dytë etj. Gjithashtu ka marrëveshje bashkëpunimi me Universita degli studi "G. D'Annunzio" Chieti, Pescara në Itali. Studentët e studimeve pasuniversitare të Universitetit "Gabriele d'Annunzio", të Chietit, në Itali, kanë mundësinë e kryerjes së aktiviteteve kërkimore në UAL, për një periudhë nga 12 muaj deri në 18 muaj, nën mbikqyrjen e një profesori ose kërkuesi pranë Universitetit Aldent. Po ashtu, ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e

Practus



L'Aquilles në Itali. Shumë pedagogë dhe profesorë të këtij universiteti kanë dhënë leksione në SPA, apo kanë mbajtur tema në konferenca të ndryshme shkencore.


Në RVB dhe gjatë diskutimeve me stafin dhe studentët, u evidentuan edhe shumë bashkëpunime të tjera me Universitete në Lituani, Poloni, Çeki, Turqi, Bullgari, etj. Shumë studentë të stomatologjisë kanë kryer mobilitete me afate të ndryshme kohore në kuadër të programeve Erasmus, apo në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me universitetet e mësipërme. Në takim me studentët e SPA u tha se prej kohësh ishte arritur akordi për mobilitet të disa studentëve të SPA-së në Universitetin e Ankarasë në Turqi, por që është shtyrë për në fillim të vitit 2022 për shkak të pandemisë Covid19. UAL ka marrëveshje me kompani për prodhimin e materialeve dentare dhe është në prag të finalizimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin e Ferrarës në Itali, me qëllim të promovohen aktivitetet në drejtimet e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, për institucionet respektive. Një komponent i rëndësishëm në zhvillimin e veprimtarive në kuadër të ndërkombëtarizimit është thirrja e lektorëve të huaj. Personalitete nga Italia janë bërë pjesë integrale e veprimtarive mësimore, praktike, klinike në UAL, apo në institucionet partnere më të cilët institucioni bashkëpunon. Në dokumentacionin mbështetës të RVB-së është dhënë një listë e gjatë partnerësh dhe bashkëpunëtorësh, të cilët kanë kapacitete e duhura për të asistuar UAL-në në zhvillimin me sukses të programit.

Gjate vizitës në UAL u verifikua dokumentacioni perkatës dhe u gjetën të nënshkruara marrëveshjet e bashkëpunimit, afatet dhe llojet e bashkëpunimit. Në këto marrëveshje është parashikuar edhe kryerja pranë laboratoreve të UAL-së e studimeve shkencore të studjuesve nga Universiteti i Chietit, tregues i qartë pozitiv. Do të kishte qenë e arsyeshme që në të njëjtën sëmester të ishte parashikuar edhe mundësia e kryerjes së studimeve nga specialistë shqiptarë në Universitetet e huaja me të cilët kanë marrëveshje bashkëpunimi. Në kuadër të bashkëpunimit me institucione shkencore e mjekësore të UAL, atë e kanë vizituar dhe kanë dhënë ndihmesën e tyre shumë profesorë e specialistë nga Europa, Amerika e Azia. Në kuadër të përmirësimit të punës lidhur me mobilitetin, ndoshta do të ishte e arsyeshme edhe parashikimi i dërgimit të specialistëve për afate të kufizuara në këto institucione, për të kryer kërkime qoftë edhe për pjesë të veçanta të studimeve që ata duan të realizojnë. Marrëveshjet janë, mbase ka mundësi për ndonjë përmirësim të tyre. Sidoqoftë bashkëpunimi me institucione të tjera të vendit apo të huaja duhet konsideruar i realizuar dhe programi i studimeve në SPA i suksesshëm. Më poshtë jepet një tabelë me të dhëna lidhur me aktivitetet e përbashkëta të bashkëpunimit të UAL me institucione të tjera ndërkombëtare.

Aktivitete shkencore në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar:

Aktivitete shkencore në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar		
1	Numri i studentëve pjesëmarrës si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare	2
2	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime	35
3	Numri i lektorëve të huaj që janë angazhuar në mësimdhënie/udhëheqje	5
4	Numri i orëve mësimore të zhvilluara nga lektorë të huaj	100

Prubus



5	Numri i pjesëmarrësve në trajnime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	22
6	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL	17-
7	Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	-

Konkluzionet e vlerësimit:

Referuar informacionit të mësipërm, rezulton se Universiteti Aldent ka eksperiencën e duhur, kapacitetet dhe bashkëpunëtorët për të ofruar një program cilësor studimi. Institucioni ka një numër të madh marrëveshjesh bashkëpunimi me disa institucione të rëndësishme arsimore, mjekësore e shkencore dhe nje aktivitet të përbashkët të konsiderueshëm. Ka marrëdhënie me institucione ndërkombëtare si Universita degli studi “G. D’Annunzio” Chieti, Pescara dhe Universitetin L’Aquila në Itali dhe me shumë universitete në Poloni, Çeki, Lituani, Turqi, Bullgari, etj.


Ndërkohë një numër i madh klinikash private janë pjesë e bashkëpunorëve të UAL-së. Ai parashikon që të lidhë marrëveshje të reja bashkëpunimi në të ardhmen me institucione të tjera prestigjioze dhe projektet janë të gatshme e në fazën e finalizimit, sikundër ishte marrëveshja me Universitetin e Ferrarës në Itali. Pavarësisht vështirësive të hasura për të kryer mobilitete, rezulton se numri i partnerëve dhe i bashkëpunorëve do të krijojë mundësi në të ardhmen mbas përfundimit të situatës pandemike. Universiteti ka përfshirë personalitete të njohura në fushën e dentistrisë, të cilët angazhohen në mësimdhënie si leksione, seminare, praktika klinike, etj.

ANALIZA SWOT PËR PROGRAMIN E STUDIMIT “SPECIALIZIMI AFATGJATË NË STOMATOLOGJI me dy profile”

a. Pikat e forta:

1. Programi i ciklit të tretë të studimit Specializim afatgjatë në stomatologji me dy profile, është në përputhje me strategjinë e institucionit dhe kërkesat e tregut të punës;
2. Programi i studimit Specializim afatgjatë në stomatologji me dy profile, që është nga të pakta programe të këtij lloji që ofrohen në vendin tonë, mundëson përgatitjen e specialistëve stomatologë në fusha specifike dhe rrjedhimisht ndikon në rritjen cilësore të shërbimit stomatologjik në vend;
3. Veprimtaritë formuese të programit të studimit ofrohen në përputhje me planin mësimor përkatës, si dhe kanë të implementuar metoda mjekimi inovative dhe nga më të fundit;
4. Personeli akademik dhe mjekët specialistë të angazhuar në procesin e mësimdhënies të programit, janë personalitete të fushës, nga universitete e institucione të njohura, partnere brenda dhe jashtë vendit;
5. Ka numër të lartë të bashkëpunimeve dhe partneriteteve me institucione të arsimit të lartë dhe qendra/klinika stomatologjike brenda dhe jashtë vendit;
6. Ka rritje të cilësisë së specializantëve në hyrje, si rezultat i politikave të përzgjedhjes së tyre nga UAL, në këtë program studimi;

Prubus



7. Infrastrukturë tërësisht e re, bashkëkohore, salla klinikash stomatologjike të mirëpajisura, në dispozicion të studentëve dhe të pacientëve;
8. Të diplomuarit në këtë program studimi kanë ndikuar jo vetëm në rritjen e nivelit të shërbimit stomatologjik vendas, por dhe në rajon (Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut);

b. Pikat e dobëta:

1. Pjesëmarrja jo e lartë e studentëve në punë kërkimore-shkencore, sidomos në periudhën e fundit, ndikuar edhe nga Covid-19;
2. Mungesa e mobiliteteve të studentëve, sidomos në kuadër të programeve të komunitetit evropian, si Erasmus+, etj;

c. Mundësitë:

1. Rritja e numrit të aplikimeve për mobilitete të studentëve dhe të stafit akademik, në kuadër të programeve të Komunitetit Europian;
2. Zgjerimi i bashkëpunimeve/partneriteteve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
3. Kërkesa në rritje për profesionistë të këtij programi specializues, kryesisht në shërbimin stomatologjik në vend dhe atij në rajon (një numër i konsiderueshëm i studentëve vijnë nga Kosova, Mali i Zi, apo nga Maqedonia);

d. Pengesat:

1. Mungesa prej më shumë se 10 vite i ofrimit të programeve të doktoratës në fushën e stomatologjisë në vend, pengesë kjo sidomos për stafin e ri në moshë, për avancimin në kualifikimin e tyre akademik (gradë shkencore apo titull akademik);
2. COVID -19 ka ndikuar sidomos në mundësinë e paketë për mobilitetet dhe në kërkimin shkencor;

Rekomandime:

1. Institucioni të shohë mundësinë e rritjes së krediteve të lëndëve specifike, apo të praktikave klinike, sipas vlerësimit nga vetë UAL dhe për aq sa e lejojnë kufizimet e akteve ligjore dhe nënligjore për këto lloj programesh;
2. Institucioni të marrë masa për vënien në efijencë të pajisjes së sedacionit koshient;

SWOT ANALYSIS FOR THE STUDY PROGRAM: "LONG TERM SPECIALIZATION" IN "DENTISTRY"

a. Strengths:

1. The third cycle study program Long-term specialization in dentistry in two profiles is in concordance with the institution's strategy and labor market requirements;
2. Being one of the few universities which offers this type of program in our country, it gives a valuable contribution to the preparation of specialists in dentistry, and consequently affects the quality growth of the dental service;

Pruchas
jeet

3. The formative activities of the study program are offered in accordance with the respective curriculum and have implemented innovative treatment methods;
4. Academic staff and specialist engaged in the teaching process of the study program are personalities of their fields, from well-known partner universities and institutions of our country or abroad;
5. High number of collaborations and partnerships with higher education institutions and dental centers / clinics in our country and abroad;
6. Increasing the quality of incoming students in this study program, as a result of the admission policies for their selection;
7. Completely new, modern infrastructure, well-equipped dental clinics available to students and patients;
8. Graduates in this study program have influenced not only the increase of the level of local dental service, but also in the region (Kosovo, Montenegro, Northern Macedonia);

b. Weaknesses:

1. The low participation of students in scientific research, recently influenced by COVID-19 situation;
2. Lack of students mobility, especially in the framework of European community programs such as Erasmus +, etc;

c. Opportunities:

1. Possibly increase the mobility of specialists and staff through applications in European Community programs;
2. Expansion of collaborations / partnerships at national and international level;
3. Increasing demand for professionals of this study program, mainly in the dental service in the country and region (a significant number of students come from Kosovo, Montenegro or Macedonia);

e. Obstacles:

1. The lack for more than 10 (ten) years of offering doctoral programs in the dentistry field in our country, it is an obstacle especially for senior staff and their advancement in academic qualification (scientific degree or academic title);
2. COVID -19 has particularly affected the limited mobility opportunity and research;

Recommendations:

1. The institution should see the possibility of increasing the credits of specific courses, or clinical practices as assessed by the UAL itself, and to the extent permitted by the restrictions of laws and bylaws for these types of programs;
2. The institution should enable the use of the conscious sedation device;

Practica

